AFRIM HOTI

KËRKIME ARKEOLOGJIKE

Përmbledhje artikujsh shkencorë

(1980 – 2000)

Botimet Jozef, 2026

KËRKIME ARKEOLOGJIKE

Përmbledhje artikujsh shkencorë

(1980 – 2000)

Nga Afrim HOTI

Përgatiti për shtyp: Muzeu Arkeologjik Durrës

Nën kujdesin e z. Alban Ramohitaj

©: Muzeu Arkeologjik, Durrës

Në kopertinën e parë: Macelllum, fillimi i shek.VI mbas Kr.
(foto e vitit 1987)

Në kopertinën e dytë: Instrumentist me violë
(fragment qeramike protomajolike), shek.XIII

Botimet Jozef, 2026

ISBN: 978-9928-942-11-1

PËRMBAJTJA

Parathënie 5

Të dhëna arkeologjike për krishterimin e hershëm në Dyrrah (shek.IV-VII) / *Des donees archeologiques sur le christianisme ancien a Dyrrachium* (*IV-VII siecles)*.....9

Disa tipare të qeramikës së mesjetës së hershme në Shqipëri (shek.VII-XI) / *Some features of the early medieval pottery in Albania (7th-11th centuries)* 25

Plastikë arkitektonike dekorative paleokristiane nga qyteti i Durrësit / *La plastique architectonique décorative à Durrës durant la période paléochrétienn*e 45

Enë me glazurë nga qyteti i Durrësit (shek. X-XV) / *Recipients a glaçure decouverts a Durres* (*X-XV siecles)*.....75

Monedha perandorake bizantine nga Durrësi (491-1025) / *Monnaies imperiales byzanines provenant de Dyrrachion (491-1025).*.....124

Kryqe - enkolpione mesjetare të gjetura në Shqipëri / *Des croix medievales trouvees en Albanie* 170

Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit 183

Kërkime arkeologjike në zonën e Kryemdhejit në rrethin e Durrësit 225

Kërkime arkeologjike në fshatin Hamallaj / *Recherches archeologiques dans le village Hamallaj* (*district de Durres)* 245

Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës.....249

Raporte gërmimesh / *(Rapports de fouilles)*.....253

Gërmimet arkeologjike të vitit 1984 - Durrës (lagjja 11) 255

Gërmimet arkeologjike të viteve 1985-1986 - Durrës, Kalaja 259

Gërmimet arkeologjike të vitit 1987 - Durrës - qytet 262

Gërmimet arkeologjike të vitit 1988 - Durrës - qytet 266
Gërmimet arkeologjike të vitit 1989 - Durres - qytet 270
Gërmimet arkeologjike të vitit 1990 - Durrës 273

PARATHËNIE

Në këtë përmbledhje me 16 artikujt jepen informacione për çështje të ndryshme të fushës antike e mesjetare. Duke u fokusuar në Durrësin arkeologjik ne kemi zgjedhur një nga qytetet më të lashtë të arealit kulturor të Adriatikut të Poshtëm.

Midis trajtesave përfshihen edhe dy punime përgjithësues: njera për qeramikën dhe tjetra për enkolpionet mesjetare të zbuluar në Shqipëri, ku objektet nga Durrësi zenë një vend kryesor.

Rrethi i problemëve të trajtuara në këtë vëllim është frut i një pune kërkimore të gjatë, të zhvilluar mbi bazën e të dhënave të vjelura në ekspeditat e viteve 1980-2000.

Nga gërmimet e kryera brenda dhe jashtë kështjellës bizantine të Durrësit, kanë dalë në dritë rrënoja monumentesh të periudhave të ndryshme: kthina banimi, elemente të plastikës arkitektonike paleobizantine, shoqëruar me objekte të ndryshme të përdorimit të përditshëm: qeramikë, stoli, mjete të liturgjisë e të tjerë objekte, që mbartin një numër vlerash të kulturës dhe që hedhin dritë për një sërë çështjesh të dinamikës ekonomiko-kulturore. Veç gërmimëve, në sheshe pranë monumentëve, janë eksploruar edhe parcela varrezash të periudhës antike e mesjetare që paqyrojnë aspekte shpitërore të banorëve të qytetit të Dyrrahut gjatë kohës së ngjizjes së kultures bizantino-arbërore

Krahas kërkimëve në qytet, ekspeditat përnjohëse në rrethinat e Durrësit, kanë evidentuar një numër qendrash arkeologjike. Ndërkohë, edhe nga kontrollet e rastit në kalatë e Skendërbeut, Ishmit e të Bashtovës, apo në kishat mesjetare të Rodonit, Çetës, e gjetkë, janë zbuluar të dhëna që nuk njiheshin më parë: mbetje

rrënojash, një lëndë e larmishme me materiale ndërtimi, vegla pune, fragmente enësh, stoli, monedha e objekte të tjera.

Bazuar në rezultatet e këtyre kërkimeve, ky vëllim na ofron një përzgjedhje artikujsh dhe informacionesh, të nxjerrë nga revista "Iliria" (1979-2000). Andaj lënda e ripublikuar, sipas teksteve origjinale, përveç disa korigjimeve, duhet parë si trajtesë që i referohet nivelit shkencor të kohës së botimit.

Në artikullin: "Të dhëna arkeologjike për krishtërimin e hershëm në Dyrrah (shek. IV-VII)" nënvizohet fakti se, gjatë periudhës së antikitetit të vonë, u realizuan një sërë projektesh bizantine, ndër më të arrira të kohës.

I ndodhur në një hapësire politiko-gjeografike të favorshme, Dyrrahu përjetoi ndërtime të një rrjeti të gjërë ngrehinash të kultit kristino-bizantin, çka solli një transformim mjedisor e urban të territorit. Vazhdimësia historiko-kulturore, evolucioni i kristianizmit interpretohen si prirjre të zhvillimit të një vargu dukurish që diktuan shndërrimin e strukturave ndërtimore romake në një plan të ri urban paleokristian.

Siç pasqyrohet edhe në rubrikën; "Gërmime arkeologjike", gjatë zbulimit të Macellliumit, në mjediset tregtare të këtij monu-menti, përveç monedhave perandorake bizantine, janë gjetur edhe objekte prej qeramike (amfora, llamba etj.), të argjendarisë, prej qelqi etj., një pjesë e të cilave, duket se i përkasin artikujve të importit.

Në artikullin: "Monedha perandorake bizantine nga Durrësi (491-1025)" jepet një koleksion me prerje të kohëve të ndryshme, nëpërmjet të cilave krijohet tabllo mbi qarkullimin e mallrave dhe trafikun tokësor e detar.

Nëpërmjet këtij qarkullimi, Dyrrahu ishte shndërruar në një treg monetar, ku zhvillohej biznesi perandorak bizantin. Për

rrjedhojë pati një impuls në shtimin e produkteve dhe rritje të tregtisë rajonale, faktorë këto, që ndikuan në forcimin e rolit ekonomik të qytetit dhe zgjerimin e lidhjeve të ndërsjellta tregtare me provincat e Ballkanit dhe më gjërë.

Periudha e antikitetit të vonë, për portet e Epirit të Ri ishte koha e intensifikimit të lidhjeve tregtare edhe me mjaft provinca dhe qytete mesdhetare.

Në vijim, në artikullin: "Plastikë arkitektonike dekorative paleokristiane nga qyteti i Durrësit" analizohen prodhimet arkitektonike paleokristiane (kolona, pilastra, ikonostaset, kapitelet, këto të fundit të tipeve korintik, kompozit etj.), mjaft të larmirtë si tipologji. Nga krahasimet e bëra rezulton se, produktet e porositura nga Ateliea e Prekonezit, kanë qenë elementët bazë që u përdorën për ngritjen e ngrehinave paleobizantine. Nëpërmjet përshkrimeve të skulpturës arkitektonike, sipas funksionit që ato kanë patur, hidhet dritë për zhvillimin hapsinor të Dyrrahut, si kryeqendër e provincës së Epirit të Ri.

Punimi "Disa tipare të qeramikës së mesjetës së hershme në Shqipëri (shek. VII-XI)" është një trajtesë që shqyrton një numër forma enësh të zbuluar në Durrës e në një truall të gjerë të territorit shqiptar. Në katalog analizohen forma enësh të ndryshme (amforat, brokat, oinohet, kotruvet, kanat e vorbat, etj), me prejardhje tipologjike nga punishte medio-bizantine që, gjatë periudhës së mesjetës së hershme, hodhën ne treg prodhime të ndryshme prej qeramike.

Çështja e përhapjes të qeramikes mesjetare në Shqipëri është parë si një aspekt i gjerë krahasues, me qeramikën e vendeve ballkanike dhe mesdhetare.

Në artikullin: "Enë me glazurë nga qyteti i Durrësit (shek. X-XV) jepet një tabllo për repertorin e qeramikës së glazuruar

me dhe pa zbukurime. Në aspektin morfologjik ajo përfaqësohet nga një seri formash. Numrin më të madh të enëve e përbëjnë tasat, kupat, pjatat e deri diku pjatancat, tavat e broket. Në disa kategori enësh janë aplikuar teknika të ndryshme zbukurimi: me shomplevë, zgrafito etj., të pikturuara me motive spirale (shek. XII), figura antropomorfe, të faunës (shek. XIII-XIV), etj.

Në artikullin "Kryqe - enkolpione mesjetare të gjetura në Shqipëri" trajtohen veçori të zhvillimit tipologjiko-kronologjik, aspekte të tregtisë dhe të qarkullimit të mjeteve liturgjike. Çështja e studimit të kryqe-enkolpionëve, shihet në një plan të gjerë krahasues, me punishtet siro-palestineze .

Në këtë vëllim të tërheq vëmendjen punimi: "Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës", parë si një praktikë funerare e fillimëve të kristianizmit. Ato u përkasin periudhës së kalimit nga faza Konstandiniane në atë Paskonstandiniane (313/340-360/370) dhe përfaqësojnë tipin i varreve në trajtën e dhomëzave, ku faqet e brëndshme të tyre janë të pikturuara me afreske që paraqesin simbolet e krizmonit.

Siç del nga kjo përmbledhje me artikuj studimorë, Durrësi dhe rrethinat e tij zenë një vend të rëndësishëm. Në këtë territor ekzistojnë me dhjetra monumente e vendgjetje arkeologjike që mbartin vlera të çmuara. Kësisoj ato prezantojnë potenciale të trashëgimisë kulturore, të cilat mund përdoren në interes të zhvillimit lokal dhe të turizmit.

Botimi i materialeve të kësaj përmbledhjeje përbën një ndihmesë në shërbim të organëve të pushtetit lokal. Nga njohja e karakterit të monumenteve mund krijohen koncepte orientuese për mënyrën e organizimit urban të qytetit në harmoni me objektet e trashëgimisë kulturore.

Autori

TË DHËNA ARKEOLOGJIKE PËR KRISHTERIMIN E HERSHËM NË DYRRAH (SHEK.IV-VII)[1]

Ndër qytetet në brigjet ilirike të Adriatikut, Dyrrahu ka qenë qendra ku u përhap së hershmi krishterimi dhe ku religjioni i ri gjeti shtrat dhe vijoi pa ndërprerje nga periudha parakostandiniane në atë bizantine.

Gjatë shek. I të erës sonë, rreth vitit 58, edhe pse në qytet numëroheshin mbi 70 familje të krishtera dhe ishin ngritur bashkësitë monoteiste, krishterimi nuk pati mundësi të përhapej shpejt e të përqafohej lehtë nga të gjithë.[2] Madje Dyrrahu u bë i njohur në mbarë botën e hershme kristiane për përndjekjen e dy martirëve vendas: Shën Astit (klerik i martirizuar në kohën e perandorit Trajan) dhe Vsabrusit.[3]

---

[1] Kumtesë e mbajtur në konferencën ndërkombëtare: "Kristianizmi i hershëm dhe Shqipëria", Tiranë, 11-12 tetor 1995. Botuar në revistën Iliria, Nr.1-2, 1996. (https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1996_num_26_1_1664)

[2] 1. H. Delehaye, Synax Eccl.Const., A.S. Propylaecum nov, Bruxelles, 1902, col. 797,801,806; AASS, Jul. 5,6; V.Laurent, Le Corpus des Sceau se l'Empire Byzantin, V/i, Paris 1963, 560-563.

[3] Shih të dhënat e citimit nr. 2. Kulti përkujtimor i martirëve të Dyrrahut do të ruhet gjatë shekujve të mesjetës. Emrat e tyre do të mbajë katedralja e Durrësit në shek. XIII-XIV; A. Dusellier, La fasade maritime de l'Albanie au moyen àge, Thessaloniki 1981, f. 32,55. Po kështu, në një afresk të shek.XIII në kishën e Rubikut, ndermjet shenjtorëve, del edhe figura e Shën Astit ku dallohet edhe sigla e tij e shkruar latinisht: V.Puzanova, Dh. Damo, Disa tipare të pikturës monumentale në Shqipëri gjatë periudhës së shek. XIII-XV, "Studime Historike" 2, 1967, f. 10.

Përhapjen e krishterimit në Dyrrah e provon në disa aspekte rituali funerar. Aty nga fundi i shek.IV të e.sonë përfaqësues nga radhët e të krishterëve i gjejmë të varrosur në një nga parcelat pagane të nekropolit kodrinor të qytetit, pranë kuotës 98 m.[4] Tipologjia e këtyre varreve nga pikëpamja e ndërtimit është pothuajse e njëjtë me varret pagane të shek. I-III të e.sonë.[5] Për të varrosurit e krishterë vijon të ruhet thuajse e njëjta strukturë ndërtimore varresh e shekujve të parë të e. sonë: varre të tipit dhomëza, të ndërtuara me tulla e llaç, porse në faqet e brendshme të suvatuara ndeshen afreske, ku me anën e penelatave me ngjyrë të kuqe janë pikturuar shenjat e njohura të krismonit.[6]

Ambiente të përshtatshme për krijimin e një varreze të hershme kristiane u bënë edhe mjediset e amfiteatrit gjatë shek. V-VII.[7] Fill pas braktisjes së këtij monumenti, varrimet e kryera në arenë dhe sidomos përgjatë galerive u dhanë këtyre të fundit karakterin e pseudo katakombeve. Qendra të tjera varrimi të

[4] A. Hoti, Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës, "Iliria" 1988, 1. f. 223-225. Edhe në parcela të tjera të qytetit ndodh po e njëjta gjë; F. Tartari, Tri sarkofagë të rinj nga Durrësi, "Iliria" 1994, 1-2, fig. 1.2. Njëri prej sarkofagëve, i zbukuruar në reliev me motive të eukaristisë, datohet në fund të shek. II - fillimi i shek. III i e.sonë. Raste analoge të pasqyrimit të eukaristisë, madje të së njëjtës kohë janë konstatuar edhe në Dardani; E. Dobrunja, *Tipologjia e monumenteve sepulkrale të periudhës romake në Kosovë*, "Iliria" 1982, 2, f. 223, fig. 2, f. 224, fig. 5-6.

[5] F. Tartari*, Një grup varresh të shek. II-IV të e.sonë në zonën kodrinore të nekropolit të Dyrrahut*, "Iliria" 1987, 1, f. 153-166.

[6] A. Hoti, po aty.

[7] V. Toçi, Amfiteatri i Dyrrahut, "Monumentet" 1971, 2, f. 39-40; L. Miraj, (Durrës- Amfiteatër) Gërmime arkeologjike të vitit 1988, "Iliria" 1988, 2, f. 264-265; F. Miraj, Mbishkrime latine të Durrësit, "Iliria" 1991, 1-2, f. 273, nr. 10-11.

shek. V-VII janë zbuluar edhe në zonën fushore të qytetit (tab. 1).[8]

Varret janë ndërtuar në mënyra të ndryshme: mbizotëron tipi me mbulesë tjegullash të vendosura në trajtë çatie dyujëse si edhe ato me gropa të thjeshta. Një numër të paktë përbëjnë varret e tipit dhomëza. Përdoret vetëm riti me vendosje trupi. Varret janë gjendur përgjithësisht pa inventar dhe rrallëherë me gjetje të pakta.

Ashtu sikundër në hapësirat e tjera ku u përhap qytetërimi kristian edhe në Dyrrah religjioni i ri ndërveproi me disa sfera të artit. Importimi i pjatave dekorative afrikano-veriore me përmbajtje biblike filloi të zëvendësojë dora-dorës enët antike me motive nga skenat e mitologjisë politeiste. Ndër to dallohen pjatat prej argjile të kuqe të viteve 280-350 të e.sonë, që pasqyrojnë subjekte me kafshë afrikane ku midis tyre ka edhe nga ato që zakonisht paraqesin episode biblike.[9] Më vonë vazhduan të

[8] H. Hidri, F. Tartari (Durrës-qytet), Gërmime arkeologjike të vitit 1989, "Iliria" 1989, 2, f. 283-284; 1. Kabashi. Durrës-qytet, po aty, f. 286; A. Sila, Durrës (Kala), Gërmime arkeologjike të vitit 1990, "Iliria" 1990. 2, f. 272. Topografia e varrezave të hershme kristiane, sot për sot, është relativisht e njohur. Këto nekropole janë paraqitur në hartë (tab. I) me shenjën konvencionale ±. Disa nga rezultatet e arritura nga gërmimet në këto varreza do t'i japim në një studim tjetër.

[9] Këto pjata sipas klasifikimit tipologjik të J.W.Hayes-it përfshihen në grupin e enëve të formave 52 B, datuar në shek. III-IV të e.sonë (J.W.Hayes, Late Roman Pottery, London 1972, f. 78, tab. XI a. Motivet dekorative të këtyre formave nuk trajtohen thjesht si pasqyrim i faunës, por si figura që, në një mënyrë ose tjetër, duhet të lidhen me episodet biblike. Një subjekt i tillë me temë: Danieli në gropën e luanëve, paraqitet më qartë në një kupë tjetër dekorative të zbuluar në Kalldrun të Shkodrës: S. Anamali, D. Komata. Varrezat e Kalldrunit (Koplik), "Kumtar i Muzeut Popullor të Shkodrës", nr.

importohen edhe kupa të tjera po nga kjo kategori qeramike. Në njërën prej tyre është paraqitur portreti ballor i Krishtit" (fig. 1).[10]



Fig. 1

Krahas qeramikës artistike hynë në Dyrrah, madje dhe u prodhuan nga punishtet vendase duke iu përshtatur ritualeve liturgjike, kandilat e tipave romakë të lyer me vernik të kuq e kafe, disqet e të cilëve mbajnë simbolet e kryqeve dhe monogramet e Krishtit. Shenja të tilla vihen re edhe në enët e transportit e sidomos në amforat e tipave mesdhetarë të shek. V-VI të

3-4, Shkodër 1978, f. 96, si dhe përshkrimi i S. Anamalit në "Albanien" Mainz, 1989, f. 443, nr. 355.

[10] Në faqen e brendshme të fragmentit me anën e teknikës së stampimit është paraqitur Krishti që mban një kryq në krahun e majtë; fytyra e rrumbullakët është qarkuar me një aureole gjysmërrethore. Ky lloj pikturimi i përket stilit E (ii) të aplikuar në çerekun e dytë të shek. VI (J.W.Hayes, vep.cit., f. 264, fig. 51, nr. 239, B, g. 240, 1).

e.sonë, në faqet e të cilave gjithashtu janë sigluar simbolet e krizmës".[11] Po kështu në materialet e ndërtimit, veç shenjave të kryqeve monogramike, ndeshen dendur edhe kryqet e tipit latin, patibulata etj.".[12] Këto elemente, që spikasin kudo në enët e përdorimit të përditshëm dhe në qeramikën masive, flasin qartë se Dyrrahu ishte shndërruar tashmë në qytet me bashkësi të kristianizuar dhe se banorët e tij nuk ishin më një populsi pagane, por qytetarë që idealet e tyre shpirtërore i kishin lidhur me krishterimin.

Pas konstituimit të fesë së re u bënë përpjekje për një vizion të ri urbanistik të qytetit. Interesim të veçantë tregoi selia peshkopale dhe administrata shtetërore për rindërtimin e qytetit të shkatërruar nga tërmetet e vitit 346 dhe ato që ranë pas tij. Gjendja e rëndë e krijuar e detyroi perandorin Anastas I të ndërmerrte ndërtimin e një sistemi të ri fortifikimi".[13] Dyrrahu përbën shembullin tipik të qytetit paleokristian bizantin, muret rrethuese të të cilit ndjekin linjën rrethore të periudhës roma-

[11] A. Hoti, Qeramika mesjetare e zbuluar në Durrës (shek. VII-XV), disertacion, 1990, f. 28, tab. VI. 27.

[12] K. Zheku, Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit, "Monumentet" 1972, 3, f. 39, fig. 9.

[13] . Në muret e kështjellës janë zbuluar tulla me monograme të Anastasit (K. Zheku, art.cit.), f. 35-43; F. Miraj, Për një interpretim të ri të monogrameve në tullat e murit rrethues të Durrësit, "Monumentet" 1980, 20, f. 127-129. Nga 60 vepra të ndërtuara në kohën e Anastasit, kështjella e Dyrrahul renditet përbri ndërtimeve ushtarake më të rëndësishme të hapësirës bizantine; E. Hrysou. Symboli stin Istoria tis Iperion, "Iperotika Kronika" 23, 1981, C. 98. Midis zbulimeve të tjera në këto mure janë konstatuar edhe tulla me monograme të Justinianit I (F. Miraj, po aty) çka tregon se edhe këtij perandori iu desh të investonte për mënjanimin e pasojave të tërmetit që ndodhi në kohën e tij, më 522. Kësaj periudhe duhet t'i përkasë edhe pjesa shtojcë e fortifikimit në kepin "Pali". Gj. Karaiskaj "5000 vjet fortifikime në Shqipëri", 1981, f. 119.

ke".[14] Sipërfaqja e fortifikuar me rreth 80 ha"[15] ndahej në tri pjesë: kështjella e sipërme, e poshtmja dhe qendra urbane pastorale (tab. I).

Muret e kështjellës me perimetër 4,4 km, lartësi 10,75 m dhe gjerësi 3,35 m'[16] janë ngritur me tulla e llaç të fortë dhe me përzierje copërash qeramike të shtypur, teknikë e njohur në murin e jashtëm të Kostandinopojës të ndërtuar po nga Anastasi I.[17]

Nga periudha e antikitetit të vonë vitet e fundit janë zbuluar pjesërisht disa mbetje e rrënoja monumentesh: Macelllumi dhe disa rrënoja kishash dhe bazilikash të gjetura përreth tij, çka dëshmojnë praninë e një qendre urbane dhe gjurmët e një grupi peshkopal.

---

[14] Nga sistemi i fortifikimit të periudhës parabizantine ka mbetur një trakt muri prane ish bastionit, prapa ish rezidencës së shtetit shqiptar të princ Vidit (sot Qendra Kulturore e Pionierëve). Janë dy harqe gjysmërrethore të ndërtuara me tulla e llaç gëlqeror me diametër 2.50 m dhe një kolonë e ndërtuar me të njëjtën teknikë 0,90 m e gjerë (Gj. Karaiskaj, A. Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë, "Monumentet" 1975, 9, 1. 8; L. Miraj, Mbi muret mbrojtëse parabizantine të Dyrrahut, Materiale të sesionit shkencor arkeologjik, Durrës (më poshtë MSAD), 1983, f. 103.

[15] A. Baçe, Studim mbi zonifikimin arkeologjik të qytetit të Durrësit. "Monumentet" 1988, 2, f. 56. Kufijtë e shtrirjes së qytetit në periudhën paleokristiane janë konvencionalë. Në sipërfaqen prej 80 ha nuk përfshihet shtojca veriore e rrethimit tek "Porta".

[16] Të dhënat i referohen rezultateve të dy fushatave të gërmimit të kryera gjatë viteve 1985- 1986 rrëzë faqes së brendshme të murit JP ku doën në dritë elemente të reja të arkitekturës. A. Hoti, Gërmime arkeologjike të vitit 1986, (Durrës-Kalaja), "Iliria" 1986, 2, f. 268-269. Nga kjo kështjellë ruhet vetëm pjesë e murit jugperëndimor me gjatësi 565 m me dy porta dhe katër kulla në trajtë shporti (tab. I, 6). Të dhënat e derisotme ende nuk japin ndonjë ide se si ka qenë zhvilluar qyteti në pjesën e sipërme përreth kuotës 98 m si pika dominuese e kështjellës. Një informacion të kufizuar kemi gjithashtu edhe për kështjellën e poshtme sipërfaqja e së cilës nuk i kalon 4500 m2.

[17] D.S. Ovtcharov, "Foresses Byzantines et Bulgares (Ve-Xes)". Sotia 1982, f. 18.



Fig. 2

Macelllumi[18] (fig. 2), i vendosur 1.20 m mbi mbetjet e strukturave të termave të periudhës romake (tab. I, 4), ka trajtën e një portiku rrethor, në mesin e të cilit ndodhet një podium. Portiku, me diametër 40 m, është i shtruar me pllaka mermeri të llojit prokonezian. Nga kolonada janë gjetur vetëm dy kolona të plota me kapitelet përkatëse. Rreth e qark kolonadës shtrihet një korridor në formën e një hajati dhe në shpinë të tij një grup mjedisesh që në anën e prapme qarkohen gjithashtu me një mur rrethor. Elementet arkitektonike, materialet e imëta arkeologjike e veçanërisht gjetja e monedhave të Anastasit I e datojnë këtë

[18] Disa rezultate paraprake rreth gërmimeve në këtë monument janë dhënë nga autori në "Iliria" 1987, 2, 1. 261-262; “Iliria”, 1988, 2, f. 271-272 dhe në “Iliria" 1989, 2, f. 293-294.

monument në periudhën e fundit të shek. V fillimin e shek. VI, ndoshta rreth vitit 500.[19]

Portiku me sipërfaqe relativisht të madhe ka pasur funksionin e një sheshi publik. Gjetja pranë piedestalit e një pëllëmbe (dore) që i përket trupores së një njeriu me përmasa natyrore, na bën të mendojmë se në qendër të podiumit duhet të ketë qenë një vepër monumentale kushtuar një personaliteti të shquar, siç mund të ishte perandori Anastas I me origjinë nga ky qytet.

Ky monument rrethor ka një planimetri të një lloji të veçantë, që ndeshet rrallë në territorin bizantin. Paralelet më të afërta të këtij monumenti gjenden në një shesh tjetër në Caricin-Grad të provincës së Dardanisë ku edhe atje ka karakterin e një ansambli cirkular, por i datuar disi më vonë, në kohën e Justinianit 1".[20] Tregjet e periudhës së hershme bizantine me sa duket iu përmbajtën skemave arkitektonike të traditës së shekujve të parë të erës sonë.[21] Edhe tregu rrethor i Dyrrahut nuk ka ndonjë dallim nga strukturat e merkatove romake.[22]

Në afërsi të këtij monumenti, në anët veriore dhe lindore janë zbuluar herë pas here mbetjet e disa ngrehinave[23] ku janë

[19] A. Hou, shih të dhënat e citimit nr. 17. Mendimin për kohën e ndërtimit të këtij monumenti rreth vitit 500 e ka shprehur së fundi G. Koch, Frühchristliche Kunst 1995, f. 63.

[20] V. Kondi, VI.Popović, Caricin Grad, 1977, fig. 4, nr. 8. Për përafërsitë me Caricin Gradin është shprehur edhe G. Koch; po aty.

[21] 1. Crema, L'architetura Romana, Enciclopedia Classica, sezione III, Archeologia e storia dell'arte classica, vol. XII, "Archeologia" (Arte romana) Toma I, f. 351, fig. 402.

[22] J. Mertens, Herdonia (Scoperta di una citta), Bari, 1995, f. 196-199, fig. 183-186 (bashkë me literaturën e cituar).

[23] A. Hoti (Durrës, Lagjia 11), Gërmime arkeologjike të vitit 1984, "Iliria" 1984, 2, f. 274- 275; 1. Kabashi, Dëshmi të reja nga dy monumente të

nxjerrë një numër jo i vogël elementesh dekorative arkitektonike (kolona, kapitele, imposte, pllaka dekorative të kangjellave, të amboneve etj.),[24] që tipologjikisht u takojnë shek. V-VI. Këto elemente që me sa duket vijnë nga godina të kultit, duhet t'i përkasin ndoshta një grupi peshkopal.

Elementet e plastikës dekorative arkitektonike në trajtimin e tyre artistik i përmbahen modeleve të njohura të atelieve që përdorin mermerin e Prokonezit. Por nuk mungojnë edhe ekzemplarë të punuar prej guri gëlqeror që ndeshet rëndom në vendin tonë.

Nga mbi 30 elemente të kësaj plastike dekorative në mbështetje të tipareve morfologjiko-estetike mund të veçohen disa tipa kapitelesh dhe impostesh. Kapitelet më të hershme janë ato të tipit korintik (fundi i shek. IV-fillimi i shek. V), që për nga trajtimi stilistik janë pothuajse të njëjta me ekzemplarë të njëkohshëm të kishave italike.[25]

Të një periudhe të mëvonshme janë kapitelet e tipit kompozit jonik disa prej të cilave ndeshen edhe në Macelllum, si dhe impostet. Këto të fundit janë të skalitura me teknikën e shom-

antikitetit të vonë në qytetin e Durrësit, "Monumentet" 1, 1989 (37), f. 149-150, tig. 3.

[24] Disa prej elementeve të plastikës dekorative arkitektonike paleokristiane janë botuar në informacione dhe punime të ndryshme; A. Meksi, "Arkitektura mesjetare në Shqipëri" (shek. VII-XV), Tiranë, 1983. f. 32, fig. 12-13; H. Myrto, Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit. "Monumentet" 2, 1981, 1. 75, fig. 1-2; M. Zeqo, Disa monumente të murosura në Shqipëri, "Monumenter" 1985, 2, f. 57, fig. 24; I. Kabashi, po aty; S. Anamali, Architettura e dekoracione tardoantica in Albania, XL corso di cultura sull arte Ravennate 1993, f. 463, fig. 1-5.

[25] *W. D. Heimeyer, Korintische* Normalkapitelle, "Studie der Romischen Architekturdekkoration", RM 1970, tab. 48, 1-4.

plevës, imtësi tipologjike kjo që ka lidhje me ndikimin e atelieve të kohës.[26]

Strukturat e Macelllumit si dhe gjetjet e rastit përreth tij na sjellin të dhëna me interes për urbanistikën e kësaj pjese të qytetit në kohën e sundimit të perandorëve Anastas (491-518) dhe Justiniani 1 (527-565). Drejtimi i kanaleve higjieno-sanitare që ndeshen pranë tyre është një e dhënë tjetër që kjo njësi urbane duhet të ketë qenë kufizuar me një rrjet rrugor kënddrejtë.[27]

Dukuritë e përhapjes së besimit kristian në shek. V-VI i kanë provuar edhe rezultatet e kërkimeve arkeologjike të kryera në rrethinat e afërta të Dyrrahut, ku siç dihet në disa fshatra (Arapaj, Gjuricaj, Lis-Patros, Qerret e gjetkë)[28] janë zbuluar ngrehina kishash e bazilikash paleokristiane.

---

[26] Edhe këto elemente arkitektonike janë të punuara prej mermeri prokonczian. Në njërën faqe me anën e teknikës së shompleves (1.5-2.0 cm) janë gdhendur kryqe greke me apices dhe anash tyre akanthe fletëgjera të majacuara. Imposte të këtilla kanë pasur përdorim të gjerë në godina kulti në vende të ndryshme të Bizantit (Turqi, Greqi, Siri, Palestinë etj.). Veçanërisht këto parime dekoracioni gjetën zbatim të gjerë në atelietë e kohës së Justinianit I; A.S. Boyd, A little-known technique of architectural sculpture champlevé reliers from Cyprus, "XVI Internationales Byzantinisten Kongress Akten" [1/5, Wien 1982, "Jahrbuch der Osterreischischen Byzantistik 32/5, 1982, f. 313; E.D.Maguire, A Revolution in Northen Justinianic capital, Desing the Axial void in Constantinople and Philpii, International Symposium for Thracian Studies "Byzantine Thrace" vol 1, Amstreda 1989, f. 161-171.

[27] F. Tartari, Gjurmë kanalesh të lashta në Durrës e në qendra të tjera antike të vendit tonë, "Monumentet" 11, 1976. f. 76-87.

[28] S. Hidri, Rezultate gërmimesh në bazilikën e Arapajt (1980-1982), "Iliria" 1983, 2, f. 239- 240; po ai. Bazilika e Arapajt e zbulimet e reja në të, "Iliria" 1986, 1, f. 329-335; H. Myrto, art.cit. f. 63, tah. II, 1-2; po ai, pjesa e dytë e artikullit të mësipërm "Monumentet" 1982, 1 (23), f. 14-16, fig. 4; N. Osmani-A. Krasniqi, Ndihmesë për hartën arkeologjike të zonës së Synejit, "MSAD", f. 114-119, tab. I, 4.

Të dhënat arkeologjike dhe burimore dëshmojnë se gjatë shek. VII nuk kemi ndonjë ndryshim në planin urbanistik të qytetit. Pjesa më e madhe e ndërtimeve antike të vona vazhduan të funksionojnë edhe në fillimet e mesjetës. U ruajtën po në atë gjendje muret rrethuese bizantine. Ishin gjithashtu në përdorim disa monumente të tjera: Macelllumi, grupi peshkopal e bashkë me të edhe kisha e Shën Anargjirëve, që për herë të fundit përmendet në një burim historik të vitit 714.[29]

Kërkimet arkeologjike të kryera më 1987 në kapelën e amfiteatrit,[30] evidentuan një fakt me mjaft interes. Nga sondazhi i bërë në pjesën e dyshemesë rezultoi se ajo ishte e shtruar me pllaka mermeri dhe baltë (tegulae mammatae) të përmasave të

[29] E. Krysou, po aty, f. 98, shënimi 2. Kisha i kushtohet dy mjekëve martirë me origjinë siriane: Shën Kozmait dhe Shën Damianit. Kulti i tyre me origjinë nga lindja, i njohur që nga viti 400 e.sonë, u përhap në Dyrrah gjatë kohës së sundimit të Anastasit I (491-518), periudhë kur, me sa duket, u ndërtua në përkujtim të tyre, kisha me të njëjtët emra: G. Koch, "Albanien kunst und kultur im Land der Skipetaren" Köln 1989, f. 46. Gjatë shek. VI-VII bashkësia kristiane e Dyrrahut pati preferenca edhe për shenjtorë të tjerë orientalë. Kështu tek mozaikët e Kapelës së amfiteatrit, në paricta lin jugor, lexohet: (+OA[ΓIO]C CTEΦANOC) (shen Stefani) dhe ate perëndimor: EI PHNH, COΦIA (Irini dhe shën Sofia). Pranë figurës së Shën Stefanit është bërë mbishkrimi +K[YPJ]E βOΘHCON TOY ΔOYΛOY COY AΛEΞANΔPOY (Ruaje zot shërbëtorin tënd Aleksandrin). Të dhënat për këto mbishkrime janë publikuar që në botimet e para: V. Toçi, po aty, H. Nallbani, Mozaiku i kishës së amfiteatrit e Durrësit, "Monumentet" 7-8, 1974, f. 13-116. fig. 4.6.7.

[30] Gërmime të drejtuara nga autori ku, krahas zbulimit të dyshemesë se kapelës, u hap edhe një osteotekë e shek. XI. (A. Hoti, Varreza mesjetare e Durrësit, sekt. B,C,D,E, artikull i përgatitur për botim). Një informacion për materialin skeletik të zbuluar në osteotekë ka dhënë H. Bllaca në "Iliria" 1987, 2, 1. 262-263. Më pas për qëllime restaurimi dhe konservimi një pjesë e dyshemesë së kapeles është hequr dhe nën të u bënë disa gërmime të tjera: R. Gega, La chapelle de l'amphitheatre de Durres, "XI. corso di cultura sull'arte Ravennate e Bixantina", Ravenna 1993, f. 519-536.

ndryshme (tab. I, 8, fig. 3:2). Në njërën prej pllakave prej balte (fig. 3:2) ishte stampuar në reliev një monogram që mund të supozohet si i Herakliut I (610-641),[31] çka dëshmon se kjo kishë i është përshtatur strukturës së amfiteatrit ose është rindërtuar në kohën e sundimit të këtij perandori. Kjo e dhënë e re për këtë kapelë i bën më bindëse mendimet e shprehura nga studiues të ndryshëm mbi origjinën herakliane dhe datimin e mozaikëve të saj në shek. VII.[32]

Dyrrahu në dekadat e para të shek. VII kishte përfunduar shndërrimin e tij nga një qytet antik me strukturë urbane pagane në një qytet tipik bizantino-kristian. Ashtu siç ndodh gjithkund në qytete të tjera bizantine edhe në Dyrrah nga të dhënat arkeologjike, por edhe nga burimet historike rezulton se gjatë kësaj periudhe, me sa duket, pati një zhvillim të kufizuar të veprimtarisë ndërtimore, aq sa, në krahasim me ritmet e ndërtimeve të

[31] Sigla është e njëjtë me një nga monogramet e njohura të stampuara në monedhat e Herakliut: W Wroth, Imperial Byzantine Coins, Chicago, 1966, f. 661, nr. 207, 209. 221.

[32] J. Castrillo, L'énigme de la mosaïque de Durrës. "Archéologia" nr. 79, viti 1975, f. 82-83. Midis të tjerave, autori e daton mozaikun si të periudhës së dinastisë së Heraklidëve (610-711); M. Andolaro, I mosaici parietali di Durrazzo o dell'origine costantinopolitano del tema ikonografico di Maria Regina, "Studien zur spatantiken und Byzantinichen kunst", Teil.Ill, Monographicen der Romisch-Germanischen central museums, Band 10, Mainz 1986. f. 108 e daton mozaikun në periudhën preikonoklaste. Lidhur me këtë shih edhe mendimet e shprehura nga M. Zeqo në recensionin e këtij artikulli në "Iliria" 1989, 1, f. 283-286; M. Thierry. A propos de la mosaïque à Durrachium, "Cahiers Archeologiques" 1986, XVIII, f. 277-289; 1. Nikolojevic, Le sceau du Christ sur une mosaïque de Durres, "Zbornik za Likovne Umetnosti, Matica Srpska" 21, Novisad 1985. I-II; H. Nallbani, po aty.

mëparshme, ajo qe e papërfillshme dhe nuk e ndryshoi dot fizionominë e qytetit të periudhës paleokristiane.



Fig. 3.1, 3.2, 3.3

RESUME

DES DONEES ARCHEOLOGIQUES SUR LE CHRISTIANISME ANCIEN A DYRRACHIUM (IV-VII SIECLES)

Aux V-VI siècles Dyrrachium s'est transformée d'une ville à structure urbaine païenne en une ville typiquement byzantine chrétienne.

Au cours de la domination d'Anastase I" (de 491 à 518), la ville s'est dotée de murailles d'enceinte (tab. I, 6) qui entouraient une superficie de 80 hectares. Une place circulaire (tab. I, 7, fig. 2), quelques vestiges d'églises et de basiliques avec leurs éléments architectoniques attestent la présence d'un centre urbain et les traces d'un complexe episcopal des V-VI siècles.

La place circulaire, construite à l'époque d'Anastase I, a la forme d'un portique circulaire de 40 mètres de diamètre. Tout autour de cette place se situent un couloir en forme de galerie et un groupe de diverses constructions. Cette place ne présente pas de différence par rapport aux structures des marchés romains (voir citation 19). Quant à la composition, elle trouce une analogie avec un autre ensemble circulaire du début du VI' siècle à Tsaritsynegrad (citation 17).

Parmi les éléments architectoniques, les chapiteaux les plus anciens (tab. II, 5) appartiennent à une église de la fin du IV siècle ou du début du V. Les chapiteaux composites ioniens remontent aux environs de l'an 500, tandis que les impostes

champlevées semblent avoir été travaillées aux ateliers de l'époque de Justinien I (527-565).

Les nécropoles des IV-VII siècles se rencontrent à plusieurs parcelles (tab. I). Dans un des tombeaux du type en forme de chambrette (fin du IV siècle), des fresques ont été peintes sur les façades internes et, entre autres, même des chrismes (citation 2,4).

Sur certains ustensiles d'usage courant et sur des matériaux de construction qui remontent aux V-VI siècles, on distingue aussi des croix grecques, latines, patibulaires, etc. Sur un fragment d'assiette d'importation nord-africaine daté du VI siècle on voit le portrait de front du Christ (fig. 1). Ces données attestent que les propriétaires des vases ne sont plus des païens et que leurs idéaux spirituels sont liés au christianisme.

Les fouilles effectuées en 1987 à la chapelle de l'amphithéâtre (tab. I, 8; fig. 3:1) ont mis au jour le plancher pavé de dalles de marbre et de terre cuite (fig. 3:3). Sur l'une des plaques en terre cuite (fig. 3:2), le monogramme d'Héraclius (610-641) est estampé en relief, ce qui offre une nouvelle indication relative a l'époque de la construction ou de la reconstruction de la chapelle et soutient l'opinion liée à son origine héraclienne et à la datation de ses mosaïques du VII siècle (citation 28).

DISA TIPARE TË QERAMIKËS SË MESJETËS SË HERSHME NË SHQIPËRI (SHEK.VII-XI)[1]

Nga gërmimet arkeologjike të kryera në qendërbanimet dhe varrezat e periudhës së mesjetës së hershme në Shqipëri, krahas gjetjeve të tjera është përfituar edhe një lëndë e kufizuar me objekte të qeramikës.[2] (fig1)

Në disa prej qyteteve mesjetare (Dyrrhachion, Lissus, Pulcheriopolis, Kanina e gjetkë) është vërejtur se, për nevoja të punimeve të meremetimit, por edhe të ngritjes së godinave të reja, duke filluar nga shek. VII e në vazhdim janë bërë investime për prodhimin e materialeve të ndërtimit.[3]

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Disa tipare të qeramikës së mesjetës së hershme në Shqipëri (shek. VII-XI); Në: Iliria, vol. 29, 1999. fq.283-295; (https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1999_num_29_1_1717)

[2] S.Anamali, H.Spahiu, Varreza arbërore e Krujës, "Iliria" IX-X (1979 - 1980), f.57-59; D.Komata, Disa tipare karakteristike të qeramikës mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1969, f.221-243; Mbi disa dukuri të traditës në qeramikën shtëpiake të mesjetës së hershme shqiptare. "Iliria" 1, 1986, f.253-260; "Qyteti iliro-arbëror i Beratit", Tiranë 1990, f.306; F.Prendi, Një varrezë e kulturës arbërore në Lezhë, "Iliria", 1979-1980, IX-X, f.139-151; N.Bodinaku, Kultura e varrezës së hershme mesjetare shqiptare në luginën e sipërme të Vjosës të rrethit të Përmetit, "Iliria" 1, 1983, f.242-243; S.Aliu, Varreza mesjetare në tumën e Rehovës, "Iliria" 2, 1986, f.215-240. A.Hoti, Qeramika mesjetare e zbuluar në Durrës (Disertacion) Tirane 1990, f.3-126, Tab.1-XLVII.

[3] D.Komata, "Qyteti...", fig.37-44; H.Spahiu, "Qyteti...", f. 160; A. Hoti, Të dhëna arkeologjike për kristianizmin e hershëm në Dyrrah (shek. IV-VII), "Iliria" 1-2, 1996, f.178-179.

Midis objekteve që provojnë këtë prodhimtari janë edhe tullat me monograme të supozuara të perandorëve bizantinë, Maurik Tiberi (593-602)[4] e të Herakliut (610-641)[5], të gjetura në Dyrrachion. Zbulimi, gjatë viteve të fundit i një punishteje qeramike pranë Forumit Bizantin të këtij qyteti përbën një fakt tjetër që dëshmon se në dekadat e para të periudhës së mesjetës funksiononte një atelie shtetërore e prodhimit të qeramikës.[6] Ka shumë të ngjarë që prodhimet e kësaj punishteje edhe më vonë të kenë qenë ndër artikujt më të kërkuar në tregjet e Arkondisë e të Themës së Dyrrhacionit[7].

Gjatë gjysmës së parë të shek. VII, vihet re një pakësim i ndjeshëm i poçerisë së importuar. Me përjashtim të amforave të Gazës, të gjetura në Durrës[8] (fig.2) dhe ato të tipit Egloff 164-varianti 2, Carthage LRA 2 (zbuluar në Shkodër e Sarandë) që patën një qarkullim konstant deri në kapërxyellin e mesit të shek. VII[9] pjesa tjetër e tipeve mesdhetare nuk u futën ose nuk arriten te riprodhohen me ne asnjeren prej punishteve të provincave të atëhershme të Arbanonit.

[4] S.Anamali, Architettura e decorazione tardoantica in Albania "XL corso di cultura sull'arte Ravennate e Bizantina", Ravena 1993, pag. 451.

[5] "A.Hoti, Të dhëna..., f.179.

[6] "A.Hoti, Të dhëna..., f.178-180.

[7] "A.Hoti, Enë me glazurë nga qyteti i Durresit, "Iliria", 1, 1989, f.227.

[8] 'A.Hoti, Qeramika..., tab.II, 1-4, 8.

[9] 'G.Hoxha, Amfora antike të vona nga qyteti i Shkodrës (shek. V-fillimi i shek. VII) "Iliria" 1- 2, 1992, f.212-217; Y.Cerova, Kontributi i ri mbi amforat e kështjellës së Onhezmit, "Iliria" 1-2, 1992, f.246-248.


MALI I ZI
KOSOVA
Shkodër
Lezhë
Grazhdan
Krujë
MAQEDONIA
Durrës
DETI
ADRIATIK
Pogradec
Berat
Symizë
Tren
Ballsh
Shtikë
Rehovë
Vlorë
Kaninë
Piskovë
DETI JON
Sarandë
GREQIA
N
0 5 10 20 40 km

Fig. 1

Qeramika e periudhës së mesjetës së hershme e zbuluar gjer më sot në Shqipëri përfaqësohet nga enë të kategorive të ndryshme. Mbizotërojnë brokat, kotruvet, kanat e vorbat dhe disi më të pakta janë amforat, amforat-shtambë, oinohet etj.[10] Poçeria e kësaj kohe duke hedhur në qarkullin forma të reja enësh nuk hoqi dorë nga riprodhimi i disa tipe enësh (vorba, kana etj.) të periudhës së antikitetit të vonë.[11] Transmetimi i traditës së prodhimit të qeramikës provinciale romake në disa tipa të veçantë të enëve të periudhës së mesjetës së hershme nuk ka patur gjithë-herë karakterin e një huazimi të thjeshtë, por edhe një përpunim krijues duke dalë hera-herës edhe me forma të reja, karakteristike për rajonin bizantin të Adriatikut Jugor dhe atij Jonian. Midis enëve tipike qe mbartin elemente të reja jo vetëm në trajtimin tipologjik, por edhe në zbukurimin e tyre janë amforat dhe amforat-shtambë (tab.II,12-13). Pas hedhjes në qarkullim të këtyre eneve dolën gradualisht nga përdorimi edhe amforat mesdhetare të kohës antike të vonë.

Për zbukurimin e enëve të periudhës së mesjetës së hershme janë përdorur dy teknika: me gërricje dhe me pikturim (tab.I-II).

Zbukurimi me anën e teknikës së gërricjes është realizuar në trajtë hullizash paralele, drejtvizore dhe valëzuese. Kjo teknikë e njohur edhe në periudhat e mëparshme ndeshet në zbukurimin e kanave, oinoheve dhe të vorbave (tab.I, 2,7- 8; II, 1-18)

Zbukurimi me pikturim është bërë me penelata ngjyrë kafe dhe më rrallë me të kuqe. Stili më i zgjedhur për pikturim kanë qenë shiritat dhe kapilaret linjë drejta, të pjerrëta, valëzuese ose

[10] Shih referimet e citimit nr.1.

[11] D.Komata, Mbi disa dukuri..., f.253-260

të lakuara; trajtat e patkoit, njollat amorfe dhe rrallë herë motivet vegjetale. Kjo teknikë pikturimi është aplikuar gjerësisht te pjesa më e madhe e enëve të transportit, të kultit (broke, oinohe, kana e kotruve) të tryezës etj.(tab.1,1-4).

Stili i zbukurimit me shirita dhe kapilarë shpreh jo aq shumë vazhdimësinë e teknikës së zbukurimit, se sa një motiv dekorativ kultik. Duke patur vazhdimisht funksion atributativ kultik enët me motive të këtilla nuk u shterrën së futuri si objekte te mirë-fillta inventari në varret kristiane që nga faza Konstandiniane e deri në fund të shek.XI.

Motivet me linja kapilare tashmë me një rreze përhapje të gjerë në rajonet mesdhetare[12] dhe në ato qendrore evropiane sipas vendeve ku janë zbuluar kanë edhe veçoritë e tyre stilistike.

Për një njohje më të mirë të veçorive morfologjiko-tipologjike të disa prej enëve të periudhës së mesjetës së hershme po përshkruajmë shkurtazi kategoritë kryesore të tyre.

[12] "R.Hodges, H.Patterson, San Vincenzo al Volturni and the origins of the Medieval Pottery Industry in laly, "La ceramica medievale nel mediterraneo occidentale" Firence 1986, p.13-26; M.Retuerce-J.Zogaya, Variantes geograficas de la ceramica Omeya Ondalusi: los temas decorati vos, "La ceramica...", p.70-74; P.Peduto, Modalita e tipologia del quotidiano dallo studio della ceramica campana nell'alto Medioevo, "La ceramica...", p.555-558; J.Patterson, D. Whitehouse, The medieval domestic pottery, "Excavations at Otranto, Volume II; The finds", Lecce 1992, p.105-109, fig.6;6 (476-482); fig.6.7 (483-492).



Tab.I – Dyrrachion (2, 8, 11-13); Kroia (1, 3, 5-7, 9-10); Piskovë (4)



Tab. II – Dyrrachion (3-4); Kroia (18); Ballsh (16); Symizë (1-2); Rehovë (5, 8-15); Grazhdan (7)



Fig. 2

1. Amforat. *(Dyrrhachion, (fig.2; tab.I, 11).*

Kanë fakturë me ngjyrë kafe ose të kuqërremtë herë-herë me nuanca të çelura në rozë. Trupi i tyre në të shumtën e rasteve është i zbukuruar me kanelyra me linja të gjera ose të ngushta. H.42-52 cm.

Pjesa më e madhe e amforave kanë qarkulluar në pellgun Adriatiko-Jonian gjatë periudhës së shek. VIII-XI/XII.[13]

Një numër jo të vogël përbëjnë edhe fragmentet e pikturuara me shirita në ngjyrë kafe të murme ose të kuqe.[14] Ato paraqesin motive me linja të c'rregullta ose harqe e spirale që ndeshen dendur në disa tipe amforash të gjetura në Dyrrachion , Kroia, Lissus, Përmet, Gjirokastër etj. Edhe këto fragmente i përkasin periudhës kohore midis shek. VIII-XI1.[15]

2.Amfora-shtambë *(Dyrrhachion, fig.3; tab.I,12-13).*

Përfaqësohen nga enë të plota dhe nga një numër i madh me fragmente. Faktura e tyre ka ngjyrë kafe të çelur ose okër me nuanca rozë. Faqet e tyre janë zbukuruar me kanelyra të gjera. Këto enë janë gjetur në kontekste stratigrafike që datohen midis shek.IX- XI'.[16] H.35-40 cm. Disa fragmente amforash-shtambë janë gjetur edhe në shtresa kulturore të shek. VII-VIII.[17] Midis tyre ka edhe asish që janë zbuluar të shoqëruara me monedha të fundit të shek.X- fillimi i shek. XI[18].

3.Broket *(Kroia; tab.I, 9-10).*

Fakturë prej argjile të pastër, të pjekur në ngjyrë kafe të errët ose të çelur në okër. Sipërfaqet e brokeve janë të zbukuruara me

[13] A.Hoti, Qeramika tab.II-IV
[14] A.Hoti, Qeramika..., tab. VI.
[15] S.Anamali, H.Spahiu, Varreza arbërore..., f.57-58, V,1-4; F.Prendi, Varreza..., f.249 I, 14; D.Komata, Gjurmë të antikitetit ilir dhe të mesjetës në kalanë e Gjirokastrës, "Iliria" 2, 1988, f.175, III, 10-27.
[16] A.Hoti, Qeramika..., f.29.
[17] Po aty, f.30.
[18] "Po aty, f.29-30.

breza hullish paralele dhe me thellime të parregullta. H.9.8.-12.5 cm. Broket janë datuar në shek. VII-IX.[19]



Fig. 3

4.Oinohetë. *(Kroia; (tab.1,3,5,7).*

Fakturë me ngjyrë okër me nuanca rozë. H.13-22.5cm. Në Kroia datohen midis shek. VI-VIII,[20] ndërsa në Lissus jane të shoqëruara me një tokëz të tipit "Korinth" (vitet 640/680 deri në fund të shek. IX)[21]

[19] F.Prendi, Njē varreze. f. 129-140; A. Hoti, Qeramika..., f.40-41.
[20] S.Anamali, H.Spahiu, Varreza arbërore..., "Iliria" 6,4, f.98.
[21] F.Prendi, Nje varreze..., f.151, V,11.



Fig. 4

5. Kotruvet *(Dyrrhachion, Kroia, Piskovë, tab. 1,2,4,6,8).*

Janë enët që ndeshen më shumë në inventaret e varreve, ndërsa në vendbanime hasen më rrallë. Kanë fakturë ngjyrë kafe në të verdhë. Sipërfaqet zakonisht të lustruara janë të zbukuruara me pikturim shiritash të çrregullt ose të gërricura me hulliza H.14-21 cm. Enët janë datuar midis shek. VII-IX[22] Në nekropolin kristian të Dyrrhachionit njëra prej enëve kotruve, ashtu si-kundër edhe në Lissus, është gjetur e shoqëruar me një tokëz të tipit "korinth"[23]

6. Tasa *(Dyrrachion, fig.5).*

Fakturë në ngjyrë kafe të hapur. Faqja e brendëshme e pikturuar, me shirita kafe në trajtë patkoi ndërsa në syprinën e buzëve me grupe shiritash H.6,5cm, Ø.204. Tasi është gjetur në Osteotekën e amfiteatrit së bashku me një monedhë të Vasilit II (976-1025),[24]

7. Vorbat *(Dyrrhachion, Krujë, Ballsh, Grazhdan, Symize, Tren, Piskovë, Rehovë, Shtike; tab.II,1-18).*

Janë punuar me çark por ka edhe të punuara me dorë. Një pjesë e tyre janë të ornamentuara me teknikën e gërricjes. H.7.4-14,1 cm.

[22] A.Hoti, "Qeramika..." f.34; S.Anamali, H.Spahiu, "Varreza arbërore...", f.78-79,98, VI,1-2; D.Komata, "Të dhëna të reja arkeologjike nga kalaja e Krujës", "Iliria", 1, 1982, f.230, 20.4 II 1-2; F.Prendi, "Një varrezë..." f. 139; N.Bodinaku, "Kultura e varrezes..," f.249, 1,14.

[23] F.Tartari, "Një varrezë e mesjetës së hershme në Durrës", "Iliria" 2, 1984, f.247, II.

[24] H.Bllaca, Durrës (Amfiteatër)."Gërmime arkeologjike të vitit 1987", "Iliria" 2, 1987, f, 262-263.



Tab. 5

Tipi i vorbave pa vegje dhe me një ose më shumë vegje ndeshet gjatë gjithë periudhës së mesjetës së hershme.[25]

[25] A.Hoti, Qeramika...,f.242-244, I, 13; S.Aliu, Varreza mesjetare...,f.230, II,23; III, 47,52-53; VI, 95-100; VIII, 112-117.

Disa imtësi stilistike për zbukurimin e vorbave janë ndër motivet karakteristike për dekorin bizantin të rajonit Arbanoi. Krahas prodhimit vendas, si rrjedhojë e pushtimeve, në këtë rajon depërtuan edhe një seri vorbash të poçerisë bullgare (tab. II, 4, 13)[26]

Repertori i enëve të periudhës së mesjetës së hershme në Shqipëri në aspektin morfologjik përfaqësohet nga një seri me forma të reja. E ndërsa në aspektin tipologjik poçeria pati një evoluim të konsiderueshëm nga pikëpamja stilistiko-dekorative, ndryshimet ishin të pjesshme. Në teknikën e zbukurimit të enëve mesjetare u ruajtën për një kohë të gjatë mjaft motive karakteristike të kohës antike të vonë.

Pjesa më e madhe e amforave, kotruveve, brokave, kanave dhe oinoheve janë zbuluar në disa qendërbanime (Kroia, Lissus, Puleheriopolis, Byllis etj) që historikisht kanë qenë përfshirë në rrethin administrativ e kulturor të Arhondisë, e më vonë të Themës së Dyrrhachionit.[27] Andaj ekziston mundësia që këto enë të jenë prodhime të këtij qyteti, që në atë kohë (shek. VII-X) cilësohej si një atelie e natyrës së mirëfilltë bizantine, nga më të rëndësishmet në territorin Arbanoi.

[26] S.Aliu, Varreza mesjetare.... Tab. VII,114.
[27] J.Ferluga, Droc i njegova oblast od VI do pocetka XIII veka "Glass" CCCXL III, 1986, 73-75.

SOME FEATURES OF THE EARLY MEDIEVAL POTTERY IN ALBANIA (7th-11th CENTURIES)

A limited quantity of pottery has been in the archaeological excavations that have been carried out so far in settlements and tumuli of the early Middle Ages in Albania, as well as other finds,

From the 7th century onwards, the production of building material in certain medieval cities (Dyrrhachion, Lissus, Pulcheriopolis, Kanina etc) was not just confined to the repair needs of older structures, but was also extended to the construction of new ones. [Komata 1991: fig. 37-44; Spahiu 1990:160; Hoti 1996: 178-179].

Among the objects that testify to such a production are monogram bricks of the Byzantine emperors Maurice Tiberi (543-602) [Anamali 1993: 451] and Heraclius (610-641) [Hoti 1996: 179], both found in Dyrrhachion. The recent discovery of a pottery workshop next to the Byzantine Forum in this city highlights the fact that a state pottery workshop was fully functional during the first decades of the Middle Ages [Hoti 1996: 178-180]. It seems most likely that its products would have been among the most wanted articles in both Arkondia and Them's markets of Dyrrhachion. During the first half of the 7th century a drastic reduction in imported pottery can be observed. Except for amphoras from Gaza, (e.g. loff 164 variant 2 Carthage LRA 2), or any other vessel that had a constant circulation until the turn of 7th century [Hoxha 1992: 212-217; Cerova 1992: 246-248], the Mediterranean types were not produced or re-

produced in any of the pottery workshops that were run in the territory of Albania (Arbanoi) (fig. 1)

Pottery of the early Middle Ages discovered so far in Albania is represented by vessels of various types. Water-jugs, jars, water-bottles and bowls seem to prevail, whereas amphora's, amphora-pitchers and oinochoes, are rather fewer in number. Pottery workshops of this period kept on putting in circulation new types of vessel but they did not stop reproducing some very traditional vessels such as bowls, water-bottles etc. that date back to Late Antiquity.

Borrowings from the Roman provincial potteries of a few special types of vessels during the early Middle Ages can hardly be called a mere imitation, because there appears a creative tendency whereby every now and then pottery workshops turned out quite new patterns that are most characteristic of the Byzantine region of the southern Adriatic and Ionian basin.

Amongst the most typical vessels that have new elements, not only in their typological treatment but also in their decoration, are the amphoras.(tab 1,12-13) After they had been put in circulation, the Mediterranean amphoras of Late Antiquity gradually went out of use.

Two kinds of technique appear to have been used in decorating vessels during the early Middle Ages, namely:

1.scratching

2.painting (table I-II).

The first technique produced a pattern of parallel, straight and wavy incisions. This technique, known from earlier times, was widely used in the decoration of water-pots, vases (pots) and oinochoes.(table. I, 2,7-8; II, 1-18).

Painted decoration was obtained by brawn brushstrokes and less by red ones. The preferred style seems to be either straight ribbons and capillaries or oblique, wavy and pliable ones, horse-shoe patterns, amorphous spots and at times plant motifs. This painting technique was widely and mostly used on transport or everyday vessels like water jugs, oinochoes, water-bottles, jars etc. (tab I, 1-4)

The style of decoration with ribbons and capillaries does not express the continuity of such a technique, but is a Christian decorative motif. Showing continuously a cultural particularity, vessels with this motif never ceased to be placed as authentic objects of inventory in Christian tombs from the time of Constantine to the end of 11th century. Motifs with capillary lines appear to have been widespread in the Mediterranean world and, from what have come out to light so far, have their own stylistic characteristics. [Hodges 1986: 13-26; Retuerce 1986: 70-74; Peduto 1986: 555-558; Patterson 1992: 105-109, fig. 6:6 (476-482); fig. 6:7 (483-492)].

We would like to describe briefly the chief types of vessels of the early Middle Ages, in order to clarify their morphological traits.

1.Amphoras *(Dyrrhachion, Lissus, Scodra fig. 2; tab.1,11)*

They are in brown or reddish and at times light pink shades. Their structure is often decorated with wide or narrow grooves. H.42-52 cm.

A great quantity of such amphoras was in circulation in the Adriatic-Ionian basin during 7-11 and 12th centuries. [Hoti 1990: tab II-IV]. A significant number also form the painted fragments in brown, grey or red ribbons [Hoti 1990: tab VI]. They have

motifs with irregular lines or arcs and spirals that are mostly found in Dyrrhachion, Kroia, Lissus, Përmet, Gjirokastër, etc. However, these fragments date back to 8th-11th centuries. [Anamali 1980: 57-58, V, 1-4; Prendi 1980: 139, XXIV, 3; Bodinaku 1983: 249, I, 14; Komata 1988: 175, III, 10-27.]

2.Pitcher-amphoras *(Dyrrhachion, fig. 3; tab. I: 12-13).*

These consist of complete vessels while the rest have a lot of fragments. They are in light brown or ochre with some pink shades. Their faces are decorated by wide grooves. These vessels have been discovered in stratigraphic contexts that date back to the 9-11th centuries. [Hoti 1990: 29]. H. 35-40 cm.

Some other fragments from pitcher-amphoras have been found in cultural levels that date back to the 7th-8th centuries. [Hoti 1990: 30]. There are also some others that have been found together with coins that date back to the end of 10th or the beginning of 11th century. [Hoti 1990: 29-30].

3.Water-jugs. *(Dyrrhachion, Lissus; tab. I, 9-10).*

These are of fine clay, fired in both dark brown or ochre. Their surfaces are decorated with parallel-belt incisions with irregular thicknesses. H. 9.8.-12.5 cm. They date back to the 7th-9th centuries.[Prendi 1980: 139-140; Hoti 1990: 40-41].

4.Oinochoes. *(Dyrrhachion, Kroia, Lissus; (tab. 1,3,5,7).*

They are in ocher with some pink shades. H. 13-22.5 cm. The ones found in Kroia date back to the 6th-8th centuries. [Anamali 1980: 98, VI, 4] while the Lissus one has a "Corinth"-type clasp (640/680 to the end of the 9th century). [Prendi 1980: 151, V, 11]

5. Jars. *(Dyrrhachion, Kroia, Lissus, Piskove; tab 1,2,4,6,8).*

These are vessels that are mostly found in necropoli, and very rarely in settlements. They are brown-yellow. Surfaces often appear to be lustrous and decorated with irregular ribbons or scratched motifs. H.14-21 cm. They date back to the 7th-9th centuries. [Hoti 1990: 34; Anamali 1980: 78-79, 98, VI, 1-2; Komata 1982: 230, II, 1-2; Prendi 1980: 139; Bodinaku 1983: 249, I, 14]. The jar found in the Christian cemetery of Dyrrhachion also has a "Corinth"- type clasp that dates back to 640/680 and continues up to the 9th century.[Tartari 1984: 247, II; Prendi 1980: 151, V, 11].

6. Bowls. *(Dyrrhachion fig. 5)*

These are in light brown. The inner face is painted with brown ribbons and has a horse-shoe form while the upper lip is full of ribbons. H.6.5 cm; p. 20.4. This bowl has been discovered in the amphitheater's ossuary, together with a coin of Basil II (976-1025). [Bllaca 1987: 262-263].

7. Vases. *(Dyrrhachion, Piskove, Rehove; tab. II, 1-18)*

These have been produced by hammer technique or by handicraft. Some of them have one or more handles while the rest that can be dated back to the early Middle Ages are without any. [Hoti 1990: 47-48; Bodinaku 1983: 242-244, I, 13; Aliu 1986: 230, III, 47, 52-53, II, 23, VI, 95-100, VII, 112- 117.]. The repertory of the early Middle Ages' vessels in Albania in the morphological aspect is represented by a bulk of new forms. While the typological aspect of pottery advanced considerably, its stylistic-decorative changes were simply slow and partial. Besides, the decorative techniques of medieval vessels preserved motifs characteristic of Late Antiquity for a fairly long time.

The greater part of amphoras, jars, water-jugs, water-bottles and oinochoes was discovered in settlements like Kroia, Lissus, Pulcheriopolis, Byllis etc. that, historically were included in the cultural administrative district of Arkondia (Aechontai), and later in the theme of Dyrrhachion, [Ferluga 1986: 73-75], hence it seems most likely that all these vessels should be the property of this city, which was considered during the 7th-10th century as a workshop of a genuine Byzantine nature, one of the most important in Albanoi territory.

A few stylistic details of the decoration are among the most characteristic motifs in relation of the Byzantine décor in Albanoi area. In parallel with the local products, some types of Bulgarian pottery were also introduced, due to a series of conquests of this region.[Aliu 1986: VII, 114] (PL. II: 4, 13 table.II, 4, 13).

PLASTIKË ARKITEKTONIKE DEKORATIVE PALEOKRISTIANE NGA QYTETI I DURRËSIT[1]

Plastika arkitektonike dekorative paleokristiane e qytetit të Durrësit është pasqyruar tashmë pjesërisht në disa informacione e artikuj të karakterit të përgjithshëm.[2] Si një trajtesë më vehte, jo vetëm e plotë por edhe e përmirësuar metodikisht ky shkrim në formë katalogu, përbën punimin e parë të këtij lloji.

Disa prej elementeve arkitektonike dekorative vijnë nga Macelllum i fillimit të shek. VI (nr. 9-12, 26-27), zbuluar vitet e fundit në qendër të qytetit të Durrësit,[3] ndërsa pjesa tjetër e koleksionit është gjetur gjatë gërmimeve të rastit në objektet e kultit që, me sa duket, i përkasin grupit episkopal të periudhës së antikitetit të vonë.[4]

Plastika dekorative arkitektonike e Durrësit ka vlerë të veçantë jo vetëm se paraqitet mjaft e larmishme tipologjikisht, por edhe për faktin se prej saj mund të nxirren të dhëna të tërthorta për rindërtimin hipotetik të disa prej ngrehinave nga të cilat ajo vjen.

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Plastikë arkitektonike dekorative paleokristiane nga qyteti i Durrësit; Në: Iliria, vol. 27, 1997. fq.325-347; *(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727 2548_1997_num_27_1_1685)*

[2] Meksi 1983:32, 12; Albanien 1985:24, 27-28; Albanien 1988:358; Kabashi 1989:150; Anamali 1993:436, 1-5.

[3] Hoti 1996: 177-178.

[4] Hoti 1996: 177.

Kapitelet, impostet dhe bashkë me to pllakat dekorative të kangjellave në trajtimin e tyre artistik janë mbështetur kryesisht në modelet e njohura të atelieve më të përparuara të kohës. Pjesa më e madhe e tyre është importuar nga Prekonezi, por nuk mungojnë ekzemplarë që janë skalitur duke përdorur gurin e zakonshëm gëlqeror të vendit tonë.

Duke iu përmbajtur veçantive morfologjiko-stilistike, dhe klasifikimit tipologjik që kanë bërë autorë të tjerë, (shih citimet e referuara në katalog), prej më shumë se 30 ekzemplarë të kësaj plastike kemi arritur të evidentojmë disa tipa kapitelesh dhe impostesh.

a) Kapitelet e tipit korintik (nr. 1-4) i kanë faqet e tyre të stolisura me akanthe gjuhëshpërvjela, ndërsa vrimat e trapanit përbëjnë një nga imtësitë dalluese të dekoracionit të tyre.

Ky tip ka gjetur përdorim nga fundi i shek. IV deri në fund të shek. V (shih citimet e referuara në katalog).

b) Kapitelet e tipit kompozit (nr. 6-12) janë daltuar me akanthe gjetheshtrira, të harmonizuara me rradhë që imitojnë pseudotrapanin. Në këtë koleksion dallohen kapitelet e tipit kompozit-jonik (nr. 9-12) ku poshtë kymave në çdo faqe dalin dy voluta.

Dy prej elementeve të këtij tipi në syprinat e abakëve përmbajnë mbishkrime (nr. 9-10).

Kapitelet e tipit kompozit i përkasin kohës së sundimit të perandorëve Anastasit I - Justinianit I (rreth viteve 500-560) (Shih referimet e cituara në katalog).

Midis kapiteleve ka edhe dy ekzemplarë që përfaqësojnë tipa të rrallë:

c) Njëri prej tyre (nr. 5) është i tipit me gjethe të shpupurisura ("windverwehten").

ç) Tjetri (nr. 13) i përket tipit me protome kafshësh ("zwei-zonen-kapitell mit Tierprotomen").

Kapitelet e dy tipave të fundit, që datohen jo më vonë se fundi i shek.V, kanë pasur një rreze të ngushtë përhapjeje jo vetëm në Dyrrachion, por edhe në qytete të tjera të provincës së Epirit të Ri.[5]

d) Impostet përbëjnë numrin më të madh të koleksionit (nr. 14-29). disa prej tyre të zbukuruara me gjethe akanthi dhe kryqe të tipeve të ndryshme (nr. 14-18) janë përcaktuar si impost-kapitele'[6] të gjysmës së parë të shek. VI. Ndërsa elementët e tjera të këtij grupi që përmbajnë voluta i kemi klasifikuar si imposte të tipit jonik (nr. 19- 21).

Në koleksionin tonë përfshihen: e) një fragment frizi (nr. 30) dhe: f) dy pllaka kangjeli (nr. 31-32) që, për nga teknika e punimit, u takojnë gjysmës së dytë të shek. V dhe jo më vonë se viti 500"[7]

KAPITELE

I. Kapitele të tipit korintik (nr. 1-4)

1. Kapitel i tipit korintik (tab. 1, 2)

Baza mbajtëse: 35,5 x 35 x 5 cm, Baza mbështetëse: Ø 36,5 cm, Lartësia: 40 cm.

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.

[5]Hoti 1996:177 Muçaj 1987:200, Cerova 1993:273-284.

[6] Cultura 1971:46.

[7] Shih citimet e referuara në katalog.

Kapiteli ka formën e një trungu cilindrik. Pjesa e poshtme e zbukuruar me dy radhë akanthesh me maja të rrumbullakuara. Në pjesën e sipërme të trungut dalin gjethe zambaku. Kymaja në trajtën e një shiriti harkor me një nyjë në mesin e saj.

Ky kapitel është një tip i përdorur në bazilikat civile[8] dhe në katakombet e hershme në Itali, [9] pa përjashtuar rastet e përdorimit në kishat e hershme kristiane të fundit të shek. IV.[10]

2. Kapitel i tipit korintik (tab.1,1).

Baza mbajtëse: 38,5 x 38,5 cm, Baza mbështetëse: Ø 36 cm, Lartësia: 36 cm.

Lënda: Mermer.

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.

Kapitel në formë trungu cilindrik. Pjesa e poshtme e zbukuruar me një radhë gjethesh akanthi gjuhëshpërvjelura. Nën buzën e kymës një rozetë disapetalëshe, anash saj dy bisqe simetrike.

Është një tip i rrallë që ndeshet në kishat e hershme kristiane të Konstandinopojës, Salonës e gjetkë.[11] Disa elemente të tij gjejnë paralele edhe me kapitelet e kishave të hershme italike.[12]

3. Kapitel i tipit korintik (tab. II, 3; fig. 1).

Baza mbajtëse: 45 x 45 cm, Baza mbështetëse: Ø 31 cm, Lartësia: 45 cm.

Lënda: Mermer

[8] Belloni 1958, 1958, nr. 25.

[9] Pensabene 1973, nr. 293; Norman, 1988, nr. 13, fig. 24-26.

[10] Heilmeyer 1970, tab. 48, 1-4.

[11] Kautzsch 1936, II, 13, XV, 203.

[12] Shih citimin 9.

Vendi i zbulimit: Pranë ish tregut të qytetit.

Kapiteli ka formë të një trungu cilindrik me dy rradhë akanthesh majëmprehta. Në katër cepat e kymës janë gdhendur katër voluta të mëdha që, në çdo faqe, përfshijnë midis tyre tri ove.

Ekzemplarët më të hershëm të këtij tipi kanë filluar të duken në fund të shek. IV.[13] Por në rrethanat e gjetjes ky tip datohet në mesin e shek. V.[14]



Fig. 1

4. Kapitel i tipit korintik (tab. II, 4) Baza mbajtëse: 43x43 cm

Baza mbështetëse: 30 cm, Lartësia:

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.

Ngjason me nr. 3.

[13] Kautzsch 1936, XXIV, 375.

[14] Meksi 1983, f. 32, fig. 12; Kabashi 1989, f. 150, fig. 3; Albanien 1985, f. 23, fig. 27.

Disa imtësi tipologjike e përafrojnë me një ekzemplar tjetër nga Salona.[15] Kësisoj ky kapitel datohet në shek. V.

II: 5. Kapitel i tipit me gjethe "të shpupurisur" ("windverwehten") (tab. I, 4).

Baza mbajtëse: 47 x 47 cm

Baza mbështetëse: Ø 30 cm Lartësia: 33 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Lagjia Nr. 11, Rr. "D. Tabaku".

Murosur në fasadën e banesës nr. 24".[16] Megjithëse 3/4 e tij janë brenda murit, i duken qartë akanthet me gjuhë pak të shpërvjelë. Kyma mbyllet me valutat, dy krahët e të cilave zbresin simetrikisht përgjatë trungut.

Ky tip ka një rreze përhapjeje të gjerë, por më tepër haset në interieret e kishave të Salonës, Romës, Egjiptit, e gjetkë gjatë periudhës së fundit të shek. IV.[17]



Fig. 2

[15] Kautzsch 1936, tab. I, 1.

[16] Zeqo 1985, f. 57, fig. 24.

[17] Kautzsch 1936, I, 1, VIII, 108, Lla.

III. Kapitele të tipit kompozit (nr. 9-12).

6. Kapitel i tipit kompozit (Tab. I, 3; fig. 2)

Baza mbajtëse: 1,30 x 1,30 m

Baza mbështetëse: Ø 87 cm, Lartësia: 89 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti (përdorur edhe si grykë pusi).

Modeluar me përmasa jo të zakonshme në formën e një trungu konik. I zbukuruar me tri radhë akantesh majëmprehta, me gjuhë paksa të shpërvjelë nga jashtë. Kyma ka formën e një kornize të trashë e ravizuar me dy kanelyra.

Kapiteli datohet në gjysmën e dytë të shek. V - fillimin e shek. VI.[18] Përmasat e mëdha na lejojnë të mendojmë se mund të ketë pasur edhe funksionin e impostit. Thuajse në të njëjtën kohë tipi në fjalë është përdorur edhe në kishat e provincave të tjera të Bizantit, si në Egjipt etj..[19]

7. Kapitel i tipit kompozit (tab. III, 3)

Baza mbajtëse: 63 x 57 cm

Baza mbështetëse: Ø 42 cm, Lartësia: 48,5 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.

Kapitel i gdhendur në formën e një trungkoni. Faqja e jashtme e zbukuruar me dy radhë akanthesh majëmprehta. Kymaja e stolisur me kanelyra, ne mesin e saj hapet në formën e zemrës brenda së cilës stilizohet përsëri akanthi.

[18] Meksi 1983, f. 32, fig. 13.

[19] Kautzsch 1936, VIII, 112, IX, 132, 138, XIV, 184.

Është një kapitel që ka gjetur përdorim të gjerë në kishat e bazilikat paleokristiane të Maqedonisë, Greqisë, Rumanisë e sidomos në Konstandinopojë".[20]

8. Kapitel i tipit kompozit (tab. III, 2, fig. 3).

Baza mbajtëse: 60 x 60 cm

Baza mbështetëse: Ø 44 cm, Lartësia: 43 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.

Të dhënat e tjera si nr. 7.



Fig. 3

9. Kapitel i tipit kompozit (tab. II, 1)

Baza mbajtëse: 72 x 72 cm

Baza mbështetëse: Ø 56 cm Lartësia 57 cm

Lënda: Mermer

[20] Kautzsch 1936, XIV, 184, 195 XVI 226: Lemerle, 1945, XII, XXVIII, 6-7; Cultura 1971, nr. 27, 28.

Vendi i zbulimit: Macelllum i fillimit të shek. VI të erës sonë.

Trung cilindrik i qarkuar me dy rradhë akanthesh majëmprehta. Në katër cepat e kymës janë gdhendur katër valuta, ndërsa ndërmjet tyre dalin gjetheza tripetalëshe. Në një kënd të suprinës së abakut janë gdhendur germat greke I X K V.

Kapitele të këtilla ndeshen në shumë kisha paleokristiane. Në fund të shek. V këto element arkitektonik kanë gjetur përdorim të dukshëm në orderet e interierëve të bazilikave maqedone,[21]por edhe në Egjipt e gjetkë.[22]

10. Kapitel i tipit kompozit (tab. II, 2)

Baza mbajtëse: 72 x 72 cm

Baza mbështetëse: Ø 54 cm Lartësia: 57 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Macelllum i fillimit të shek. VI të erës sonë. Në pjesën e syprinës së abakut janë gërvishtur germat T P. Të dhënat e tjera si nr. 9.

11. Kapitel i tipit kompozit-jonik (tab. III, 4)

Baza mbajtëse: 69 x 69 cm

Baza mbështetëse: Ø 50 cm, Lartësia: 52 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Macelllum i fillimit të shek. VI të erës sonë. Të dhënat e tjera si nr. 9 e 10.

12. Kapitel i tipit kompozit (tab. III, 1)

Baza mbajtëse: 71 x 71 cm

Baza mbështetëse: Ø 54,4 cm, Lartësia: 58 cm

[21] Lemerle 1945, XI.

[22] Kautzsch 1936, VIII, 107-108, 112; XIII, 117.

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Macelllum i fillimit të shek. VI të erës sonë.

Të dhënat e tjera si nr. 9-11.

IV: *13. Kapitel i tipit me protome kafshësh ("Zwei-Zonen-Kapitell mit Tierprotomen") (fig. 4)*

Baza mbajtëse: 46 x 46 cm

Baza mbështetëse: Ø 37 cm, Lartësia: 42 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Kapitel i punuar në formë trungu cilindrik. Me gdhendje dhe me trapan është kompozuar një rradhë me akanthe gjuhë-shpërvjela. Mbi nivelin e gjetheve në katër cepat e kymës dalin dukshëm protomet e qengjave dhe të një kafshe tjetër të paidentifikuar. Suprina e abakut ka formë katërkëndëshe.

Është një kapitel që ndeshet jo rrallë në kishat e ndërtuara gjatë kohës së Anastasit I (491-518). Ekzemplari ynë lidhet më shumë me tipet e prodhuara rreth vitit 500.[23]

V. Impost-kapitele (nr. 14-18)

14. Impost- kapitel (tab. IV, 3)

Baza mbajtëse: 70,5 x 55,5 cm

Baza mbështetëse: 45 x 36 cm

Lartësia 36 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

[23] Cultura 1971, f. 106, fig. 31; Kautzsch 1936, XXX, 494; Theodo-resku 1963, f. 273, fig. 13,1; Albanien 1988, f. 445-446, fig. 358.

Punuar në formë trungkoni. Në njërën faqe me shomplevë (1,5 cm) janë gdhendur: një kryq grek me apicese dhe anash tij akanthe fletëgjerë me majë.

Këto imposte njihen si tipa mjaft të njohura në objekte kulti të Turqisë, Greqisë, Sirisë, Palestinës gjatë shek. V-VI,[24] por një aplikim të dukshëm stilet e dekoracionit të tyre patën në atelietë e kohës së Justinianit 1.[25]



Fig. 4

15. Impost-kapitel (tab. IV, 5)

Baza mbajtëse: 70 x 55 cm

Baza mbështetëse: 41,5 x 41,5 cm., Lartësia: 35 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.

Punuar në mermer në formë trungkoni. Në njërën faqe i daltuar me shomplevë (1,5 cm) një kryq latin me apicese. Të dhënat e tjera si nr. 14.

[24] Boyd 1982, f. 313.

[25] Maguire 1989, f. 161-171.

16. Impost-kapitel (tab. IV, 1)

Baza mbajtëse: 75 x 70 cm

Baza mbështetëse: 48 x 48 cm, Lartësia: 32 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Punuar në formë trungkoni. Në njërën faqe të gdhendur me shomplevë dhe me trapan të thellë (deri 3,5 cm), akanthet majëmprehtë si dhe kryqi latin brenda një rrethi. Në faqen tjetër po me të njëjtën teknikë janë bërë vetëm akanthe. Të dhënat e tjera dhe datimi si nr. 14 e 15.

17. Impost-kapitel (tab. IV, 4)

Baza mbajtëse: 1,10 x 0,90 m

Baza mbështetëse: 0,82 x 0,55 m Lartësia: 40 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti Të dhënat e tjera si nr. 16.



Fig. 5

18. Impost-kapitel (tab. IV, 2; fig. 5)

Baza mbajtëse: 1,10 x 1,10 m

Baza mbështetëse: 0,76 x 0,76 cm Lartësia: 0,57 m
Lënda: Mermer
Vendi i zbulimit: Gjetje rasti.
Të dhënat e tjera si nr. 16

VI. Imposte (nr. 19-29)

19. Impost i tipit jonik (tab. V, 2)

Baza mbajtëse: 58 x 40 cm
Baza mbështetëse: Ø 36 cm, Lartësia: 27 cm
Lënda: Mermer
Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Punuar në formë trungkonike. Në mesin e njërës faqe një kryq grek në reliev, poshtë të cilit një bisk harkor që përfundon në skaje me gjethe zemre.

Në dy skajet e bazës së trungut dy voluta. Hapësira ndërmjet volutave e zbukuruar me motivin e rrethit.

Kapitele-imposte të këtilla që hasen në kishat e Maqedonisë, Rumanisë, Greqisë e gjetkë, janë datuar në fillim të shek. VI[26]

20. Impost i tipit jonik (tab. V. 4; fig. 6)

Baza mbajtëse: 48,5 x 40 cm
Baza mbështetëse: 35,5 x 31,1 cm, Lartësia: 20,5 cm
Lënda: Mermer
Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

[26] Lemerle 1945, VI, d,c, XXVIII, 10; Cultura 1971, f. 107, nr. 36; Grabar 1963, Pl. 42:2.



Fig. 6

Punuar në formë trungkonike. Në njërën faqe një kryq latin me apicese. Anash tij janë gdhendur simetrikisht dy motive "S"-je. Pjesa fundore në dy skaje ka dy voluta. Në hapësirën midis volutave janë modeluar ovat dhe kola.

Ky tip kapiteli ka ngjashmëri me ekzemplarë të tjerë të shek. VI që hasen në kishat e tjera të provincave bizantine".[27]

21. Impost i tipit jonik (tab. V. 3.fig. 7)

Baza mbajtëse: 72,5 x 47 cm

Baza mbështetëse: 42 cm, Lartësia: 30 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Modeluar në formë trungkonike. Në njërën faqe kyma e saj është zbukuruar me bisqe e gjethe-zemre. Poshtë kymës janë gdhendur akanthe majërrumbullakëta. Në dy skajet e bazës dy voluta dhe midis tyre motivi i oves.

Këto imposte janë përdorur në kishat e shek. VI erës sonë".[28]

[27] Lemerle 1945, XXVIII, 13, Cultura 1971, f. 107, fig. 36.

[28] Kautzsch 1936, XXXIII, 335, 336; XXXVI, 568, 583; Cultura 1971, fig. 36.

22. Impost (tab. VI, 2; fig. 8-9)

Baza mbajtëse: 55,5 x 30 cm

Baza mbështetëse: 32 x 19 cm Lartësia: 28 cm

Lënda: Gurë gëlqeror

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Në njërën faqe është gdhendur një kryq latin me apices. Në dy krahët e kryqit, dy shpendë të vendosur përballë me njëri-tjetrin duke çukitur. Në faqen tjetër brenda një kordeleje rrethore një rozetë 9 petaleshe në reliev. Poshtë kordeles një bisk gjysmërrethor me gjethe trifletëshe.

Paraqitja ballë për ballë e shpendëve është karakteristike për motivet e zbukurimit të plastikës dekorative të shek. VI.[29]



Fig. 7

23. Impost (tab. VII, 1)

Baza mbajtëse: 44 x 29 cm

Baza mbështetëse: 24 x 20, cm Lartësia: 18 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Në njërën faqe një kryq grek i modeluar në reliev me apicese disi të dukshme.

[29] Lemerle 1945, VI, c.

Edhe ky impost datohet në fillimet e shek. VI.[30]

24. Impost (tab. VI, 1)

Baza mbajtëse: 52 x 34 cm

Baza mbështetëse: 35 x 13 cm, Lartësia: 15 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Në njërën faqe një kryq latin me apicese.

Të dhënat e tjera si nr. 23.

25. Impost (tab. VI, 3)

Baza mbajtëse: 68 x 35 cm

Baza mbështetëse: 40 x 20 cm, Lartësia: 30 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Në njërën faqe një kryq grek me apicese. Edhe ky impost datohet në fillimet e shek VI.[31]



Fig. 8

[30] Lemerle 1945, XXXI, 27.

[31] Lemerle 1945, XXVIII, 4.

26. Impost (tab. VII, 3)

Baza mbajtëse: 1,04 x 0,72 m

Baza mbështetëse: 0,54 x 0,52 cm, Lartësia: 37 cm

Lënda: Gurë gëlqeror

Vendi i zbulimit: Macelllum i fillimit të shek. VI të erës sonë.

Në njërën faqe një kryq latin në reliev. Imposte të këtilla janë gjetur në bazilikën A të Philippes në Maqedoni.[32] Imposti është i njëkohshëm me kapitelet e tjera të zbuluara në këtë monument,

27. Impost (tab. VII, 4)

Baza mbajtëse: 85 x 56,5 cm

Baza mbështetëse: 42 x 40 cm, Lartësia: 29 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Në njërën faqe një kryq latin në reliev e rrethuar nga një bisk që përfundon në dy skaje me gjethe zemre.

Motivi i zbukurimit është pothuajse i njëjtë me impostet e përdorura në bazilikat e Maqedonisë[33] që i përkasin gjysmës së parë të shek. VI.

28. Impost (tab. VII, 2)

Baza mbajtëse: 44 x 30 cm

Baza mbështetëse: 28 x 21 cm, Lartësia: 22 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

[32] Lemerle 1945, XII, d, XXVIII, 3.

[33] Lemeric 1945, VI, d.e; XXVIII, 10.

Në njërën faqe një kryq latin me apicese të lehta. Të dhënat e tjera si nr. 25.



Fig. 9

29. Impost (tab. V, I)

Baza mbajtëse: 60 x 30 cm

Baza mbështetëse: 39 x 16,8 cm, Lartësia: 16 cm

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: Gjetje rasti

Në njërën faqe brenda një rrethi është skalitur në reliev motivi i diellit.

Të dhënat e tjera si nr. 24.

VII Elemente të tjera arkitektonike (nr. 30-32)

30. Fragment frizi (tab. VIII. I)

Baza mbajtëse: 1,35 x 57,5 m, Lartësia: 0,25 m

Lënda: Mermer

Vendi i zbulimit: I murosur në të djathtë të portës "sekrete" (Kështjella e fillimit të shek. VI të e.sonë).

E gjithë faqja e fragmentit është zbukuruar me akanthe fletëgjata. Poshtë tyre janë skalitur motivet në trajtë vezake dhe katërkëndëshe. Modelime të tilla, madje edhe të alternuara pothuajse njëlloj i ndesh në frontonin e diptikut të Ariadnës në Konstandinopojë (rreth vitit 500).[34]

31. Pllakë kangjeli (tab. VIII, 2).

Gjatësia: 1,75 m, Gjerësia: 0,74 m, Trashësia: 0,06 m

Lënda: Mermer

Vendi i gjetjes: Pranë ish tregut modern të qytetit (Bezisteni).

Në njërën faqe është paraqitur në reliev monogrami i Krishtit, ndërsa në faqen tjetër një kryq i madh me reliev të cekët. Poshtë tij një bisk i përdredhur që vijon simetrikisht dhe përfundon në dy skajet me gjethe në trajtë zemre. Pllaka, e thyer në tri pjesë, ka pesë bira të tejshpuara.. Nga autorja e zbulimit është datuar në fund të shek. V".[35] Në Philippes pllaka të këtilla janë gjendur në kangjelin e një kishte të shek. V.[36] 32. Pllakë kangjeli (tab. VIII, 3)

Gjatësia: 1,56 m, Gjerësia: 0,93 m, Trashësia: 0,06 m

Lënda: Mermer

Vendi i gjetjes: Gjetje rasti

Në njërën faqe monogrami i Krishtit, brenda një kurore rrethore me lule trepetalëshe (latos?). Poshtë saj një bisk i njëjtë me atë të pllakës nr. 31.

Pllaka me elemente të ngjashme të përdorura në kangjell dhe në anijatë tek bazilika A e Bylisit janë datuar në shek. V".[37]

[34] Coche de la Ferte 1981, f. 324, nr. 140.
[35] Kabashi 1989, f. 151
[36] Lemerle 1945, tab. XXV, 12.
[37] Mucaj 1987:175, VIII, 1.

SHKURTIME

Albanien, 1985	Albanien, Kulturdankmäler eines unbekannten Landes aus 2200 Jahren, Marburg 1985.
Albanien, 1988	Albanien, Schätze aus dem Land der Skipetaren Mainz, 1988
Anamali, 1993	Anamali, S., Architekttura e decoracione tardoantica in Albania, "XL corso di cultura sull'arte Ravennate e Bizantina", Ravena 29 aprile-5 maggio 1993, Ravena 1993
Belloni, 1958	Belloni, G., "I kapitelli romani di Milano", Padova, 1958.
Boyd, 1982	Boyd, Susan, A., A little-known technique of architectural sculpture champlevé reliefs fron cyprus, "XVI Internationales Byzantinistenkongress" Akten II/5 Jahrbuch der Österreichischen Byzantistik 32/5, Wien 1982.
Cerova, 1993	Cerova, Y., Elemente arkitektonikë të Scampis të shek. VI, "Iliria" 1 e 2, 1993.
Cultura, 1971	Cultura Bizantina in Romania, Bucuresti 1971
Coche de la Ferte, 1981	Coche E, de la Ferte, "L'art de Byzance", Paris 1981
Grabar, 1963	Grabar, A., "Sculptures byzantines de Constantinople (IV-X siècles)", Paris 1963
Heilmeyer, 1970	Heilmeyer, W.D., Korintische Normal kapitelle Studie der Römischen Architekturdekoration, "Mitteilungen des Deutschen Archaologischen Instituts", Römische Abteilung, 1970.
Hoti, 1996	Hoti, A., Të dhëna arkeologjike për krishtërimin e hershëm në Dyrrachion (shek. IV-VII), "Iliria" 1 e 2, 1996.

Kabashi, 1989	Kabashi, I., Dëshmi të reja nga dy monumente të antikitetit të vonë në qytetin e Durrësit, "Monumentet" 1, 1989, (37).
Kautzsch, 1936	Kautzsch, R., "Kapittellstudien Beiträge zu einer Geschichte des spätantike kapitelles im Osten von vierten bis ins siebente Jahrhundert", Berlin-Leipzig 1936
Lemerle, 1945	Lemerle, P., "Philippes et la Macedonie Orientale a l'epoque chrétienne et byzantine", Paris 1945
Maguire, 1989	Maguire, Eunice Danterman A., Revolution in Nerthen Justinianic kapital Design the Axial void in Constantinople and Philippi (Fisrt International Symposium for Thracian Studies) "Byzantine Thrace", vol I, Amsterdam 1983.
Meksi, 1983	Meksi, A., "Arkitektura mesjetare në Shqipëri" (shek. VII-XV), Tiranë 1983
Muçaj, 1987	Muçaj, S., Bazilika A e Bylisit, "Iliria" 1, 1987
Norman, 1988	Norman N. J., "The architecture of the Circus in the light of the 1982 season in AA.VV", The Circus and a Byzantine Cemetery at Cartage, I, Michigan 1988
Pensabene, 1973	Pensabene, P., "Ostia VII. I Kapitelli", Roma, 1973
Theodoresku, 1963	Theodoresku, D., L'edifice Romano-byzantin de Callatis, "Dacia", VII, 1963
Zeqo, 1985	Zeqo, M., Disa monumente të murosura në Shqipëri, "Monumentet" 2, 1985.

RÉSUMÉ

LA PLASTIQUE ARCHITECTONIQUE DÉCORATIVE À DURRËS DURANT LA PÉRIODE PALÉOCHRÉTIENNE

Trente-deux éléments de la plastique architectonique décorative sont divisés en plusieurs types:

a) Des chapiteaux de type corinthien (n° 1-4), datés de la période allant de la fin du IV siècle à la fin du V° siècle.

b) Des chapiteaux de type composite (n° 6-12) qui remontent à l'époque de la domination des empereurs Anastase I et Justinien 1 (entre l'an 500 et 560).

c) Un chapiteau du type à feuilles dites déployées (n° 5) ou "windverwehten", daté du V° siècle.

d) Un chapiteau du type au protomé d'animaux (n° 13) ou "zwei-zonen-kapitell mit Tierprotomen" du Ve siècle.

e) Des impostes du VI° siècle (n" 14-29).

La collection comprend également un fragment de frise (n° 30), ainsi que deux plaques de chancel (n° 31-32) qui, vu la technique de travail, remontent à la seconde moitié du V° siècle.



Tab. I



Tab. II



Tab III



Tab IV



Tab V



Tab VI



Tab. VII



Tab. VIII

ENË ME GLAZURË NGA QYTETI I DURRËSIT[1] (shek. X-XV)

Gërmimet arkeologjike dhe punimet e ndryshme të kryera në qytetin e Durrësit kanë nxjerrë në dritë një lëndë të pasur me qeramikë të glazuruar të periudhës mesjetare.[2] Ky material[3] i mbledhur në shtresat e sipërme të mesjetës së hershme dhe sidomos në shtresat kulturore të mesjetës së mesme, përbëhet nga një numër relativisht i madh fragmentesh dhe enësh të plota. Pjesa më e madhe e kësaj lënde është fiksuar në rrethana stratigrafike të tilla ku për datimin e tyre kanë shërbyer monedhat bizantine të shoqëruara me to. Pjesa tjetër, ndonëse jo gjithëherë e mbledhur në shtresat kulturore të sigurta, prapseprapë ka dhënë mundësi që, edhe këto të fundit, të klasifikohen sipas veçorive të tyre.

Enët me glazurë të Durrësit përmbajnë një varg të dhënash tipologjike dhe kronologjike me vlerë. Numrin më të madh të

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Enë me glazurë nga qyteti i Durrësit (shek. X-XV); Në: Iliria, vol. 19 n°1, 1989. fq.213-240;
(*https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1989_num_19_1_1519)*

[2] Enët që analizohen më poshtë janë gjetur në kurtinën 1 dhe 2 (A. Hoti, Kalaja..., f. 269) dhe në kullën D të kalasë (material i pabotuar nga gërmimet e V. Toçit); në amfiteatër e termat (material i pabotuar nga i njëjti autor): në monumentin në kolonadë rrethore (A. Hoti, Durrës-qytet, f. 261-262) në territorin e një varreze mesjetare (A. Hoti, Lagja 11, f. 275) dhe në vendgjetje të tjera (H. Myrto, Durrës-qytet,f. 251; F. Tartari, Durrës-qytet, E. 259).

[3] Ilustrimet grafike janë përgatitur nga Myrvete Dajlani ndërsa fotot nga Adnan Hyka.

tyre e përbëjnë tasat, kupat, pjatat e deri diku pjatancat, tavat e broket. Në kategoritë e tjera të enëve, glazurimi është përdorur në mënyrë të kufizuar.

Enët e punuara prej argjili të pastër, me ngjyrë të kuqe në rozë, me dhe pa zbukurim përbëjnë numrin më të madh të qeramikës me glazurë. Më pas vijnë enët e tjera prej argjili gjithashtu të pastër, me ngjyrë okër në të bardhë e me nuanca të blerta, që në pjesën më të madhe të tyre janë të zbukuruara.

Enët e glazuruara do t'i ndajmë në dy grupe: a) enë pa zbukurim, b) enë me pikturim.

A. ENE ME GLAZURE PA ZBUKURIM

Enët e këtij grupi janë të madhësive mesatare dhe të vogla (tab. I, 4-18, 11, 2-21). Ndër format, predominojnë tasat trungkonikë me buzë të pjerrëta ose të profiluara, me funde të sheshta dhe nganjëherë me këmbë të larta unazore. Në këtë grup enësh përfshihen edhe disa tava të cekëta cilindrike me buzë të drejta dhe ndonjë pjatë. Në përgjithësi glazuara mbulon faqet e brendshme të enëve, buzët e tyre, si dhe një deri dy gisht nën buzë nga ana e jashtme. Në disa enë dhe sidomos tek tasat e vegjël është bërë glazurim i plote (tab.1,4.1, 8, 13. 17. 18; II, 4-6). Për lyerjen e faqeve janë aplikuar tre mënyra; me zhytje, me furçë, me spërkatje. Ngjyrat kryesore të glazurave përbëhen nga jeshilja e errët ulli, bizelja, e verdha, kremi, ndërsa kafeja dhe ngjyra e mjaltit kanë pasur një përdorim të pakët. Në disa prej tasave është përdorur gjithashtu një lloj glazure transparente gjysmë mat.

Midis enëve të këtij grupi, interes paraqesin tasat me glazurë jeshile ulliri (tab. I. 5. 6. 11-13), si dhe ato me ngjyrë mjalti (tab. I, 9) që janë zbuluar në shtresa kulturore të shoqëruara me mo-

nedha të perandorëve Jani I Cimiski (569-976) dhe të Aleksit I Komneni (1081-1118). Mënyra e glazurimit me ngjyrë jeshile-ulliri është vënë re edhe në enët e shek. X-XII të zbuluara në vendbanimet mesjetare të vendit tonë.[4] Në punishtet bizantino-lindore përdorimi i glazurës është dukur aty nga shek. IX.[5] Ndërsa në vendin tonë dhe konkretisht në Durrës, siç e thamë më lart, ajo duhet të jetë futur më vonë, ndoshta nga fundi i shek. X. Enët e tjera të glazuruara me ngjyrë të verdhe, kafe, jeshile të çelur, kafe në çokollatë etj. (tab. 1. 7. 8. 10, 14-18: tab. II. 4-21) janë gjetur me monedha të shekujve XIII-XIV që u përkasin perandorëve latinë (1204-1261), Theodorit II. Engjëll Komnenit (1223-1230), Manuelit III Komnen (1390-1417), etj. Të kësaj periudhe, ose diçka më vonë, thuajse me karakteristika cilësisht të njëjta, janë edhe enët e zbuluara në vendbanime dhe kështjella mesjetare të vendit tonë.[6]

[4] Hoti, Ndihmesë.... f. 263, Komata, Qyteti (në shtyp), Muçaj, Qyteza, f. 259.
[5] Sipas Čimbuleva (Vases..., f. 204), glazurimi më i hershem i enëve në qendrat poçare të Bullgarisë është futur që në shes. IX. Po kështu mendon edhe Comsa (Cultura.... f. 114) për prodhimin e kësaj qeramike në teritorin e Rumanisë.

[6] Anamali, Ballsh...., f. 258 (qeramika e tryezës përbëhet kryesisht nga enet e glazuruara me një e shume ngjyra të shekujve XII-XIV); Anamali-Spahiu, Shkodër. I. 270: Komata, Të dhëna. . f. 227; Të dhëna për qytetin.... tab. IV, 7-12; Rezultatet.... I. 123, tab. II. 1-2 (qeramika bizantine datohet që nga shek. X e në vijim); Qendërbanimi.... 1. 71-72, tab. II. 4-3, 111, 1, 2; IV. 1. 3, 5: Kalaja,... I. 259, fig. 9; Lako. Rezultatet. ... T. 121, tab. XVIII. 2-8; Maquj. Qyteza..., T. 259-260, tab. IV, 46-64 (përmendet një numër enësh me glazurë të verdhë e kafe që datohen në fund të shekujve XIII (1. 261); Cakran... f. 264 (veçohet qeramika me glazurë të bardhë, të verdhë e të blertë e shek. XIII-XIV), Saraçi, Vau i Dejës.... f. 296; Kalaja.... f. 219, tab. V. 6; Spahiu. Rezultatet.... f. 82, tab. II, 4.

KATALOGU

Tab. I (4-18)

4. Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjil me ngjyrë rozë. Trup trungkonik me fund të ulët. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë të verdhë. Diam. 13 cm. Nr. inv. 1.

5. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe në rozë. Trup trungkonik me fund të ngritur. Lyer nga brenda dhe paksa nën buzë nga jashtë me glazurë jeshile të errët. Diam. 10,7 cm. Nr. inv. 1516.

6. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë rozë të ndezur. Trup trungkonik me buzë të profiluara në trajtë sqepi dhe fund paksa të ngritur. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile ulli. Diam. 14,5 cm. Nr. inv. 1122.

7. Fragment tasi. Gjetur në varrezën mesjetare. Trup trungkonik me buzë të profiluara. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile të hapur. Diam. 15.5 cm. Nr. Inv. 1036.

8. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe në rozë me buzë të proliluara ne trajtë S-je. Lyer nga brenda dhe paksa nga jashtë me glazurë jeshile. Diam. 12,8 cm. Nr. inv. 1516.

9. Fragment tasi. Gjetur ne Macellum. Argjilë me ngjyrë okër. Trup gjysmë globular me buzë të profiluara ne formë S-je dhe fund të ulët. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë mjalti. Diam. 15 cm. Nr. inv. 1516.

10. Tas. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë me ngjyrë kafe. Trup trungkonik me buzë te drejta dhe fund paksa të ngritur. Lyer nga brenda me glazurë të blertë. Diam. 13,5 cm. Nr. inv. 760

11. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë kafe. Trup trungkonik me buzë te glazuara nga jashtë. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë të errët ulliri. Diam. 4,9 cm. Nr. inv. 23.

12. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Trup trungkonik me buzë të profiluara në trajtë S-je dhe fund të sheshtë. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë transparente, Diam. 14,9 cm. Nr. inv. 87.

13. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe e çelët. Trup trungkonik me buzë të profiluara në formë sqepi dhe fund të ngritur. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile të errët. Diam. 17,5 cm. Nr. inv. 1480.

14. Tas. Gjetur në kala. Argjilë kafe e çelët. Trup trungkonik me buzë të profiluara dhe fund paksa të larte. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile. Diam. 20 cm. Nr. inv. 541.

15. Tas. Gjetur në kala. Argjilë kafe e çelët. Trup trungkonik me buzë të profiluara dhe fund paksa të lartë. Lyer nga brenda me glazurë të blertë. Diam. 25,6 cm. Nr. inv. 1481.

16. Tas. Gjetur në kala. Argjilë kafe në rozë. Trup trungkonik me buzë të hapura e fund të lartë. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë. Diam. 20 cm. Nr. inv. 3598.

17. Pjatë e thellë. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe në rozë. Ka formë trungkonike me buzë të hapura drejt. Lyer nga brenda me glazurë jeshile, Diam. 23,2 cm. Nr. inv. 1481.

18. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë okër në rozë. Trup trungkonik me buzë të profiluara trekëndëshe. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë e njolla të blerta. Diam, 19,5 cm. Nr. inv. 5500.

Tab. II (4-21)

4. Kupë. Gjetur në Macellum. Argjilë e kuqe në rozë. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund të ngritur. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë kafe në çokollatë. Diam. 10,3 cm. Nr. inv. 1456.

5. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë e kuqe në rozë. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund të ngritur. Lyer nga brenda dhe jashte me glazurë kafe në çokollatë. Diam. 12 cm. Nr. inv. 3554.

6. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë i kuq në rozë. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund të ngritur. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë kafe në çokollatë. Diam. 14,7 cm. Nr. inv. 477.

7. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë kafe. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund të ulët. Lyer nga brenda dhe gjysmë gishti nga jashtë me glazurë jeshile. Diam. 11,7 cm. nr. inv. 98.

8. Pjatë. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe e çelur. Ka formë trungkonike me buzë të profiluara nga jashtë dhe fund të lartë. Lyer nga brenda me glazurë jeshile. Diam. 15,5 cm. Nr. inv. 475.

9. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë okër. Trup trung-konik me buzë të drejta të harkuara dhe fund të lartë. Lyer nga brenda dhe dy gisht nën buzë nga jashtë me glazurë të blerë në të verdhë. Diam. 12.5 cm, Nr.inv. 810.

10. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë e kuqe në rozë. Ka formë trungkonike me fund të sheshtë. Lyer nga brenda dhe paksa nga jashtë me glazurë të blertë. Diam. 16,2 cm. Nr. inv. 6496.

11. Tavë. Gjetur në Macellum. Argjilë ngjyrë okër. Ka formë trungkonike me fund pak të ngritur. Lyer nga brenda dhe paksa nga jashtë me glazurë në ngjyrë jeshile. Diam. 17,5 cm. Nr. inv. 3255.

12. Tavë. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë ngjyrë rozë e ndezur. Ka formë trungkonike me fund paksa të ngritur. Lyer nga brenda me glazurë të blertë. Diam. 24,6 cm. Nr. inv. 721.

13. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë me pjekje kafe të çelët. Trup trungkonik me buzë të rrumbullakuara. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë në krem dhe me njolla jeshile. Diam. 30 cm. Nr. inv. 4.

14. Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjilë kafe në okër. Trup trungkonik me buzë të harkuara dhe fund pak të ngritur. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile. Diam. 17. Nr. inv. 2005.

15. Tas. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë okër. Trup trungkonik me buzë të profiluara në formë trekëndëshi dhe fund të sheshtë. Lyer nga brenda me glazurë jeshile. Diam, 15 cm. Nr. inv. 97.

16. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë me pjekje kafe të çelur. Trup trungkonik me parete të trasha dhe fund të lartë të sheshtë. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë dhe me njolla jeshile. Diam. 16 cm. Nr. inv. 508.

17. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me pjekje kafe të çelur. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund të sheshtë. Lyer nga brenda me glazurë të blertë të çelur. Diam. 16 cm. Nr. inv. 2298.

18. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Diam. 18.5 cm. Të dhënat e tjera si nr. 17. Nr. inv. 5779.

19. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë me pjekje okër në kafe. Trup trungkonik me buzë të profiluara harkore dhe fund pak të ngritur. Lyer nga brenda me glazurë të blertë. Diam. 25 cm. Nr. inv. 540.

20. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe në okër. Trup trungkonik me fund të ulët. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë të verdhë dhe me njolla jeshile. Diam. 18.5 cm, Nr. inv. 541.

21. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë okër. Trup trung-konik me buzë të shpërvjelura nga jashtë. Lyer nga brenda me glazurë jeshile. Diam. 25 cm. Nr. inv. 2555.

B. ENE TE GLAZURUARA DHE ME ZBUKURIM.

Enët e këtij grupi mund t'i ndajmë në tri kategori: 1) enë të zbukuruara me zgrafito dhe me fushëngritje; 2) enë me zbukurim në reliev; 3) enë me pikturim polikrom.

1. Enë të zbukuruara me zgrafito dhe me fushëngritje (chomplavé).

Enët e kësaj kategorie janë relativisht të paktë (tab. 1, 1-3; II, 2-3; III, 1-19). Ato përbëhen nga tasa e pjata të thella të glazuruara me ngjyrë jeshile, të verdhë e krem, kafe etj. Pikturimi është realizuar vetëm në faqen e brendshme të enëve dhe në më të shumtën e rasteve në pjesën fundore të tyre. Ndër elementet dekorative janë rrethi i mbushur me harqe e spirale, zbukurimet me figura njerëzish, shpendësh dhe motivet vegjetale.

Pjesa më e madhe e enëve të pikturuara me rrathë të mbushur ngjasojnë me motivet e ekzemplarëve nga qendra të tjera të

trevës ballkanike që datohen në shek. XI-XIII.[7] Fragmentet e tjera të tipit të tasave për servisje (tab. V, 6-7, 10, XI), nga pikëpamja e mjeshtërisë së pikturimit kanë tipare të ngjashme me qeramikën e pikturuar italiane të shek. XV.[8] Por krahas anëve të përbashkëta ato kanë imtësira të punimit të zgrafitos si dhe të ngjyrimit që dallojnë nga ato apenine gjë që na shtyn të mendojmë se duhet të kemi një imitacion të saj në punishtet durrsake, proces ky që mund të jetë futur aty nga fundi i këtij shekulli. Si mbështetje e kësaj lidhje shërben edhe fakti se pas vitit 1392 e në vijim, për një kohë të gjatë, Durrësi ishte nën pushtimin venedikas.[9]

Enët e tjera të pikturuara me figura zoomorfe dhe vegjetale vijnë nga shtresa kulturore të shoqëruara me monedha anonime të perandorëve latinë (shek. XIII). Të kësaj kohe janë datuar ato edhe në qytete dhe vendbanime mesjetare të Ballkanit,[10]

Fragmenti i tasit i paraqitur në tab. IV, 13 përmban një pikturë tregimtare ku jepen motivet e luftimit dhe të mbrojtjes. Ky fragment është gjetur në një monedhë të shekullit XIV që i përket Republikës të Shën Markut.

Me anën e teknikës së zbukurimit me fusha të ngritura janë punuar një numër i kufizuar tasash (tab. V, 1-2, 4-5, 8-9). Këto enë janë të glazuruara me tone të ndezura në ngjyrë të verdhë në

[7] Morgan, The Byzantin, XLI, a; nr. 292 c. 1004, d. 1007; XL, nr. 955, f. 158; XLI, a, b, c, d; 1358, nr. 1636; XLVII g. nr. 1395, Cult. Byzant., fig. 271 Barnea, Gravan, fig. 30. BYZANTINH f. 232, nr. 272, f. 239, nr. 290, f. 240, nr. 291-292.

[8] Alb. Schatze, nr. 380, 4; Gardelli, Ceramiche f. 151, fig. 51 a, f. 182, tab. XIVII, Conton, Le Antiche, f. 17, fig. e tretë djathtas f. 19, 21.

[9] Burime..., f. 208-209.

[10] Tablot-Rice, Byzantine, XVII, a, fig. 4 (II-III). Cimbuleva, Vases, f. 233, Pl. XIX, nr. 91.

çokollatë. Zbukurimet e bëra me këtë teknikë paraqesin motive floreale palmeta, dredhëza etj. Disa prej këtyre janë stilistikisht të ngjashme me ornamentet e poçerisë islamo-kalife të shek. XIV.[11]

KATALOGU.

Tab. I (1-3)

1) Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë okër në kafe. Trup trungkomik me buzë të profiluara në trajtë S-je. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile të errët ulliri. Incizuar nga jashtë me grafito në formë hullizash koncentrike. Diam, 14,7 cm. Nr. inv. 23.

2) Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë okër në kafe. Trup trungkonik me buzë të profiluara në trajtë S-je. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile të errët ulliri. Incizuar nga jashtë me zgrafito në formë hullizash koncentrike. Diam. 12.5 cm. Nr. inv. 109.

3) Pjesë çanaku. Gjetur në kala. Trup në trajtë gjysmë globulare. Vegjë e zgjatur nën buzë. Diam. 18 cm. Nr. inv. 341.

Tab. II (2-3)

2. Pjatë. Gjetur në Macellum. Argjilë okër në të kuqe. Ka formë trungkonike me buzë të shpërvjelura nga jashtë e fund të lartë. Lyer nga brenda dhe jashtë me zmalto kafe në çokollatë. Me teknikën e zgrafitës së hollë janë paraqitur motive me spirale dhe rrathë koncentrike. Diam. 20.5 cm. Nr. inv. 1790.

3. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë okër në të kuqe. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund të lartë. Lyer nga

[11] Aylon, Fragmenti, f. 52-53, tab XIX, c.

brenda dhe jashtë me zmalt kafe në çokollatë. Të dhënat e tjera si nr. 2. Diam. 16.5 cm. Nr. inv. 1480.

Tab. III (1-19)

1. Fragment pjate. Gjetur në kala. Argjilë e kuqe me nuanca të theksuara rozë. Lyer nga brenda e jashtë me jeshile. Me teknikën e zgrafitos së hollë është pikturuar figura ballore e portretit të një njeriu. Fytyra e vogël e realizuar në formën e dy rrathëve koncentrikë, sytë rrethore, disi të zgjatur, përfundojnë me bisht. Në mesin e tyre në formën e pikës është paraqitur retina. Hunda e shtypur, ndërsa goja e mbyllur. Përmasat: 8 x 5.5 cm. Nr. inv. 3302.

2. Fragment tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë kafe në okër. Lyer nga brenda me zmalt të blertë. Me zgrafito të hollë është bërë shiriti i mbushur me harqe dhe spirale. Diam. 27.5 cm. Nr. inv. 193.

3. Fund pjate. Gjetur në amfiteater. Argjilë me ngjyrë rozë të ndezur. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë dhe njolla jeshile. Në qendër të enës është gërvishur një rreth, brenda të cilit është paraqitur një rozetë katërfletëshe. Diam. 6.8 cm. Nr. inv. 2196.

4. Fragment tasi. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë okër. Glazurë krem në të verdhë Me zgrafito të hollë është bërë figura e një heshte (?). Diam. 24 cm. Nr. inv. 387.

5. Fund tasi. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë okër e nuanca rozë. Lyer nga brenda me glazurë të gjelbër. Me zgrafito të hollë është pikturuar një figurë me tre spirale të bashkëmbështetura tangencialisht me njëra-tjetrën. Diam. 6 cm. Nr. inv. 650.

6. Fragment tasi. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë e kuqe me nuancë kafe. Lyer nga brenda me glazurë jeshile. Me

teknikën e zgrafitos është pikturuar një shpend në profil. Diam. 8 cm. Nr. inv. 1192.

7. Fund pjate. Gjetur në amfiteatër. Argjilë ngjyrë okër. Lyer nga brenda me zmalt të verdhë të hapët. Me zgrafito të hollë është pikturuar figura e një luleje katërpetalshe, ndërmjet të cilave janë bërë zbukurime me spirale dhe harqe. Diam. 6.7 cm. Nr. inv. 650.

8) Fund tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjile ngjyrë kafe. Lyer me zmalt të bardhë mat. Me anën e shamplevës është realizuar nje rreth, brenda të cilit është bërë një rreth tjetër i mbushur me harqe. Diam. 10.8 cm. Nr. inv. 6125.

9. Fragment tasi. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë okër në rozë. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë. Në qendër të enës është pikturuar me zgrafito një rreth i mbushur me spirale e vija të lakuara. Diam. 8 cm. Nr. inv. 404.

10. Fund pjatance. Gjetur në Macellum. Argjilë ngjyrë okër të thellë. Lyer nga brenda me glazurë jeshile. Me zgrafito linjë mesatare është vizatuar figura e peshkut. Diam 10 cm. Nr. inv. 607.

11. Fragment tasi. Gjetur në kala. Argjilë me pjekje rozë. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë e njolla jeshile. Me anën e zgrafitos janë bërë disa vija të rregullta dhe një vijë zig-zag. Diam. 24 cm. Nr. inv. 375.

12. Fragment tasi. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë kafe në rozë. Trup trungkonik, buzë të profiluara drejtë dhe fund unazor. Lyer nga brenda me glazurë krem e njolla jeshile. Me zgrafito të hollë është bërë figura e një shpendi, Diam. 22.2 cm. Nr. inv. 484.

13. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me pjekje ngjyrë rozë të ndezur. Lyer me glazurë të verdhe. Në qendër të enës është incizuar një rreth i mbushur me spirale e vija të lakuara. Pranë buzës, një shirit koncentrik i zbuluar me të njëjtat motive. Diam. 8.3 cm. Nr. inv. 6914.

14. Tas. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë kafe në okër. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund pak të ngritur. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë. Me zgrafito të trashë është pikturuar figura e një peshku e rrethuar me motive dredhëzash. Poshtë tij dallohet bishti i një specie tjetër nga fauna e detit. Diam. 23 cm. Nr. inv. 790.

15. Fund tasi. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë roze të ndezur nga brenda me glazurë jeshile. Me zgrafito të hollë është pikturuar figura e një shpendi në profil. Diam. 6 cm. Nr. inv. 3696.

16. Fund tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë okër të ndezur në bezhë. Lyer me glazurë të verdhë dhe me njolla jeshile. Me zgrafito të hollë është bërë pjesa e krahut të një shpendi. Diam. 7.6 cm. Nr. inv. 138.

17. Tas. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me ngjyrë të kuqe të thellë. Trup trungkonik me buzë të rrumbullakuara dhe fund paksa të ngritur. Me zgrafito linjë mesatare është bërë figura e një shpendi në profil. Diam. 21.5 cm. Nr. inv. 6900.

18. Fragment tasi. Gjetur në kala. Argjilë me ngjyrë rozë të ndezur. Lyer me glazurë të verdhë dhe me njolla jeshile. Me zgrafito linjë mesatare është bërë një shirit i mbushur me vija vertikale. Diam. 21 cm. Nr. inv. 1056.

19) Fund tasi. Gjetur në amfiteater. Argjilë me ngjyre okër në rozë. Lyer nga brenda me zmalt jeshil. Me zgrafito linjë mesatare është bërë figura e një shpendi. D. 9 cm. Nr. inv. 6906,

Tab. IV (1-13).

1. Tas. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me ngjyrë okër. Trup trungkonik, buzë të drejtë dhe fund unazor. Lyer nga brenda me glazurë jeshile të errët dhe njolla të hapura bezhë. Me zgrafito të trashë, janë pikturuar të harmonizuara spiralet dhe motivet vegjetale. D. 1, 22 cm. Nr. inv. 8895.

2. Fund tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjil me pjekje kafe të ndezur. Lyer nga brenda me zmalt të verdhë. Me anën e zgrafitos linjëgjerë janë pikturuar motive vegjetale. Diam. 5,3 cm. Nr. inv. 2092.

3. Tas. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë ngjyrë kafe të ndezur. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund unazor pak të ngritur. Lyer nga brenda me zmalt të verdhë. Me zgrafito të gjerë, janë bërë motivet vegjetale. Diam. 21,5 cm. Nr. inv. 822.

4. Tas. Gjetur në amfiteatër. Argjil me ngjyrë kafe të çelur. Trup trungkonik buzë të profiluara në formë S-je dhe fundi i sheshtë. Lyer nga brenda me zmalt kafe në gështenjë. Me zgrafito të trashë, janë pikturuar motive spirale dhe vegjetale. Diam. 21 cm. Nr. Inv. 6902.

5. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me pjekje okër-rozë. Trup trungkonik me buzë të drejta dhe fund unazor paksa të ngritur. Lyer nga brenda me zmalt të blertë. Me zgrafito të trashë janë pikturuar motive vegjetale. Diam. 22 cm. Nr. inv. 2277.

6. Tas. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjil me pjekje kafe okër. Trup trungkonik me buzët të profiluar trekëndëshe dhe fund unazor paksa i ngritur. Glazurë e verdhë me njolla jeshile. Me zgrafito linjë trashë janë pikturuar motivet ve. gjetale. Diam. 22,3 cm. Nr. inv. 822.

7. Tas. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me pjekje ngjyrë okër, në rozë. Trup trungkonik, buzë të profiluar trekëndëshe me fund të sheshtë. Glazurë jeshile me shkëlqim. Me zgrafito të trashë janë pikturuar motive spirale dhe vegjetale. Diam. 21 cm. Nr. inv. 6901.

8. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjil me ngjyrë rozë të ndezur. Trup trungkonik, buzë të profiluara në trajtë S-je dhe fund i ngritur unazor. Glazurë kafe e errët me njolla jeshile në gështenjë. Me zgrafito të trashë janë pikturuar gjethe dhe spirale. Diam. 21 cm. Nr. inv. 6903.

9. Fund tasi. Gjetur në Kala. Argjil me ngjyrë okër të thellë. Lyer nga brenda me zmalt jeshil. Me zgrafito të trashë, janë pikturuar motive vegjetale dhe spirale. Diam. 9,8 cm. Nr. inv. 393.

10. Fragment tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me ngjyrë kafe në çokollatë. Trup trungkonik, buzë të profiluara në trajtë S-je dhe fund unazor. Me zgrafito janë pikturuar motive spirale dhe vegjetale. Diam. 20 cm. Nr. inv. 6909.

11. Fund tasi. Gjetur në Macellum. Argjilë ngjyrë okër. Lyer nga brenda me zmalt jeshile. Me zgrafito të trashë janë pikturuar motive spirale e vegjetale. Diam. 10 cm. Nr. inv. 1708.

12. Fund tasi. Gjetur në amfiteatër. Argjilë ngjyrë kafe të ndezur. Glazurë e verdhë me shkëlqim. Me zgrafito të trashë janë pikturuar motive vegjetale. Diam. 10,4 cm. Nr. inv. 2253.

13. Fund pjate. Gjetur në Kala. Argjil ngjyrë kafe. Lyer nga brenda me zmalt jeshil me shkëlqim. Me zgrafito të trashë është pikturuar një luftëtar me mburojë. Diam. 12,2 cm. Nr. inv. 13.

Tab. V (1-2, 4-10).

1. Fragment tasi. Gjetje rasti në qytet. Argjilë me pjekje ngjyrë rozë. Trup trungkonik, buzë të profiluara trekëndëshe dhe

fund unazor i ngritur. Lyer nga brenda me zmalt të verdhë dhe njolla jeshile. Me anën e shomplevës është pikturuar një motiv qendror i paidentifikuar dhe një shirit rrethor periferik i zbukuruar me motive vegjetale. Diam. 26 cm. Nr. inv. 3443.

2. Fragment tasi. Gjetje rasti në qytet. Argjilë ngjyrë kafe në rozë. Trup trungkonik, buzë e profiluar trekëndëshe dhe fund unazor i ngritur. Lyer nga brenda me ngjyrë mjalti. Me anën e shomplevës janë pikturuar motivi qendror me palmeta, shiritat rrethore dhe motivet vegjetale. Diam. 25 cm. Nr. inv. 3441.

3. Fragment tasi. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë me ngjyrë kafe në rozë. Glazurë ngjyrë bezhë. Me anën e teknikës së shomplevës janë bërë motivet vegjetale të lyera me zmalt të gjelbër. Diam. 24,5 cm. Nr. inv. 314.

4. Fund pjate. Gjetur në Macellum. Argjilë me ngjyrë kafe në rozë. Lyer me glazurë ngjyrë okër. Me anën e shomplevës janë bërë motive vegjetale të lyera me zmalt të verdhë. Diam. 18 cm. Nr. inv. 1841.

5. Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjilë me ngjyrë kafe në rozë. Lyer nga brenda me glazurë kafe në çokollatë. Në qendër të enës nga brenda me linjë mesatare është bërë një rreth. Po kështu me zgrafito dhe shamplevë është pikturuar portreti i një femre në profil dhe përballë saj është vendosur një lule. Pjesa tjetër e enës është zbukuruar nga kombinimi i rrathëve me motive floreale. Diam. 26 cm. Nr. inv. 448.

6. Fund tasi. Gjetur në Kala. Argjilë me ngjyrë kafe në rozë. Trup trungkonik me buzë harkore të shpërvjelur nga jashtë dhe fund unazor i ngritur. Lyer nga brenda me glazurë ngjyrë kafe në çokollatë. Me anën e zgrafitos dhe shomplevës është pikturuar portreti i një femre në profil dhe përballë saj është vendosur një lule. Diam. 9 cm. Nr. inv. 449.

7. Fund tasi. Gjetur në Macellum. Argjil me pjekje okër të ndezur në rozë. Lyer nga brenda me glazurë çokollatë. Me anën e shomplevës kanë bërë palmetat të ngjyrosura me të verdhë. Diam. 10,5 cm. Nr. inv. 151.

8. Fund tasi. Gjetur në varrezën mesjetare. Argji me ngjyrë okër. Faqja e brendëshme e lyer me glazurë të verdhë. Me anën e shomplevës janë bërë palmetat të ngjyrosura me zmalt bezhë. Diam. 10,5 cm, Nr. inv. 966.

9. Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjil i kuq në rozë. Trup trungkonik me buzë të profiluar në trajtë S-je dhe fund të sheshtë. Lyer nga brenda me jeshile. Me anën e zgrafitos është paraqitur figura e një shpendi (rosë?). Në anët e saj dy lule. Diam. 9 cm. Nr. in. 3707.

2. Enë me zbukurime në reliev

Në enët e kësaj kategorie përfshihen disa fragmente. Midis tyre dallohen fragmenti i një tasi ku është modeluar figura e një zogu (tab. X, 6). Shprehja e motiveve me zogj në reliev përbën një veçori dalluese për qeramikën të glazuruar të shek. XI-XII në rajonet lindore të Bizantit.[12] Numri i kufizuar i gjetjeve të këtyre enëve në Durrës, të lë të mendosh se kemi të bëjmë me objekte të importit bizantin. Në një fragment tjetër, faqja e brendshme e tij është zbukuruar me pullëza ngjyrë kafe, të ngritura në reliev që paraqesin një figurë të pa identifikuar (tab. X, 3). Tasa me glazurim me motive pothuajse të tilla të zbuluara, në Korinth datohen në fillim të shek. XII.[13] Një variant tjetër paraqet tasi i

[12] Cimbuleva, vep. cit., f. 216, Pl. IX, 51; f. 222, Pl. XII, 63-66, f. 233, Pl. XIX, 91.

[13] Morgan, vep. cit., 1. 93, fig. 69, nr. 640-672, f. 95, fig. 681. Tab. XXVII, b, m, 665; BYZANTINH KAI, f. 230, nr. 267.

dhënë në tab. II, 1. Ena është gjetur në një grup me tasa protomajolikë. Faqja e jashtme e saj është zbukuruar me reliev të valëzuar. Ky stil zbukurimi është karakteristik për poçerinë e shek. XIII në Durrës dhe me sa dimë nuk njihet në repertorin e enëve të kësaj kohe brenda dhe jashtë vendit tonë.

Katalogu

1. Tas (tab. II, 1). Gjetur në Macellum. Argjil me ngjyrë kafe në rozë. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë kafe dhe çokollatë. Në faqen e jashtme, poshtë buzëve është zbukuruar me inçizime koncentrike dhe me reliev të valëzuar. Diam. 14 cm. Nr. inv. 3553.

2) Fund tasi. (tab. X, 6). Gjetur në Macellum. Argjil me ngjyrë rozë. Faqja e brendëshme është lyer me glazurë të verdhë në okër dhe e zbukuruar me motive në reliev, ku është paraqitur figura e nje shpendi të stilizuar. Diam. 7.6 cm. Nr. inv. 1809.

3) Fragment tasi. tab. X. 3). Gjetur në amfiteatër. Argjilë me ngjyrë kafe në rozë. Lyer në faqen e brendëshme me glazurë krem. Me anën e zgrafitos linjëhollë është konturuar një figurë e paidentifikuar e mbushur nga brenda me pullëza kafe të ngritura në reliev, Diam. 27 cm. Nr. inv. 2203.

3. Enë me pikturim polikrom

Ndër enët e zakonshme të këtij lloji kanë qenë tasat trungkonike dhe në një sasi më të pakët pjatat, pjatancat, kupat, broket etj. (tab. V, 3. 11, 12, VI, 1-4, VII. 1-5. VIII. 1-8 IX. 1-6. X. 1, 4, 5, 7-20). Brumi me të cilin janë punuar këto enë është kryesisht po ai që është përdorur dhe për enët e kategorive të tjera. Përjashtim bëjnë enët e punuara prej një argjile të pastër me

pjekje okër në të verdhë, që tashmë njihen me termin protomajolike (tab. VI-VIII, XII-XII). Këto enë janë glazuruar me një pastë të bardhë pa shkëlqim por nuk mungojnë midis tyre dhe të atilla që janë lyer me zmalt krem okër me shkëlqim mesatar, duke përfshirë këtu edhe ndonjë rast të veçantë, kur për sfondin e tyre është përdorur glazura e blertë (tab. VI. 3). Për glazurimin e enëve të llojit jo protomajolik kanë shërbyer zakonisht zmaltet me ngjyra të verdha. bizele, jeshile, etj., që herë-herë marrin karakterin e njollave. Tasat me njolla vijnë nga shtresa kulturore të shoqëruara me monedha të shek. XII-XIII. Enë me zbukurime të këtilla janë gjetur edhe në territorin e Maqedonisë.[14] dhe Bullgarisë. [15]

Në pjesën më të madhe të enëve pikturimi është bërë në faqet e brendshme mbi glazurë. Vetëm tek disa broka dhe në ndonjë pagure zbukurimet janë bërë në faqet e jashtme të tyre. Në pikturimin e enëve që zakonisht është përdorur peneli i lehtë njëhollë e mesatar, dallohen dy mënyra: a) pikturim me linja të zeza (që në të shumtën e herës ka karakterin e një kordoni të hollë në reliev) me anën e të cilave janë paraqitur skematikisht figura të ndryshme, ndërsa ngjyrat e tjera kanë patur karakterin plotësues, b) pikturim me penel të hollë e mesatare e shumëngjyrësh (kafe, jeshile. të verdhë, të kuqe etj.), me anën e të cilave është bërt konturimi dhe mbushja e figurave. Sipas llojit të motiveve enët e kësaj kategorie ndahen në: 1) Enë të pikturuara me motive vegjetale (tab. VIII, 1. 4. IX. 1-3. X, 8, 11, 12, 15, 16, 19). që paraqesin objekte të natyrës në radhë të parë lule e gjethe të ndryshme. Këto zbukurime, megjithëse janë pikturuar

[14] Og. Arheološkoto, f. 138, fig. 802.

[15] Čimbuleva, vep. cit., tab. XXVII, f. 122-126,

me linja të thjeshta nga pikëpamja artistike qëndrojnë në një radhë me enët e tjera bizantine. Kështu në një enë dyvegjake imitohet në mënyrë të plotë dhe deri në detaje motivi i një luleje të rrethuar nga një kurorë gjethesh (tab. X, 15). Enët e zbukuruara me motive florale janë gjetur së bashku me monedha të shekujve XII-XIII. 2) Enë të pikturuara me figura antropomorfe (tab. VII, 2; 4, VIII, 2). që u përkasin llojit të enëve protomajolike. Midis motiveve të zbukurimit tërheq vëmendjen një fragment pjatance ku është pikturuar figura e një instrumentisti. Nga pikëpamja e ndërtimit. instrumenti paraqet ngjashmëri me tipin e veglave kordofone me hark. Për përhapjen gjeografike të këtyre veglave muzikore mesjetare të dhënat e derisotme janë ende të kufizuara. Deri më sot njihen vetëm disa. Njëri prej tyre është ndeshur në afresket e një godine të shek. XI[16] në trevat fqinjë të perandorisë bizantine, një e dytë është e pikturuar në një pjatancë të këtij lloji të datuar në shek. XIII,[17] Instrumenti ynë ka të ngjarë t'i përkasë një viole.[18] 3) Enë të pikturuara me motive zoomorfe (tab. VI, 1, VII, 1. VIII, 7, IX. 4-5, X, 9). Figurat nga fauna e detit dhe e tokës janë gjithashtu të kufizuara, por ato paraqesin interes për disa imtësi stilistike të pikturimit. të tyre. Edhe këto enë janë gjetur në shtresa kulturore të sh. XIII-XIV. 4) Enë të pikturuara me figura gjeometrike (rombe, rrathë. harqe. kënde etj.) (tab. VI, 3, VII, 3.5 VIII, 3, 8, X, 13-14). Në një fragment ene (tab. X, 5) është pikturuar me grafit mbi glazurë figura e një rombi: në disa fragmente të tjera është vizatuar motivi i kryqit i futur në rreth, etj. Aplikimi i figurave gjeometrike

[16] Lazariev, Istorija..., tab. 121, b.

[17] Huyghe, L'art..., f. 139, fig. 383.

[18] Falenderoj pedagogun e Institutit të Lartë të Arteve sh. F. Mikopuli, që më ndihmoi për identifikimin e kësaj vegle muzikore me violên.

mbi sfondin e enëve përbën një veçori specifike për artin e poçerisë durrsake. Këto enë sipas rrethanave stratigrafike të gjetjes së tyre u takojnë shekujve XI-XII. Në disa fragmente enësh të tjera vërehen dhe pikturime të thjeshta me valëzime, me motivin e zemrës të vargëzuar etj. (tab. VIII, 5: X. 4). Si lloje të veçanta zbukurimi që ndeshen në një numër jo të vogël enësh janë ato motive që paraqesin linja spiralike dhe figurën e rrjetës (tab. VI, 2, 4; VII, 1, 3, 5: VIII, 6; IX, 1; X, 10, 14. 18, 20). Edhe këto enë janë gjetur në shtresat kulturore të mesjetës së mesme.

Midis enëve të tjera me zbukurim polikrom ka nga ato (tab. VI, 4; VII, 3, 5; VIII, 8), që nga forma dhe veçanërisht nga stili i zbukurimit paraqesin afërsi të madhe me enët e njëjtit lloj të zbuluara në Korint, në Brindisi e gjetkë.[19] Nga paralelet që gjejmë në këto vende fqinje enët në fjalë i përkasin qeramikës protomajolike, që datohet në gjysmën e parë të shek. XIII.[20] Kushtet e gjetjes së tyre në Durrës, të shoqëruara me monedha të kësaj kohe (të perandorëve latinë) e saktësojnë edhe më tej këtë datim. Po kështu është datuar kjo qeramikë edhe në Ras të Novi Pazarit (Jugosllavi),[21] që me sa dimë përbën kufirin më verior të përhapjes së kësaj qeramike në Evropën Juglindore. Përmbajtja e elementeve dekorative të enëve protomajolike të Durrësit në pjesën më të madhe të tyre u përgjigjet plotësisht zbukurimeve nga repertori i enëve tashmë të njohura greko-italike të këtij lloji. Por krahas këtyre afërive në protomajoliken

[19] Nicolacopoulos, Céramique..., f. 160-176, tab. LXI; Patitucci-Ugeri, Proto- maiolica.... tab. KXXIX, b, c; LXXX, a-b: LXXXI. f-e; LXXXII. a. b, c; LXXXIII.

[20] *Po aty.*

[21] Popović, Importation..., f. 11.

e Durrësit dallohen dhe disa motive të një lloji të veçantë, që përbëjnë tiparin kryesor të kësaj qeramike, stilistikisht të ndryshme nga ato që njihen deri më sot në literaturën arkeologjike. Kështu fragmenti i pjatës me figurën e instrumentistit, pjatanca e zbukuruar me shqiponjë (tab. VII. 1), tasi me motivin e nyjes së Solomonit (tab. VI, 3) dhe disa motive të tjera florale (tab. VIII, 1, 4) përbëjnë një veçori ornamentale të veçantë për enët protomajolike të Durrësit.

Katalogu

Tab. V. (3, 11-12).

3) Fragment pjate. Gjetur në kala. Argjil shumë i pastër me ngjyrë të verdhë-okër. Lyer me zmalt ngjyrë qumështi pa transparencë (majolike). Me penelata shiritash ngjyrë portokalli dhe blu janë pikturuar motive florale. D. 19,4 cm. Nr. inv. 229.

11) Broke. Gjetur në Macellum. Argjil okër në të verdhë. Ka bark sferik, qafë cilindrike, buzë në formë gjetheje, fund të sheshtë. Lyer nga jashtë me glazurë të verdhë. Zbukuruar me penelata mesatare shiritash ngjyrë blu dhe kafe të errët, në buzë, dhe me shirita të valëzuara horizontale dhe të pjerrëta, mbi bark. L. 16 cm, Nr. inv. 1336.

12) Fragment pjate. Gjetur në kala. Enë majolike si nr. 3. Me shirita mesatarë ngjyrë blu, jeshile, të verdhë dhe kafe janë pikturuar motive gjeometrike (rrathët) dhe vegjetale. D. 24,5 cm, nr. inv. 1028.

Tab. VI (1-4)

1) Fragment tasi. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjile kafe në okër. Trup trungkonik i thellë me fund të lartë. Lyer me

glazurë krem. Me anën e linjës së penelit të zi është bërë figura e një shpendi (gjel ?) i ngjyrosur me jeshile dhe të kuqe. Diam. 31 cm. Nr. inv. 71.

2) Tas. Gjetur në varrezën mesjetare. Enë e llojit protomajolike. Trup trungkonik me buzë të profiluar trekëndëshe dhe fund të ngritur. Per vizatimin e figurës së rrjetës, të rrathëve, të harqeve dhe kryqeve janë përdorur ngjyrat blu, jeshile dhe të kuqe. D. 22,2 cm. Nr. inv. 223.

3) Fragment tasi. Gjetur në kala. Ene e llojit protomajolike. Trup trungkonik, me buzë të drejtë dhe fund të lartë. Faqja e brendshme e lyer me glazurë të verdhë. Me penelatë të hollë kordoni të zi janë bërë figurat gjeometrike (rrathët, harqet, trekëndshat) dhe elementët e tjera (nyja e Solomonit, arabeskat). Diam. 30 cm. Nr. inv. 300.

4) Pjatë. Gjetur në kala. Argjilë okër në të verdhë. Ka formë trungkonike me buzë të drejtë dhe fund të lartë. Lyer nga brenda me glazurë të bardhë pastoze mat. Vizatimi i rrathëve periferikë dhe i rrathëve të vegjël qendrorë është bërë me penelata linjëhollë të zeza, ndërsa motivet e rrjetës dhe të rrathëve zinxhirë janë pikturuar me penelata mesatare ngjyrë të kaltër. D. 25 cm. Nr. inv. 447.

Tab. VII (1-5)

1) Fragment pjatance. Gjetur në Macellum. Enë e llojit proto-majolike. Trup gjysmë globular me këmbë të lartë. Me linjë kor-doni të zi është pikturuar figura e shqiponjës. Për mbushjen e figurës së këtij shpendi dhe të rrjetës është përdorur ngjyra blu dhe kafe. D. 11,5 cm. Nr. inv. 2939.

2) Fragment pjate. Gjetur në kala. Enë e llojit protomajolike. Me linja peneli në trajtë kordoni të zi në reliev është pikturuar figura e një njeriu si dhe malivet e arabeskave. Fustanella dhe

rrathët janë ngjyrosur me jeshile. Përmasat: 12 x 17 cm. Nr. inv. 321.

3) Fragment ene. Protomajolike. Gjetur në Kala. Trup trungkonik me buzë të harkuar nga brenda. Rrethi qendror dhe rrathët koncentrikë të buzëve janë hequr me penelata të zeza, motivet e rrjetës me ngjyrë kafe, këndet e brendashkruar me blu dhe harqet përsëri me të zezë. D. 15,5 cm. Nr. inv. 99.

4) Fragment pjate. Gjetur në Kala. Enë protomajolike. Me penelatë të hollë në trajtë kordoni të zi në reliev janë vizatuar figura e një njeriu, motive florale dhe gjeometrike. D. 33,5 cm. Nr. inv. 340.

5) Fragment tasi. Gjetur në Kala. Të dhënat e tjera pothuajse si ato të nr. 3. Ndryshojnë vetëm motivet e këndeve të brendashkruar që janë zëvendësuar me rrathët zinxhirë. D. 15,5 cm. Nr. inv, 100.

Tab. VIII (1-8),

1) Fragment ene protomajolike. Gjetur në Kala. Me penelatë të hollë paksa të ngritur në reliev janë pikturuar motive floreale të ngjyrosura me të kuq dhe blu. Përmasat: 11,5 x 10 cm.

2) Fragment pjate. Protomajolike. Gjetur në Macellum. Lyer nga brenda me glazurë ngjyrë krem në bezhë. Me penelatë të hollë në trajtë kordoni të zi të ngritur në reliev është pikturuar figura e një instrumentisti. Ai është veshur me një këmishë me grykë të hapët e ngjyrosur me tone të kaltra, ndërsa vegla muzikore është mbushur me pigmente kafe në okër. Ngjyrat janë të ëmbla pa kontranste koloristike. Portreti është perceptuar në pamje ballore. Në fytyrën e tij të rrumbullakët derdhen flokët kaçurrela. Sytë i ka të mëdhenj e të hapët, hundën të hollë dhe paksa të majosur, ndërsa gojën të vogël dhe të mbyllur. Instrumenti është mbështetur në anën e përparme të supit të majtë të

artistit. Suprina e saj ka formë ovale. Mbi pjesën fundore është ngjitur një riskë segmentare, që duhet të ketë shërbyer për fiksimin e kordieres. Në mesin e riskës del kordiera në formën e gërmës T. Në kordierë janë vendosur katër tela. Një element tjetër intere-sant është dhe prania e gjurmes së lehtë të pjesës së një harku që dallohet në mesin e suprinës mbi kordierën e sipërme. Kjo pjesë harku duhet t'i përkasë fillimit të një prej dy enëve (brimat e rezonancës). Përmasat: 11,5 x 10 cm. Nr. inv. 86/1.

3) Fragment ene. Gjetur në Kala. Përbërja e argjilës dhe e glazurës njëlloj si nr. 1. Me linjë penelatash të zeza janë bërë figurat e rrathëve dhe të kryqeve. Ndërsa pikat e vogla janë ngjyrosur me të kuqe. Përmasat: 5 x 4,5 cm. Nr. inv. 102.

4. Njëlloj si nr. 1. Nr. inv. 103.

5) Fragment ene. Gjetur në Macellum. Argjilë ngjyrë okër. Lyer me glazurë të bardhë mat. Me penelatë të zezë është bërë linja e valëzuar, ndërsa shiritat e harkuar me të kaltër. Përmasat: 7 x 3 cm. Nr. inv. 104.

6) Fund ene. Gjetur në Kala. Argjila dhe glazura njëlloj si nr. 4. Me penelatë të zezë është pikturuar motivi i rrjetës, ndërsa katrorët e vegjël të mbushur me të kaltër. D. 6,8 cm. Nr. inv. 105.

7) Fund ene. Gjetur në Kala. Argjilë kafe e çelët. Lyer me glazurë të verdhë në krem. Në fundin e enës është vizatuar figura e një kafshe grabitqare (dhelpër ?) e ngjyrosur me të zezë. Rreth e rrotull saj një shirit harkor i blertë. Vrima në njërin skaj tregon se fragmenti ka qenë përdorur për ekspozim. D. 7,8 cm. Nr. inv. 2557.

8) Fragment tasi. Protomajolike. Gjetur në Kala. Me anën e penelatës së zezë janë vizatuar rrathët, harqet dhe kryqet me

krahë të rrumbullakosur. Ky i fundit është i kufizuar nga jashtë me një rreth të kaltër. D. 18,7 cm. Nr. inv. 106.

Tab. IX (1-6)

1) Pagure. Gjetur në Kala. Argjilë me pjekje kafe në rozë. Trup cilindrik, qafë të hollë të profiluar vegjë shpatuke të vrimuara dhe këmbë në formë të dalurash. Faqja e jashtme e lyer me zmalt të verdhë me shkëlqim. Me anën e penelatave kafe dhe jeshile janë bërë kombinimi i motiveve të ndryshme: florale, gjeometrike dhe spiralike. L. 19 cm. Nr. inv. 30/1.

2) Fragment last. Gjetur në amfiteatër. Argjilë ngjyrë rozë. Trup trungkonik me buzë këndore dhe fund të sheshtë. Lyer nga brenda me zmalt të zi. Me anën e kombinimit të zgrafitos linjëhollë dhe penelatës është bërë një lule me katër petale e mbushur me kuadrate të kafejta. Anës saj janë vizatuar motive të tjera me ngjyrë jeshile. D. 22,5 cm. Nr. inv. 2241.

3. Pjatë. Gjetur në Macellum. Argjilë me pjekje okër në rozë. Ka formë trungkonike me buzë të hapura të drejta dhe fund të sheshtë. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë jeshile në të verdhë. Me penelata shumëngjyrëshe (kafe, të verdhë, jeshile, të kuqe etj.), është bërë një sfond natyror me lule (zambakë e gjethe). Dy vrimat në periferi tregojnë se kanë shërbyer për ekspozim. D. 25,5 cm.

4) Fragment kupe. Gjetur në Macellum. Argjilë e kuqe. Trup trungkonik me fund të sheshtë. Lyer me glazurë bezhë në të verdhë. Me penelatë të hollë të zezë është pikturuar figura e një shpendi. Përreth tij janë vizatuar rrathë koncetrikë me motive florale, të ngjyrosura me blu, të kuqe dhe portokalli. D. 14,2 cm. Nr. inv. 1079.

5) Fund tasi. Argjilë me ngjyrë rozë të ndezur. Me penelatë linjëhollë është vizatuar një shpend i ngjyrosur me të kuqe dhe me nuanca jeshile. D. 6,5 cm. Nr. 122.

6) Broke. Gjetur në Termat. Argjilë okër në rozë. Trup cilindrik, grykë tërfili dhe fund i sheshtë. Lyer nga jashtë me glazurë të verdhë. Zbukuruar me penelata jeshile (spirale dhe njolla), si dhe me linja zgrafitoje të kafejta, që ndërpresin njëra tjetrën. L. 22,5 cm. Nr. inv. 2608.

Tab. X (1, 4. 5. 7-20)

1) Fragment pjate. Gjetur në Macellum. Argjilë okër në rozë. Lyer nga brenda dhe jashtë me glazurë bezhë në portokalli. Me anën e penelatave kafe dhe jeshile janë bërë motivet florale. Përmasat: 8,5 x 5,5 cm. Nr. inv. 20.

4) Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjilë ngjyrë okër me nuanca rozë. Lyer nga brenda dhe paksa nga jashtë me glazurë krem në okër. Me penelata të zeza janë bërë rrathët koncentrikë dhe ornamente me motive të zemrave të lyera me ngjyrë violet dhe jeshile. D. 10 cm. Nr. inv. 107.

5) Fragment ene. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë ngjyrë kafe të hapët. Lyer me glazurë jeshile. Me penelatë grafiti është bërë figura e një rombi me diagonale të zgjatura. Përmasat 3,5 x 3,5 cm Nr. inv. 438.

7) Fragment katruveje Gjetur në amfiteatër. Argjilë kafe e çelur. Lyer nga jashtë me zmalt të bardhë dhe me nuancë të verdhë. Zbukuruar me kombinimin e dy teknikave zgrafito linjash rrethore e valëzuese, njolla jeshile dhe pika të kafenjta. D. i barkut 19 cm. Nr. inv. 5750.

8) Fund ene. Gjetur në amfiteatër. Argjilë rozë. Lyer nga brenda me glazurë bezhë. Me penelata jeshile është pikturuar një

rozetë. Çdo petal i saj përshkohet në mes nga një varg pikash të zeza. D. 6 cm. Nr. inv. 523.

9. Fund ene. Gjetur në kala. Argjilë me pjekje kafe në rozë. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë. Me penelata shumëngjyrëshe është bërë figura e një peshku. D. 7,2 cm. Nr. inv. 44.

10) Dyvegjake e pjesëshme. Gjetur në Macellum. Argjilë e kuqe. Trup sferik, qafë trungkonike fund i sheshtë. Lyer me glazurë të tejdukshme dhe me nuanca të verdha. Me penelatë jeshile të errët janë bërë motivet spiralike. L. 15 cm. Nr. inv. 639.

11) Broke. Gjetur në amfiteatër. Argjilë kafe e çelur. Trup sferik, fund i sheshtë. Lyer me glazurë jeshile. Me penelata jeshile ulliri janë bërë motivet vegjetale. L. 14 cm. Nr. inv. 866.

12) Fund ene. Gjetur në varrezën mesjetare. Argjilë e kuqe. Lyer me glazurë të verdhë. Me penelata jeshile dhe kafe është bërë motivi floral. D. 9 cm. Nr. inv. 240.

13) Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjilë me ngjyrë kafe të çelët. Lyer me glazurë të verdhë. Me penelata jeshile janë bërë motivet dhe linjat valëzuese. D. 15.2 cm. Nr. inv. 312.

14) Fragment tasi. Gjetur në Kala. Argjilë me pjekje kafe të çelët në okër. Lyer nga brenda me glazurë të verdhë. Me linja të kafejta janë bërë rrathë koncentrike dhe me të kuqe motivi i rrjetës. Diam. 16 cm. Nr. inv. 157.

15) Pjesë e një dyvegjakeje. Gjetur në Macellum. Argjilë ngjyrë okër dhe nuanca rozë. Trup sferik, fund i sheshtë. Lyer me gla-zurë të verdhë. Me penelata jeshile është pikturuar motivi floral. L. 13,8 cm. Nr. inv. 419.

16) Pjesë fundi pjate. Gjetur në Kala. Argjilë kafe me nuanca rozë. Lyer me glazurë të verdhë. Me linja të zeza është vizatuar një gjethe fieri. D. 7,2 cm.

17) Fragment brokeje. Gjetur në amfiteatër. Argjilë me ngjyrë të kuqe. Trup sferik, qafë cilindrike, fund i sheshtë. Lyer me glazurë jeshile. Me penelata jeshile të errëta është bërë motivi floral (?). L. 15 cm. Nr. inv. 1587.

18) Pjesë një katruveje. Gjetur në amfiteatër. Argjilë okër në të kuqe. Trup sferik, qafë e hollë cilindrike fund i sheshtë. Lyer me glazurë të verdhë në okër. Me penelata jeshile janë bërë motive spirale. L. 15 cm. Nr. inv. 2345.

19) Fund tasi. Gjetur në Kala. Argjilë me pjekje kafe në të kuqe. Me penelata jeshile është pikturuar motivi floral. D. 10 cm. Nr. inv. 108.

20) Pjesë brokeje. Gjetur në amfiteatër. Argjilë kafe në okër. Trup sferik, qafë cilindrike dhe fund i sheshtë. Lyer me glazurë gjysmë transparente. Me penelata jeshile janë vizatuar motivet spiralike dhe valëzuese. L. 13 cm. Nr. inv. 6003.

PËRFUNDIME

Nga shqyrtimi i lëndës doli se aty nga fundi i shek. X nisën të prodhoheshin për herë të parë në Durrës tasat e tipit bizantin me glazurë jeshile-ulliri dhe ngjyrë mjalti mat. Këto prodhime të para plotësonin nevojat e qytetit dhe të krahinës përreth tij.[22] Ka të ngjarë që gjatë gjithë mesjetës së mesme, ndoshta edhe më përpara, Durrësi të ketë qenë tregëtuesi kryesor i mallrave të luksit të kësaj kategorie enësh, madje siç dëshmohet në dokumenta të shek. XIV, këto prodhime të qeramikës së hollë kanë qenë të preferuara si mallra eksporti dhe për qytetet e tjera të Mesdheut.[23]

[22] Hoti, Ndihmesë.... 1. 263.
[23] Ducellier. La façade.... f. 388.

Pas shek. XI, në prodhimet e poçerisë durrsake përdoret gjerësisht glazurimi i kategorive kryesore të enëve të tryezës. Madje një pjesë e mirë e kësaj lënde zbukurohej me motive të shumëllojshme.

Enët e pikturuara me teknikën e zgrafitos me sa duket që në fillim u mbështetën tek format dhe motivet dekorative e enëve të punishteve të njohura bizantino lindore dhe jugore (Kostandinopojë, Nesembër, Korinth etj.). Në poçerinë e Durrësit ndeshet në një shkallë relativisht të gjerë stili zbukurues me teknikën e zgrafitos. Kjo gjini e qeramikës përmban disa elementë jo vetëm të formës, por dhe të dekorit, që dallohen nga ato të poçarisë së qyteteve të tjera të Bizantit. Ndër enët me veçori origjinale janë ato të zbukuruara me ndërthurje spiralesh dhe motive vegjetale (tab. IV, 1-10), enët e pikturuara me figura njerëzore (tab. IV, 13). etj.

Përsa i takon mënyrës së zbukurimit të shomplevës, kjo teknikë në repertorin e enëve të Durrësit është futur relativisht vonë, pas shek. XIII.

Numri i pakët i enëve të zbukuruara me shomplevë tregon për atë se mundësitë aplikimit të saj, me sa duket, kanë qenë më të pakta.

Edhe teknika e zbukurimit në reliev, është aplikuar në mënyrë të kufizuar. Motivet e realizuara në disa enë duket se janë frymëzuar nga modelet e njohura bizantine. Për këtë dëshmon edhe prania e importit korintas të shek. XII, ndërsa zbukurimet e bëra në faqet e jashtme të tyre flasin për një veçori specifike të prodhimit vendas.

Qeramika protomajolike e Durrësit përfaqësohet me një numër relativisht të pasur enësh të zbukuruara me motive të larmishme. Enët e zbukuruara me ornamente vegjetale përbëjnë një

tipar të përbashkët me ato të qyteteve mesdhetare. Me sa duket në gjysmën e parë të shek. XIII, nga punishtja e Durrësit filluan të prodhohen tasat e parë të kësaj kategorie, duke iu përmbajtur formave dhe stilit zbukurues të qendrave poçare mesjetare të Mesdheut, me të cilat Durrësi ka patur lidhje të vazhdueshme tregëtare e kulturore.[24] Këto modele enësh tipike për proto-majolikën mesdhetare u prodhuan në mënyrë pak a shumë të ngjashme edhe nga punishtja e Durrësit. Pas mesit të shek. XIII dhe deri në fundin e tij vihet re një zbehje dhe shkëputje nga motivet e mëparshme. Tasat dhe fragmentet e tyre të zbukuruara me motive të veçanta: figura njerëzore, kafshe, motive florale etj. dëshmojnë për një aplikim të ri dekorativ e veçori origjinale të kësaj gjinie qeramike në Durrës.

SHKURTIME

Alb. Schätze	Albanien Schätze aus dem Land der Skipetaren, Mainz 1988.
Anamali, Ballsh	Anamali. S. Gërmimet arkeologjike të vitit 1983 në Ballsh, Iliria 1983, 2.
Anamali-Spahiu, Shkodër	Anamali. S. Spahiu. II. Shkodër, Germimet arkeologjike të vitit 1984, «Iliria 1984, 2.
Ayalon Frammenti	Ayalon Myriam Rosen. Frammenti islamici nel Museo di Faenza. Faenza», 1982, I-II,
Barnea, Garvan	Barnea, J. Garvan Dinogeția, București 1961.
Burime tregimtare	Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, Tiranë 1975.
BYZANTINH KAI	BYZANTINH KAI METABYZANTINH TEXNH, AΘHNAI, 1986.
Cimbulera, Vases	Čimbuleva, J. Vases à glaçure en argjilë blanche de Nessebre IX-XIIe s.), Nessebre II, Sofia, 1980.

[24] Po aty

Comsa. Cultura	Comsa, M. Cultura materială veche românească, Bucuresti, 1978.
Conton, Le antiche	Conton, L. Le antiche ceramiche veneziane scoperte nella Laguna, Venezia. 1940.
Gardelli, Ceramiche	Gardelli, G. Ceramiche del Medioevo e del Rinascimento, Ferrara. 1986.
Ducellier, La façade	Ducellier, A. La façade maritime de l'Albanie au Moyen age (Durrazo et Valona du XIe au XIVe siècle), Thessaloniki 1981.
Hoti, Ndihmesë	Hoti, A. Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit. Iliria, 1987, 1.
Hoti (Lagjja 11)	Holi, A. Gërmimet arkeologjike të vitit 1984 në Durrës (Lagija 11), "Iliria" 1984. 2.
Hoti, Durrës-Kalaja	Hoti. A. Gërmimet arkeologjike të vitit 1986 në Durrës (Kala) "Iliria", 1986, 2.
Hoti, Durres-Qytet	Hoti, A. Durrës-qytet, «Iliria", 1987, 2.
Huyghe, L'Art	Houyghe R. L'Art et l'Homme, Paris 1958.
Komata, Të dhëna	Komata, D. Të dhëna të reja arkeologjike nga kalaja e Krujës, Iliria» 1982, 1.
Komata, Të dhëna për qytetin	Komata, D. Të dhëna për qytetin arbëror (shek. VII-XI), «Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe kulturës së tij. (Tirane 2-5 korrik, 1982), Tiranë, 1988.
Komata, Rezultatet	Komata, D. Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në kalanë e Kaninës (Rrethi i Vlores) në vitet 1971 e 1973, Buletin Arkeologjik 4, 1974.
Komata, Qendërbanim	Komata, D. Qendërbanimi i fortifikuar i Kaninës në rrethin e Vlorës, "Buletin Arkeologjik", 5, 1975.
Komata, Qyteti iliro-shqiptar	Komata, D. Qyteti iliro-shqiptar i Kaninës (monografi, përgatitur për botim).
Komata, Kalaja Gjirokastrës	Komata, D. Kalaja e Gjirokastrës, gërmimet arkeologjike të vitit 1983, Iliria, 1983, 2.

Kult. Byzan.	Cultura byzantina in Romania, Bucureşti, 1971.
Lako, Rezultatet	Lako K. Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Butrint në vitet 1975-1976, Iliria" 1981, 1.
Lahi-Hoxha, Shkodër-Kala	Lahi, B., Hoxha, G. Shkodër-Kala, Gërmime arkeologjike të vitit 1987, "Iliria" 1987, 2.
Lahi-Hoxha, Kalaja Shkodrës	Lahi, B.-Hoxha, G. Kalaja e Shkodrës, Gërmime të vitit 1986, Iliria, 1986, 2.
Lazarev, Istorija	Lazarev, V.N. Istorija vizantijskij zivopisi I1, Moskva 1948.
Morgan, The Byzantine	Morgan, H.C. The Byzantine Pottery, «Corinth» XI, 1942.
Muçaj, Qyteza	Muçaj S. Qyteza mesjetare e Mashkjezés, «Iliria» 1984, 1.
Muçaj, Cakran	Muçaj, S. Cakran, Gërmimet arkeologjike të vitit 1983, "Iliria" 1983, 2.
Myrto, Durrës-qytet	Myrto, H. Durrës-qytet, Gërmimet arkeologjike te vitit 1987, Iliria 1987, 2.
Nicolacopoulos, Ceramiques	Nicolacopoulos, G. Céramiques encastrées des anciennes eglises de Grèce, «Faenza» 1981, 1-6.
Od arheoloskolu	Od arheološkoto Bogatsvo na SR Makedonija, Makedonija, Skopje, 1980.
Patitucci Uggeri-Protomaiolica	Patitucci Uggeri, S. Protomaiolica Brindisina Gruppo I, Faenza VI, 1979.
Popović, Importation	Popović, M. Importation et production locale de céramique à Ras (in 11eme debut 13 me siècles), "Colloque sur la céramique byzantine"
Talbot-Rice, Byzantine	Talbot-Rice, D. Byzantine glazed Pottery, Oxford, 1930.
Saraçi, Kalaja	Saraçi, Gj. Vau i Dejës, Gërmimet arkeologjike të vitit 1984, Iliria 1984, 2.
Spahiu, Rezultatet	Spahiu, H. Rezultatet e gërmimeve të vitit 1974 në kalanë e Beratit, Buletin Arkeologjik 5, 1975.

Tartari, Lëndë	Tartari, F. Lëndë arkeologjike nga Petra (Shkëmbi i Kavajes), Buletin Arkeologjik 5, 1975.
Tartari, Durrës-qytet	Tartari, F. Durrës-qytet, Gërmimet arkeologjike të vitit 1987, Iliria 1987, 2.

RESUMÉ
RECIPIENTS A GLAÇURE DECOUVERTS A DURRES
(X-XV SIECLES)

Les fouilles archéologiques et les divers travaux effectués dans la ville de Durrës ont dégagé un matériel abondant de céramique à glaçure qui date de la période médiévale. Les récipients faits d'une pâte argjilëuse propre de couleur rouge tirant sur le rose, avec ou sans décoration, forment le plus grand nombre d'objets céramiques à glaçure. Viennent ensuite les autres récipients d'argjilë également propre de couleur oere tirant sur le blanc aux tons verts, dont la plupart sont décorés. Les récipients à glaçure se répartissent en deux groupes:

A) Récipients à glaçure non décorés (pl. I, 4 à 18; II, 4 à 21). Parmi eux, les bols à glaçure vert olive (pl. I, 5, 6, 11 à 13) ainsi que ceux en couleur de miel suscitent notre intérêt. Ils ont été découverts avec des monnaies datant des Xe et XIe siècles. Les autres bols à glaçure jaune, brune, vert clair, brun tirant sur le chocolat etc. (pl. I, 7, 8, 10, 14 à 18; II, 4 à 21) étaient associés avec des monnaies des XIIIe et XIVe siècles.

B) Récipients à glaçure décorés. Ils se divisent en trois catégories:

1) récipients décorés avec la technique du sgraffite

(pl. I, 1 à 3; II, 2, 3; III, 1 à 19) et du champ élevé (pl. V, 1, 2, 4, 5, 8. 9) à glaçure verte, jaune, crème, brune, chocolat etc. Parmi les éléments décoratifs il y a le cercle rempli d'arcs ou de spirales, les figures anthropomorphes, les oiseaux et les motifs végétaux. Les récipients de cette catégorie se situent entre les XIe et XVe siècles.

2) recipients décorés par des motifs en relief à glaçure brune tirant sur le chocolat (pl. II, 1), brune tirant sur le rose (pl. X, 3) et jaune (pl. X, 6). Ils portent en décoration la figure d'un oiseau, des motifs onduleux. Les récipients de cette catégorie datent des XII et XIIIe siècles.

3) récipients peints polychromes (pl. V, 3, 11, 12; VI, 1 à 4: VII, 1 à 5; VIII, 1 à 8: IX, 1 à 6; X, 1, 4, 5, 7 à 20) généralement enduits d'émail jaune et vert. En font exception les récipients protomaioliques (pl. VI 2 à 4; VII-VIII, XII-XIII) qui sont enduits de glacure blanche et ocre. Les récipients de cette catégorie portent en décoration des motifs végétaux, des ligures anthropomorphes, zoomorphes, géométriques etc. Ils se situent entre le XII et le XVe siècles.



Tab. I – Shek. X-XI (nr. 1-6, 9, 11-13);
shek. XII-XIV (nr. 7-8, 10, 14-18)



Tab. II – Shek. XIII- XIV



Tab. III – Shek. XII-XIV



Tab. IV-Shek. XIII-XIV



Tab. V – shek. XIII-XIV (nr. 1, 2, 4, 5, 8, 9, 11);
shek. XV (nr. 6, 7, 10, 12).



Tab. VI - Shek. XIII.



Tab. VII – Shek. XIII



Tab. VIII – Shek. XIII



Tab. IX -Shek. XIII-XIV



Tab. X – Shek. XII (nr. 1-3, 5-6, 8, 12-13, 15, 19);
Shek. XIII-XIV (4, 7, 9, 10, 11, 14, 16-18, 20).



Tab XI



Tab XII



Tab XIII



Tab. XIV

MONEDHA PERANDORAKE BIZANTINE NGA DURRESI (491-1025)[1]

Në muzeun arkeologjik të Durrësit ruhet një koleksion me monedha bronzi perandorake bizantine, nga i cili deri më sot është bërë i njohur vetëm një numër i kufizuar[2]. Katalogu që po paraqesim përbëhet nga monedha të pabotuara, prerje që i përkasin harkut kohor nga fillimi i sundimit të Anastasit I (491) deri në fundin e mbretërimit të Vasilit II (1025)[3].

Në fondin e monedhave të përfshira në katalogun tonë bëjnë pjesë 126 copë bronzi dhe 1 ari. Ato vijnë nga gërmimet në termat e shekujve të parë të erës sonë dhe në amfiteatër[4], në kala dhe në sheshin e tregut të antikitetit të vonë[5], si dhe nga gjetje rasti në qytet dhe në rrethinat[6]. Kjo sasi, që përbëhet nga prerje

1 Hoti Afrim, Myrto Halil. Monedha perandorake bizantine nga Durrësi (491-1025). Në "Iliria", vol. 21, 1991. f. 91-122;
https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1991_num_21_1_1583

2 H. Spahiu, Monedha bizantine të shek. V-XIII të zbuluara në territorin e Shqipërisë, «Iliria» IX-X, f. 353-394; A. Hoti, Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit, «Iliria», 1987, 1, f. 249, fig. 1.

3 Pjesa tjetër e monedhave bizantine të perandorëve në vijim, që numerikisht është shumë më e madhe, mbetet për një punim të ardhshëm.

4 V. Toçi, Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir të Dyrrahut në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike, Konferenca e Parë e Studimeve albanologjike, Tiranë, 1965, f. 461 dhe Amfiteatri i Dyrrahut, «Monumentet», 1970, 2, f. 39.

5 A. Hoti, Gërmime arkeologjike të vitit 1984, «Iliria», 1984, 2, f. 275; të vitit 1986, Iliria, 1986, 2, f. 269; të vitit 1987, Iliria», 1987, 2, f. 261; të vitit 1988, «Iliria, 1988, 2, f. 272.

6 Pjesa më e madhe është mbledhur në pika të ndryshme të qytetit, si gjetje rasti, nga një grup pionierësh të drejtuar nga H. Myrto.

të 18 perandorëve, me përjashtim të një boshllëku prej 150 vjetësh (683-830), mbulon tërë periudhën kohore që përmendëm.

Duke marrë si pikënisje kohën e Anastasit I, u jemi përmbajtur kritereve të reja për katalogimin e monedhave perandorake bizantine, sikundër i kemi ndjekur ato edhe për sa i përket renditjes sipas secilit perandor, punishtes monetare, llojit të metalit, vlerës së monedhës dhe, pastaj, vitit të prerjes[7].

Monedhat që kemi në dispozicion ndahen në dy faza, që në fakt përputhen me periodizimin e përgjithshëm që u është bërë monedhave bizantine[8].

Në fazën e parë përfshihen monedhat e prera nga Anastasi I deri tek Konstandini IV Pogonati (491-683), ku numrin më të madh e përbëjnë ato të Anastasit I, të Justinianit I dhe të Justinit II. Bronzet e Anastasit I përbëhen nga ato me vlera të mëdha (follis) deri nga ato më të voglat (pentanumia dhe 2 1/2 numia), por, nga gjithsej 13 copë të tij, 12 rezultojnë të prera pas vitit 507.

Justini I përfaqësohet vetëm me dy monedha. Numri i monedhave të Justinianit I tregon një rritje (19 copë). Pastaj vijojnë monedhat e perandorëve të tjerë të kësaj faze: Justini II (9 copë), Tiber Kostandini dhe Maurik Tiberi (nga një copë), Foka (6 copë), Herakliu I dhe Konstandini IV Pogonati (nga një copë) ndërsa Konstanci II në kohën midis tyre përfaqësohet me 6 copë.

[7] Shih W. Wroth, Imperial Byzantine Coins in the British Museum, Chicago, 1956, f. XII dhe W. Hahn, Monete Imperii Byzantini, Band I, Wien, 1973. Në katalog janë vënë datat për secilën monedhë, duke filluar nga viti XII u Justinianit I (533/39) e deri në gjysmën e dytë të shek. VII, d.m.th. për tërë kohën që ato e përmbajnë atë. Eshtë bërë gjithashtu një klasifikim i bazuar mbi kritere më të sakta për sa u përket monedhave të Janit I Zimiskit dhe Vasilit II (shih W. Wroth, vep. cit., 480-483) në krahasim me literaturën e përdorur më parë në vendin tonë (J. Sabatier, Description générale des monnaies byzantines, Leipzig, 1930).

[8] Shih W. Wroth, vep. cit., f. LXXXVI.

Natyrisht shifrat tona janë të vogla për të bërë krahasime, megjithatë bie në sy se gjatë kësaj faze numri i monedhave të prera nga perandori Justinian I është më i madh dhe kjo gjë na kujton faktin e njohur se gjatë kohës së sundimit të tij, Durrësi shikohej si një vend i sigurt për ruajtjen e vlerave monetare[9].

Rënia numerike që vihet re me Justinin II, dhe sidomos pas tij, është një dukuri e konstatuar edhe në qendra të tjera mesjetare të vendit tonë[10]. Kjo rënie është karakteristike edhe për viset fqinje. Kështu, është thënë se sasia e monedhave bizantine pas vitit 522 në Korint e Athinë tregon një rënie «dramatike»[11].

Mungesa e plotë e monedhave për kohën nga 683 deri më 830 është gjithashtu një dukuri e vërejtur në tërë vendin tonë[12]. Kjo, përveç shkaqeve më të ngushta, që ende nuk i njohim, gjen një shpjegim edhe me krizën e përgjithshme të sistemit financiar që preku tërë perandorinë, duke filluar nga koha e Konstancit II (mesi i shek. VII) e deri në fundin e shek. VIII[13].

Faza e dytë, që nis me monedha të prera nga perandori Theofil, përkon, do të thonim, jo rastësisht me kohën e krijimit të Temës[14]. Në katalogun tonë ky perandor në fakt përfaqësohet vetëm me një monedhë. Pastaj vijojnë monedha të Vasilit I (5

[9] Mbretëresha e gotëve, Arnalasuntha, në atë situatë turbullirash, vendosi ta transferonte arkën e shtetit të saj nga Ravena në Durrës (E. Chrysos, Simiroli stin Istoria tis Iperioi kata tin proto vizantini epohi (4-7), «Ipeirotika», tomos 23. Ioanina, 1981, f. 98.

[10] H. Spahiu, art. cit. (pasqyra statistikore).

[11] D. Metealf, The mint of Thessalonica in the Early Byzantine Period, Revue Numismatique, XXI, 1979, f. 117.

[12] H. Spahiu, art. cit. (pasqyra statistikore).

[13] J. Ferluga, Sur la date de la création du Theme de Durrachium, Actes du Congrès Intern. d'Etudes Byzantines II, Belgrade, 1964, f. 84; H Ahrwailer, Byzance et la Mer, Paris, 1966, f. 59, 71.

[14] J. Ferluga, art. cit., f. 85.

copë), të Leonit VI (30 copë). perandor ky që deri më sot përfaqësohet këtu me më shumë monedha. Vijojnë pastaj monedha të Romanit I (3 copë), të Konstandinit VII dhe të Nikiforit II Foka (nga 3 copë secili), me një rritje për kohën e Janit I Zimiskit (11 copë) dhe të Vasilit II (12 copë).

Duhet thënë se në sasinë e përgjithshme të monedhave të katalogut tonë, ndonëse jo e konsiderueshme, bëjnë pjesë dhe tipa e variante të panjohura më parë nga botimet në vendin tonë, siç janë (në katalog): nr. 5, 6, 8, 11, 13 (të Anastasit I), nr. 14, 15 (të Justinit I). nr. 16, 18, 19, 21-23, 27-29, 32, 33 (të Justinianit I). nr. 35, 36. 38-40 të Justinit II), nr. 45 (e Maurik Tiberit), nr. 46, 47-51 (të Fokës), nr. 52 (e Herakliut I), nr. 54-57 (të Konstancit II), nr. 59 (e Konstandinit IV Pogonatit), nr. 99-101 (të Konstandinit VII Porfyrogjenetit), pa mundur të bëjmë krahasim për monedhat e Janit I Zimiskit dhe të Vasilit II që janë botuar më parë, mbasi janë kataloguar mbi kritere të vjetruara. Për sa i takon qarkullimit të monedhave me prejardhje nga punishte të ndryshme perandorake, për kohën që ato kanë funksionuar krahas atyre të kryeqytetit, vihet re se nga Konstandinopoja vijnë 22 copë, nga Selaniku 14 copë, nga Nikomedia një copë. nga Kyzyku 5 copë, nga Antiokia 3 copë, nga Kartagjena 8 copë, nga Sicilia 2 copë dhe nga një punishte e papërcaktuar 3 copë. Në këtë mënyrë listës së punishteve monetare perandorake bizantine, të njohur më parë në vendin tonë, i shtohen dhe dy të reja (Kartagjena, Sicilia).

Koleksioni që trajtuam, ndonëse ende i vogël, përbën një tregues të zhvillimit ekonomik e kulturor, me luhatjet e veta, të diktuara nga rrethanat e ndryshme politike që përjetoi qyteti gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme.

KATALOG

ANASTASI I - (11.4.491 - 1.7.518)

Bronze

Konstandinopol

Follis (1.9.507 - 1.9.512)

F. DNANASTASIVSPPAVIG. Busti i Anastasit I, pa mjekër, në profil dj., me diademë, pancir dhe paludamentum (mantel ushtarak). Shp. Shenja M; lart kryq; në të dj., yll; në të m. yll; poshtë: A; në segment: CON.

1. AE ↓ 16.50 gr. 3 mm (tab. I, 1). Gjetje rasti në qytet, nr. 207[15].

2. Krs. W. Hahn, vep. cit. V. I, tab. 2 dhe pragtab. II, nr. 23. AE 18.40 gr, 34 mm (tab. I, 2).

F. ↓ Si nr. 1

Shp.Si nr. 1; poshtë B.

Gjetje rasti në qytet, nr. 98.

W. Hahn, po aty., nr. 23.

3. AE ↓ 18 gr, 34 mm.

F. Si nr. 1.

Shp.Si nr. 2.

Gjetur në Macellum (më poshtë e shënuar me M.K.), v. 1987, nr. 922.

[15] Numrat rendorë janë ata të regjistrave provizorë (të gërmimeve).

4. AE ↓ 18.30 gr, 35 mm.

F. Si nr. 1.

Shp.Si nr. 2.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 922/1.

5. AE ↓ 18,10 gr, 33 mm. (tab. I, 3).

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 2; në të m. e paqartë.

Gjetur në M.K., 1988, nr. 3543.

Follis (1.9.512 - 1.9.517).

6. AE ↓ 17.90 gr, 36 mm (tab. I, 4).

F. Si nr. 1; legjenda lexohet me vështirësi:

DNANASTASIVSPP...

Shp. Si nr. 1; poshtë: Γ

Gjetje rasti në qytet. nr. 58.

W. Hahn, vep. cit., po aty. nr. 271.

Për një monedhë të tillë me prejardhje nga Durrësi, shih H. Spahiu, art. cit.. f. 366, nr. 47.

7. AE ↓ 17.80 gr, 35 mm (tab. I, 5).

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 1; poshtë: Δ

Gjetur në M.K., 1987, nr. 922/2. W. Hahn, po aty, nr. 272.

8. AE ↓ 9.89 gr., 34 mm (tab. I, 6).

F. Si nr. 1; legjenda: [DNANASTA] SIVSPPAV.

Shp. Si nr. 1: poshtë: Є

Gjetur në Fushë-Qerret 1987, nr. 418. W. Hahn, po aty. nr. 28.

9. AE ↓ 14.35 gr, 34 mm.

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 8.

Gjetje rasti në qytet, nr. 95.

10. AE ↓ 15.40 gr, 34 mm.

F. Si nr. 1; legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 8.

Gjetur në amfiteatër, 1969, nr. 2703.

Pentanumia (1.9.517 - 1.7.518).

F. DNANASTASIVSPPA IVG. Busti i Anastasit I dj., me diademë, pancir dhe paludamentum.

Shp. Shenja  me dy kokrriza lart dhe poshtë shtagës se mesit përpara, A.

11. AE ↑ 2.50 gr, 14 mm (tab. I, 7).

Gjetje rasti në qytet, nr. 921.

W. Hahn, vep. cit. V. I, tab. 3 dhe pragtab. II, 39.

12. AE ↑ 2.19 gr, 13 mm.

F. Si nr. 11; legjenda jo e plotë... SIVSPPAV.

Shp. Si nr. 11.

Gjetje rasti në qytet, nr. 920.

2 1/2, numia (11.4.491- 498).

F. Legjenda rrethore e fshirë. Busti i Anastasit në profil dj.

Shp. Monogrami i Anastasit brenda një kurore: 

13. AE ↓ 0.98 gr, 9 mm (tab. I, 8).

Gjetje rasti në qytet, nr. 922.

Krs. W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 2 dhe Pragtab. II, nr. 40 (ku në monogram mungon kryqi).

JUSTINI I (19.7.518 - 1.8.527)

Bronze

Selanik

Follis (1.9.522 - 4.4.527).

F. DNIVSTI NVSPP AVG. Busti i Justinit I, me kurorë, në profil dj. me diademë, pancir dhe paludamentum.

Shp. Shenja M; lart kryq; në të m. yll; në të dj. yll. Në segment... SO.

14. AE ↓ 13.52 gr, 30 mm (I, 9).

Gjetje rasti në qytet, nr. 21.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 11 dhe Pragtab. IV, nr. 70.

Gjysmëfollis

F. DNIVSTINVSPPAVG. Busti i Justinit I, në profil dj., me diademë, pancir dhe paludamentum, duke mbajtur në dorën e dj globin me kryq të mbivendosur; figura në përgjithësi mjaft e fshirë.

Shp. Shenja K; në të m. një kryq i gjatë; në të dj. yll; lart kryq; në segment: TES

15. AE ↓ 19 mm, 4.30 gr.

Gjetur në M.K.. 1987, nr. 4229.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 10 dhe pragtab. IV, nr. 72.

JUSTINIANI I (1.8.527 - 14.11.565)

Bronze

Konstandinopojë

Follis (1.9.532 - 1.9.537).

F. DNIVSTINIANVISPPAV. Busti i Justinianit I, pa mjekër, në profil dj.. me diademë, pancir dhe paludamentum.

Shp. Shenja M: lart kryq; në të m. yll; në të dj. kryq: poshtë A; në segment: CON,

16. AE ↓ 16.50 gr. 30 mm (tab. I, 10).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 702.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 19, pragtab. VII, nr. 84

Gjysmëfollis (1.9.537 - 538).

F. Legjenda rrethore e fshirë: [DNIVSTINIANVSPPAVG]. Busti i perandorit në profil dj., me tiparet mjaft të fshira.

Shp. Shenja K; në të m. një kryq i gjatë; në të dj. Є lart dhe poshtë yll; në segment: CON.

17. AE ↓ 7.65 gr. 26 mm.

Gjetur në termat. 1960, nr 291.

W. Hahn, rep. cit.. v. I. tab. 20 dhe pragtab. VII, nr. 91.

Selanik

Gjysmëfollis (511 - 512).

F. [DNIVSTINIANVS] PPAVG. Busti i Justinianit I, pa mjekër, përballë, me përkrenare dhe pancir, duke mbajtur globin

me kryq të mbivendosur në dorën e dj. dhe në të m. mburojë; në fushë, djathtas, një kryq.

Shp.Shenja K: lart, kryq: në të dj. (vertikalisht) ANNO; në të m. X4 në segment: TES

18. AE ↓ 11.10 gr, 22 mm.

Gjetur në M.K., 3544.

Gjysmëfollis (548 - 549).

19. AE ↓ 4.90 gr.. 22 m (tab I. 11.)

F. Si nr. 18.

Shp.Si nr. 17; në të m. XXII.

Gjetur në M.K. 1987, nr. 3516.

IS (16 numia) (540 - 542).

F. Legjenda rrethore e lexueshme jo mirë: mirë: DNIVSTINIANVSPPAVG. Busti i Justinianit (deri diku i fshirë) me diademë, parzmore dhe paludamentum, dj.

Shp. Shenja IS; në të m., A. në të dj. P; në segment TES

20. AE ↓ 7.78 gr. 20 mm (fab. I, 12).

Gjetje rasti në qytet, nr. 123.

W. Hahn, vep. cit., v. 1, tab. 29 dhe pragtab. VIII, nr. 169 a2.

Δ (4 numia) (538 - 1.9.542).

F. Si nr. 20; legjenda jo e plotë... PPAVG.

Shp. Shenja Δ lart kryq; në të m. A; në të dj. P.

21. AE ↓ 1.80 gr. 15 mm (tab. II, 1).

Gjetur në M.K., 1986, nr. 3547.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 30 dhe pragtab. VIII. 176 a.

Kyzyk

Follis (532/33)

F. [DNIVSTINIAN]VSPPAV Busti i Justinianit I përballë, me përkrenare dhe parzmore, duke mbajtur globin me kryq të mbivendosur me dorën e dj.; në dorën e m. mburojë; në fushë, djathtas, kryq. Shp. Shenja M; lart, kryq: poshtë, A: në të m. (vertikalisht).

ANNO; në të dj.  në segment: KYZ.

22. AE ↓ 10.35 gr, 28 mm (tab. II, 2).

Gjetje rasti në qytet, nr. 208.

Krs. W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 24 dhe VII, 120.

Follis (542/543).

23. AE ↓ 19.50 gr, 38 mm (tab. II, 3).

F. Si nr. 22; legjenda e plotë.

Shp. Si nr. 22; në të dj. 

Gjetje rasti në qytet, nr. 209.

24. AE ↓ 16,90 gr, 35 mm.

F. Si nr. 22; legjenda e plotë.

Shp. Si nr. 22; në të dj. 

Gjetur në bazilikën e Gjuricajt, 1989, nr. 106.

Antiok (Theopolis)

Follis (para vitit 538)

F. DNIVSTINI]ANVSPPAV. Busti i Justinianit I në profil dj. me diademë, pancir dhe paludamentum (figura e dëmtuar).

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë A; në të dj. yll; në segment: MAN.

25. AE ↓ 15.68 gr, 30 mm (tab. II, 4).

Gjetur në M.K., 1986, nr. 786.

Gjetur në M.K., 1986, nr. 786.

J. Sabatier, «Description générale des monnaies byzantines», I, Leipzig, 1930, tab. XIII, 9.

Follis (550/51):

F. DNIVSTINIANVSPPAVG. Busti i Justinianit I, pa mjekër, përballë, me helmetë dhe pancir; në dorën e dj. mban globin me kryq të mbivendosur; në të m. mburojë me emblemën e kalorësit; në fushë, djathtas, kryq.

Shp.Shenja M; lart, kryq; poshtë ; në të m. (vertikalisht) ANNO, në të dj.;  në segment: 

26. AE ↓ 18,20 gr. (tab. II, 5).

Gjetur në Qerret, nr. 1063.

Krs. W. Wroth, vep. cit., f. 60, nr. 327, tab. IX, 5.

Gjysmëfollis (1.9.532 - 1.9.537)

F. DN IVSTINIANVSPPAV. Perandori ulur në fron, përballë, duke mbajtur skeptrin në dorën e di. dhe globin me kry në dorën e m.; është i veshur me rrobën e gjatë; në kokë mban përkrenare me pendë.

Shp.Shenja K; në të m. një kryq i gjatë ndërmjet shkronjave



në të dj. 

27. AE ↓ 9.70 gr., 25 mm (tab. II, 6).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 3545.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 25 dhe pragtab. VIII, 135.

Kartagjenë

Follis (para vitit 538).

F. DNIVSTINI ANVSPPAV. Busti i Justinianit I në profil dj.

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë; në të dj., kryq; në të m. kryq; në segment: CAR.

28. AE ↓ 14.57 gr, 30 mm.

Gjetje rasti në qytet, nr. 923.

Krs. W. Wroth, vep. cit., f. 65, nr. 368.

Gjysmëfollis (536/537).

F. DNIVSTINIANVSPPAV Bust perballë i Justinianit I, me helmetë dhe pancir. duke mbajtur globin me kryq ne doren e dj.; në fushë, djathtas, një kryq.

Shp.Shenja K; lart kryq: poshtë SO; në të m. (vertikalisht) ANNO; në të dj. X; në segment: ..R.

29. AE ↓ 18.25 gr, 34 mm (tab.II,7)

Gjetur në nekropol, 1947, nr. 1144. Krs. Hahn, tab. 32 dhe pragtab. IX, nr. 196.

Gjysmëfollis (539/540).

F. DNIVSTINIANVSPPAV. Busti i Justinianit I, me helmetë dhe pancir, duke mbajtur globin me kryq në dorën e dj.; në fushë, djathtas, një kryq.

Muri (4,90 m i gjatë, 2,40 m i lartë) është ndërtuar me gurë gjysmë të punuar të lidhur me llaç gëlqereje e zhavorr të imët.

[18] H. Robinson, vep. cit., Pl. 46, M. 379; J. Perlzweig, vep. cit. Pl. 39, 2431.
[19] J. Sabatier, Description générale des monnaies byzantines, vol. 1, Leipzig, 1930, f. 183, Tab. XIII, 13 (për faqen), f. 183, Tab. XIV, 5 (për shpinën).

Enë balte: a) barqe amforash të zbukuruara me hullisa të krehëruara; b) fragmente vorbash të zbukuruara me hulliza valëzuese (Tab. VI, 5, VII, 8) Vorba me zbukurime të tilla datohen në shek. IX-XI1.[20]

Teknika e mureve, e njohur në disa fortifikime të antikitetit të vonë përreth Durrësit,[21] si dhe qeramika e kësaj periudhe përforcojnë mendimin e shprehur kohë më parë [22] se Kalaja e Turrës duhet të jetë ngritur në shek. V-VI e.sonë. Ndërsa fragmentet e enëve të kuzhinës dëshmojnë se ky fortifikim është përdorur edhe gjatë mesjetës së hershme.



Fig. 2



Fig.3

[20] A. Hoti, Rezultate të gërmimeve në Kalanë e Durrësit, 1983-1986, (dorëshkrim).

[21] Gj. Karaiskaj, A. Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth të antikitetit të vonë «Monumentet» 9, 1975, f. 5-25.

[22] H. Myrto, Hartë e… "Monumentet", 1982, 1, f. 23 ka vërtetuar se lagjja e poshtme e këtij fortifikimi, e quajtur Carinë, është banuar pa ndërprerje gjatë shek. I-VI e. sonë.

4. Kryevidh

Kodra e Kishës te Qafa e Thanës. Në majën dhe shpatet e kodrës u gjetën disa objekte arkeologjike.

Qeramikë ndërtimi: a) tulla të plota me përmasa 29 x 15,5 x 4 cm; 48 x 22 x 4,5 cm (Tab. II, 2, 4).

Enë balte: a) barqe shtambash të zbukuruara me hulliza (tab. VII, 18, 19); b) buzë vorbash (Tab. VIII, 2021); c) fragment pjate të glazuruar me jeshile dhe të zbukuruar me vija të zeza që paraqesin motivin e rrjetës (Tab. X, 8); c) një fragment tjetër ene tryeze prej balte të pastër me pjekje të verdhë në okër të glazuruar nga brenda me solucion të bardhë dhe të zbukuruar me vija të zeza që paraqesin motive arabeskash (Tab. X, 12). Nga pikëpamja e llojit të brumit dhe e teknikës së zbukurimit, ky fragment është thuajse i njëjtë me enët protomajolike[23] të fundit të shek. XII dhe fillimit të shek. XIII, të zbuluara në disa qytete të Mesdheut (Korint, Brindis etj.)[24] d) pjesë tasi prej brumi me pjekje të kuqe rozë, glazuruar nga brenda dhe jashtë me zmalt ngjyrë jeshile-ulli (Tab. X, 7). Këto enë i përkasin prodhimit durrsak të shek. X-XIII[25]. Edhe në rajonet pranë Kostandinopojës, tasa me veçori të tilla përcaktohen si prodhime bizantine të shek. XXI.[26]

[23] Termi protomajolike përdoret për të përcaktuar atë lloj qeramike të shek. XII-XIII, që, nga pikëpamja e përbërjes me argjilë ngjyrë peani dhe glazurë të bardhë, i përqaset, por nuk është majolike e vërtetë.

[24] Ch. Morgan, Corinth XI, fig. 18, A; S. P. Uggeri, Protomaiolica brindisina, Gruppo 1, Faenza, 66, 1979, Tab. LXXXII; C.

[25] F. Tartari, Lëndë..., f. 142.

[26] C. Nicolescu, Ceramika zmatuita din sec. X-XV in lumina ultimelor cercetari arheologice, SCIA VI, 1959, 2, f. 75

Duke u mbështetur në faktin se në pika të ndryshme të kësaj kodre ndeshen kocka njerëzish, mendojmë e Kodra e Qafës së Thanës gjatë shek. XIII duhet të jetë përdorur si varrezë.

Kodra e Kishës së Vlashës. Në majën e kësaj kodre është zbuluar një trakt muri (2,60 m x 0,90 m) i ndërtuar me gurë shtuforë të lidhur me llaç gëlqereje. Në faqen e brendshme të tij kishte mbetur pa u shkëputur një fragment suvaje i punuar me teknikën e afreskut (Tab. XII, 5). Fragmenti ka përmasa 5,5 x 4,5 cm e trashësi 1,6 cm. Mbi sfondin e verdhë në okër është realizuar pikturimi me shirita të kuq në kafe, në të cilët dalin bisqe e vija të bëra me penel të hollë. Ngjyrë tjetër me përdorim më të kufizuar dhe që përbën cipën e dytë të pikturimit, është një lloj solucioni i bardh pastoz, me anën e të cilit janë realizuar mbi shiritin e kuq disa pikëzime të bardha.

Qeramikë ndërtimi: a) një tullë e plotë me përmasa 29,5 x 29,5 x 5 cm (Tab. II, 3) dhe një copë tulle tjetër me përmasa 29 x ? x 4,8 cm, (Tab. II, 5). Tek kjo e fundit, në njërën faqe, është vizatuar me gërvishtje skema e lojës së nëntëshes (yçit), ndërsa në faqen e prapme skema e një loje tjetër e ndarë brenda me 17 katrorë e trekëndësha dhe tri rombe. Vizatimet e të dy lojërave janë bërë në mënyrë të shkujdesur, me sa duket për nevoja të çastit. Yçe të vizatuara në tulla janë zbuluar si në qytetin e Durrësit ashtu edhe në horën e tij.[27]

Duke u mbështetur në gjetjen e një cope monedhe bakri të tipit kupac (me legjendë të palexueshme), që, sikurse dihet, i përket periudhës së sundimit të Komnenëve,[28] ka shumë mundësi që këtu kemi të bëjmë me një godinë të shek. XI-XIII.

[27] Ekzemplarë të këtillë, që ruhen në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit, vijnë nga gjetje rasti dhe janë të pabotuar.

[28] J. Sabatier, vep. cit., vëll. II, f. 1892188

Masivi i Kryevidhit. Te shpati i kodrës së Terriqes u gjetën disa fragmente qeramike prej brumi me ngjyrë okër, me përzierje grimcash guri të shtypura (Tab. V, 4-5). Për nga forma e buzës dhe e vegjës duket qartë se ato u përkasin amforave korintase (tipi A) të kohës fundi shek. VII - fillimi i shek. VI p.e.sonë.[29] Këto të dhëna, megjithëse të kufizuara, dëshmojnë për praninë e një qendre protoqytetare.

5. Patk Milot

Kodra Malasenj. Në njërin prej shpatave të kësaj kodre u zbuluan rrënoja muresh të ndërtuara me gurë e llaç gëlqereje (me gjerësi 0,80 0,95 m). Po aty u gjetën fragmente enësh balte: a) barqe enësh (Tab. VIII, 14, 15); b) vegjë katruveje (Tab. VII, 25); c) fragment tasi prej brumi të verdhë në okër, glazuruar nga brenda në sfond të bardhë gjysmëmat, i zbukuruar me vija katrorësh të kaltër me pikëza të kuqe (Tab. X, 4). Zbukurime të këtilla hasen në tasat protomajolikë të fillimit të shek. XIII që, zakonisht, në kishat greke, italiane etj. janë vendosur e përdorur si baçine.[30]

6. Sterbeg

Kodra e Biqerrit. Përreth majës së kodrës, gjatë një ekspedite, u gjetën objekte të ndryshme arkeologjike: a) copa tjegullash solene dhe kaliptere (Tab. III, 15, IV, 2, 11); b) pjesë gryke pitosi (Tab. VI, 12) c) fragmente amforash balte të zbukuruara

[29] F. Tartari, Amforat e muzeut arkeologjik të Durrësit, «Iliria, 1982, 2, t. 242, Tab. I, 1, 3; V. Bereti, Vendbanimi ilir në Triport të Vlorës Iliria, 1985, 2, f. 314, Tab. I, 1; A. Nanaj, Butroti protourban, Iliria", 1985, 2, Tab. I, 10.

[30] C. Nicolacopoulos, Cerámiques encastrées des anciennes églises de Grèce, Faenza, 1981, 1-6, f. 172, Tab. LIX, b; S. P. Uggeri, vep.cit., Tab. XXXIII.

me teknikën e hullive (Tab. VII, 13, 15); c) fragmente vorbash (Tab. VII, 1, 4).

7. Zhabjak

Kodra e Tunelit. Në JL të kësaj kodre, në thellësi rreth 0,70 m, u zbulua një varr. Skeleti i futur në gropë ruhej në gjendje të mirë. Mënyra e varrimit me trupvënie. Drejtimi V-J (kafka në anën veriore). Inventari: Një pelike dhe një skifos balte të lyer me vernik të zi (Tab. V, 9, 11). Skifosi është i zbukuruar me vija grafiti të zi që paraqesin motive gërsheti dhe floreale. Së bashku me enët u gjetën edhe mbeturinat e një strigile hekuri. Inventari i varrit, e sidomos pelikja, përfaqëson një ndër tipet e njohura të poçerisë dyrrahase të shek. IV-III p.e.sonë.[31] I kësaj kohe duhet të jetë edhe varri dhe ka të ngjarë t'i përkasë një sportisti të atë-hershëm të Zhabjakut.

8. Bashtovë

Te stallat e gjedhit, gjatë hapjes së një kanali është gjetur një lekit balte i zbukuruar me ornamente në trajtë rrjete (Tab. V, 10). Enë me zbukurime të këtilla në tumën I të Apolonisë datohen në shek. IV-III p.e.sonë.[32] Kësaj kohe duhet t'i takojë edhe ky varr.

9. Beden

Kodra e Kishës. Në majën dhe shpatet e kësaj kodre u gjetën disa objekte arkeologjike.

Qeramikë ndërtimi: copa tullash me përmasa 28 x ? x 3 cm (Tab. III, 1, 8, 12 IV, 21).

[31] H. Hidri, Gërmime në nekropolin e Dyrrahut, Kodrat e Dautes, (viti 1977) Iliria, 1983, 1, f. 151, Tab. XV.

[32] A. Mano, Nekropoli i Apolonisë, Tuma I (Gërmime të vitit 1958-1959); Iliria I, 1971, f. 176, Tab. XXII, 10-11.

Enë balte: a) pjesë vegje e një amfore shtambë (Tab. VII, 30); b) buzë vorbe (Tab. VII, 26); c) fragmenti i një pjate prej brumi të kuq në portokalli, me pak shkëlqim, i zbukuruar me rrathë bashkëqendrorë të gërvishtur dhe të pikëzuar (Tab. VII, 10). Këto zbukurime ngjasojnë shumë me stampat e stileve B-C të enëve afrikano veriore të fundit të shek. IV dhe fillimit dhe shek. V[33]

10. Lekaj

Kodra e Dodëve (quhet edhe Kodra e Dëllinjës). Në vendin e thirrur Lati, si rrjedhojë e erozionit shumëvjeçar, janë dëmtuar konstruksionet e disa varreve. Njëri varr, thuajse i dëmtuar, ishte zbuluar me tjegulla solene (0,75 x 0,44 x 0,05 m) të zbukuruara me hulli në trajtë sinusi (Tab. IV, 9). Tjegulla me zbukurime të këtilla janë ndeshur në disa nekropole të shek. IV-VI në vendin tonë.[34] Skeleti i shpërbërë. Drejtimi P-L. Dyshemeja e shtruar me solene të të njëjtit tip. Inventari: Dy enë balte një-vegjake të thyera. Ena e parë (Tab. VI, 2) e ka trupin të zbukuruar me hulli të lehta dhe të pikturuar me shirita të kuq. Ena e dytë (Tab. VI, 1) është variant i së parës, por e pazbukuruar. Tipat e këtyre enëve e sidomos zbukurimet me shirita të çrregullt ngjajnë me ekzemplarë të njohur dhe teknika zbukurimi të aplikuara në antikitetin e vonë.[35]

[33] J.W. Hayes, Late roman pottery, London, 1972, f. 232, fig. 39, 28 (5); f. 416, fig. 1, C, A.

[34] H. Myrto, Mbi disa... f. 251, Tab. IV, 2; D. Komata, Kështjella e Zharrës - fortesë e periudhës antike të vonë, Iliria VI, 19766, f. 326, Tab. V, 2.

[35] N. Ceka, Ad Quintum, «Iliria VI, 1976, f. 312, Tab. XI, 5. Këtë lloj qeramike autori e vendos në shek. IV të e.s, dhe e cilëson atë si prodhim të Dyrrahut (f. 298); D. Komata, Mbi disa.... 256-257, Tab. I, 10.

Duke patur parasysh se edhe në pika të tjera të këtij shpati duken kulme tjegullash, sikundër ato të mbulesave të varrit të sapopërshkruar, mendojmë se këtu duhet të kemi një varrezë të shek. IV-V e.sonë.



Fig. 4

Kodra e Gjeçëve. Në disa pika të kësaj kodre, në thellësi 0,70 m, janë vërejtur gjurmët e një ujësjellësi prej tubash qeramike të lidhur me llaç gëlqereje (Tab. II, 11). Tuba uji me përmasa thuajse të barabarta janë zbuluar para disa vitesh brenda qytetit të Kavajës dhe ashtu sikundër është thënë për atë ujësjellës[36] edhe ky i Lekajt duhet të ketë funksionuar gjatë shek. XVII-XVIII.

Kodra e Kishës. Përreth kësaj kodre, si rrjedhojë e fenomenit të rrëshqitjes së dherave, janë zbuluar disa objekte arkeologjike.

Trakte muresh. Janë ndërtuar me gurë të papunuar të lidhur me llaç. Këtë teknikë e vrejtëm në dy mure gjatësore që shkojnë

[36] Z. Shehu, vep.cit., f. 120 121, Tab. II, 4.

paralelisht njëri tjetrin. Ato kanë gjatësi përkatëse 4,50 m dhe 3,10 m, me gjerësi të njëjtë 1,05 m.

Enë balte: a) vegjë e glazuruar me zmalt jeshil (Tab. X, 10); b) fragment pjate i glazuruar me zmalt të verdhë (Tab. IX, 38); c) fragment tasi i glazuruar me zmalt krem dhe i zbukuruar me vija të zeza (Tab. X, 1). I takon qeramikës protomajolike të fillimit të shek. XIII.[37]

Kodra e Ujqërve. Gjatë punimeve tarracuese, në shpatet e kësaj kodre janë gjetur, së toku dy, sëpata bronzi me tipare dhe përmasa pothuajse të njëjta (Fig. 4; Tab. XII, 9-10). Ato ngjasojnë me sëpatën e Boksit (Shkodër), të datuar në shek. XII p.e. sonë dhe që përfaqëson një variant midis sëpatave shkodrane dhe atyre shqiptaro-dalmate."[38]

11. Luz i Madh

Tek vendi i quajtur «Mani i fermës është hapur rastësisht një varr. Mënyra e varrit është me trupvënie. Skeleti ruhej pjesërisht me drejtim VP-JL (kafka në VP). Në skajin e gjymtyrëve të poshtme u gjet pjesa e një ene balte e zbukuruar me bojë të murrme mat (Tab. VI, 3). Linjat e penelit, në trajtë të çrregullt, ngjajnë plotësisht me zbukurimet e enëve të shekujve IV - VI37 dhe,[39] ashtu sikundër është thënë, qendra e prodhimit të tyre duhet të jetë qyteti antik i Durrësit.[40]

---

[37] *S. P. Uggeri, Protomaiolica..., T. LXXIX, b.*

[38] F. Prendi, Epoka e bronzit në Shqipëri, «Iliria» VII-VIII, 1977-1978, f. 30 31, Tab. X, 2.

[39] D. Komata*, Kështjella e Kaninës (Disertacion);* H. Spahiu*, Rezultatet e gërmimeve të vitit 1974 në Kalanë e Beratit,* «Buletin Arkeologjik, 5, 1975, f. 81, Tab. II, 3; N. Ceka*, Ad Quintum..., f. 312, Tab. XI, 4-5;* Gj. Karaiskaj*, Gradishta e Symizës në periudhën e vonë antike dhe mesjetë*..., f. 196, Tab. III, 17.

[40] N. Ceka, *Ad Quintum...,* f. 298.

12. Mlik.

Kalaja e Mlikut. Është identifikuar si një vendbanim i fortifikuar i periudhës qytetare ilire, me vazhdimësi jete edhe gjatë mesjetës[41] (Fig. 5). Në ekspeditat e kohëve të fundit kemi zbuluar këtu disa objekte të reja arkeologjike.



Fig. 5



Fig. 6

[41] H. Myrto, Hartë..., Monumentet» 1, 1982, f. 16.

Mur tarracimi. I ndërtuar me gurë gjysmë të punuar me vendosje lidhjeje të thatë (Fig. 6). Disa prej gurëve i afrohen trajtës së paralelepipedit (0,42 x 0,36 x x 0,25 m; 0,51 x 0,40 x 0,21 m etj.). Në anën e brendshme të murit mblodhëm fragmente qeramike (Tab. V 1, 2, 6), prej balte të verdhë me nuancë të blertë: Midis fragmenteve ka edhe funde enësh me vernik të zi të zbukuruara me motivin e trekëndëshit të zgjatur (Tab. V, 3). Kjo qeramikë në vendbanimet protoqytetare u përket prodhimeve jonike të shek. VI-V p.e.sonë.[42]

Brenda kalasë, pranë vendit të quajtur Muret e Kishës, u gjetën disa objekte të tjera.

Qeramikë ndërtimi. Copa kalipteresh dhe solenesh me dhe pa zbukurime (Tab. IV, 4).

Enë balte: a) pjesë e një amfore me qafë cilindrike dhe bark sferik (Tab. VI, 6). Kjo enë ndeshet si tip në disa qendra të vendit tonë dhe datohet midis shek. V VI.[43] Në vendet fqinje gjen paralele me disa amfora qilari të fillimit të shek. VI të zbuluara në Agoranë e Athinës[44]; b) bark ene i zbukuruar me linja valëzuese dhe pikëzime, të gjitha këto me ngjyrë kafe (Tab. VII, 17). Edhe ky fragment është variant i qeramikës së të njëjtit lloj si ajo e zbuluar në varret antike të vona të Lekajt dhe të Luzit të Madh

[42] N. Ceka, Kultura protourbane ilire, «Iliria», 1985, 1, f. 120.

[43] D. Komata, Kështjella e..; S. Muçaj, Vendbanime të antikitetit të vonë në krahinën e Mallakastrës, «Iliria» IX-X, 1979-1980, f. 294, Tab. III, 11. Një grykë amfore e ngjashme, e gjetur në bazilikën e Margëlliçit, është datuar në shek. XI e. sonë (po aty, f. 288).

[44] H. S. Robinson, vep. cit., Pl. 32; M. 323, 324, 328.

si edhe në vend-gjetje të tjera;[45] c) bark shtambe prej balte kafe rozë zbukuruar me tufa vijash lineare e të valëzuara të gërvishtura (Tab. VIII, 1). Kjo kategori qeramike është e njëjtë jo vetëm nga përbërja, por edhe nga motivet e zbukurimit, me enët e shek. VIII të zbuluara në Foro të Italisë.[46] Ndërsa në viset lindore të perandorisë bizantine enë me zbukurime të këtilla janë përdorur edhe gjatë shek. XI-XII;[47] c) copa vorbash thuajse të njëjta nga forma me ato të kishës së Qeretit (Tab. VII, 2-3, 5, 8).

13. Kanaparaj



Fig. 7

Kodra e Qenzës. Para disa vitesh në këtë kodër janë ndeshur materiale arkeologjike të periudhës helenistike.[48] Kohët e fundit, nga kontrollet tona kemi gjetur disa tulla të plota (0,44 x 0,30 x 0,05 m), tulla të rrumbullakëta (me diametër 18 cm dhe trashësi 5 cm) dhe një terrakotë me kokën e një femre (Fig. 7: Tab. V. 7) e ngjashme me ekzemplarë të këtij lloji që në Durrës datohen midis shek. III-II p.e.sonë[49].

[45] N. Ceka, Ad Quintum…, Tab. XI, 4; H. Spahiu, Rezultatet..., f. 86, Tab. II, 3; Gj. Karaiskaj, Gradishta..., f. 196, Tab. III, 17.

[46] O. Mazzucato, *La ceramica laziale nell'altomedioevo*, Roma, 1977, f. 29, fig. 47.

[47] M. Chisvaşi-Coms, Nekotorye istoriçeskie vyvody v svajzi s neskolkimi arheologiçeskimi pamjatnikami VI-XII vv n.e.e. na territorii RNR, Dacia», I, 1957, Tab. IV, 22, 24.

[48] H. Myrto, Hartë…, «Monumentet», 1982, 1, f. 13.

[49] H. Hidri, Gërmime në..., f. 153; po ajo, Gjurmë të një punishte qeramike në Dyrrah, Iliria VI, 1976, f. 258, Tab. I, 2, 7-8.

Kodra e Kishës. Si rrjedhojë e gërryerjeve, tek rrënojat e një kishe që ndodhet në këtë kodër, herëpashere. dalin objekte arkeologjike të ndryshme.

Trakt muri. I ndërtuar me gurë shtuforë të papunuar e llaç gëlqereje, me përmasa 2.30 dhe 0,80 m.

Qeramikë ndërtimi: a) copa tullash e tjegullash (Tab. IV, 1, 15, 18). Enë balte: a) pjesë gryke pitosi e zbukuruar në pjesën e sipërme me hulli të valëzuara dhe të pjerrëta (Tab. VI, 10). Një pitos i tillë në kështjellën e Pogradecit është datuar në shek. IV-VI;[50] b) fragmente amforash, disa prej të cilëve të zbukuruar me hulli të ngushta e të gjëra (Tab. VII, 31, 33, 34; Tab. VIII, 2-3); c) fragmente shtambash të zbukuruar me tufa hullish lineare dhe valëzuese (Tab. VIII, 5-6, 8), motive këto të njëjta me ato të fragmentit të gietur në kalanë e Mlikut (Tab. VIII, 1); c) vegjë në trajtë bishti kungulli, e glazuruar me zmalt jeshil (Tab. VII, 32); d) dy vegjë kotruvesh (Tab. VII, 35, X, 9); e) fragmente poçesh (Tab. VII, 21, 24: IX, 22, 45: X. 2): e) fragmente tasash (Tab. IX, 25-30) të glazuruar me zmalt jeshil. bizele, krem. Në to dallohen pesë mënyra glazure: me zhytje, me derdhje, me penel, me furçe dhe me spërkatje. Për zbukurimin e tyre janë përdorur motive të ndryshme: linearo-valëzuese, me njolla të çrregullta, floreale etj. (Tab. X. 2. 5-6, 11); f) fragment qypthi (Tab. IX, 40): g) dy copa vorbash (Tab. VIII, 23: IX, 35). Gjetje të ndryshme: a) pjesë e një kandili prej balte (Tab. VIII, 27): b) majë shigjete hekuri me fletë të hollë (Tab. XI. 15); c) vath bronzi i gjetur vite më parë[51] (Tab. XII, 1).

[50] S. Anamali. Kështjella e Pogradecit, Iliria IX-X, 1979-1980, f. 243, Tab. IV, 5.
[51] H. Myrto, Hartë.... Monumentet 1. 1982 f. 12-13, fig. 1

Prania e qeramikës me hulliza të krehëruara na lejon të përcaktojmë si kohë të fillimit të jetës në këtë majë kodre shek. V-VI të e.sonë. Për vazhdimin e jetës në këtë vend interes të veçantë paraqesin fragmentet e shtambave të zbukuruar me hulliza lineare dhe valëzuese, objekte këto që u përkasin shek. VIII-XI. Të njëkohshëm me këto janë gjithashtu edhe tasat e glazuruar me zmalt ngjyrë jeshile ulliri, si dhe ato me glazurë të tejdukshme, që, sikundër u shprehëm për qeramikën e Kodrës së Vlashajt, u përkasin prodhimeve të shek. XXI. Në këto rrethana del se këtu kemi të bëjmë me një fazë të dytë, që lidhet si periudhë me mesjetën e hershme shqiptarc.

Pjesa tjetër e lëndës arkeologjike e përbërë nga fragmente tasash, pjatash, poçesh etj. të shek. XII-XIV,[52] dëshmon se jeta në kodrën e kishës ka vazhduar edhe gjatë mesjetës së mesme.

14. Çetë

Kisha e Shën Premtes. Në territorin pranë kishës është zbuluar rastësisht një varr-gropë. Nga skeleti ruhej në gjendje të plotë kafka, ndërsa pjesët e tjera ruheshin pjesërisht. Mënyra e varrimit me trupvënie. Drejtimi P-L (kafka në perëndim). Inventari: tre tasa balte trungkonikë (Tab. IX, 21, 23, 37) glazuruar nga brenda, mbi buzë dhe një gisht nën buzë me zmalt jeshil dhe krem. Tasa të njëjtë me këta janë zbuluar në një varr të mesit të shek. XII në varezën mesjetare të qytetit të Durrësit[53].

Pjesë ujësjellësi: Një fragment tubi balte (Tab. II, 12) që ka shumë mundësi t'i përkasë ujësjellësit të kishës.

[52] F. Tartari, Petra..., f. 142; D. Komata..., Kështjella...

[53] A. Hoti, Gërmime arkeologjike të vitit 1984, Lagja 11 Durrës «Iliria", 1984, 2, f. 274-275

Enë balte: a) fragmente shtambash të zbukuruar me tufa hullizash lineare dhe valëzuese (Tab. VIII, 16, 24), motive të njëjta me ato të tipave të enëve të gjetura në Mlik e në Kanaparaj, që i datuam në shek. VIII XI; b) profili i një poçeje zbukuruar me dy tufa hullizash paralele që përfshijnë në mes tyre hulliza të tjera të gërvishtura në trajtë thonjëzash (Tab. VIII, 19). Ky tip ene, nga mënyra e zbukurimit, përngjan me një fragment ene tjetër të shek. XI XIV, të gjetur në kalanë e Bllacës.[54]

Materialet dhe objektet e sipërpërmendura na japin të dhëna të një kuadri kohor nga shek. VIII e deri në shek. XIV. Në këto rrethana gjen përputhje dhe përforcohet më tej mendimi i mbështetur në të dhënat që ofron arkitektura e kishës dhe datimi që i është bërë asaj në fund të shek. XIII.[55] Materiali i imët arkeologjik i mbledhur rishtazi është ende i varfër, por të dhënat kronologjike që u nxorrën prej tij nuk e përjashtojnë mundësinë që në këtë godinë kulti të ketë një fazë ndërtimi para shek. XIII, aq më tepër, kur dihet se shumë prej kishave të hershme mesjetare u rindërtuan dhe u ripërdorën edhe gjatë mesjetës së mesme.

15. Rogozhinë

Kodra e Kishës. Në sipërfaqen e kësaj kodre gjetëm disa kocka varresh dhe disa objekte arkeologjike: a) copa tjegullash solene (Tab. III, 14; IV, 17, 19) me dhe pa zbukurime; b) pjesë gryke dhe vegjë shtambe (Tab. VII, 28), si dhe disa fragmente tasash të glazuruar nga brenda me zmalt jeshil të njëjtë për nga lloji me tasat e shek. XII-XIII, që përmendëm për fshatrat Kanaparaj dhe Çetë. Megjithëse të dhënat janë të kufizuara, men-

[54] N. Ceka, A. Baçe, Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit: luginën e Devollit dhe të Shkumbinit, Monumentet 3, 1972, f. 205, Tab. II, 6

[55] A. Meksi, Kishat e..., Monumentet 1, 1984, f. 107.

dojmë se maja e kodrës është përdorur si varrezë në mesjetën e mesme.

16. Met Hasanaj.

Kodra e Kishës. Nga punimet bujqësore kanë dalë disa materiale arkeologjike: a) copa tjegullash solene me dhe pa zbukurime (Tab. IV, 13, 17); b) fragment amfore i zbukuruar me një hullizë valëzuese (Tab. VI, 4). Amfora të zbukuruara me motive të këtilla janë gjetur në një ndërtesë të shek. IV VI në fshatin Rubjekë të këtij rrethi.[56]

17. Tilaj

Ara e Rrasave. Në fundin e shpatit jugor të kodrës janë ndeshur disa objekte arkeologjike: a) trakt muri i ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje, me përmasa: 1,80 m i gjatë, 0,60 m i gjerë dhe 0,40 m i lartë; b) tuba ujësjellësi prej balte (Tab. II, 10); c) copa tullash (15 x ? x 3,5 cm) dhe tjegullash (Tab. IV, 5); c) fragmente amforash të zbukuruar me hulliza (Tab. VI, 8, VIII, 11, 12; d) fragment shtambe i zbukuruar me hulliza lineare dhe valëzuese (Tab. VIII, 16) ashtu si ato të Mlikut, Kanaparajt (shek. VIII-XI); e) fragment i një tasi prej brumi të pastër me pjekje në ngjyrë të kuqe portokalli, i zbukuruar me hulliza (Tab. VII, 9). U përket enëve të importit afrikano-verior të shek. IV-V[57] e) shpatull vorbe e zbukuruar me gropëzime (Tab. VIII, 22). Vorba me këto zbukurime gjatë gërmimeve në qytetin e Durrësit janë gjetur në shtresën e mesjetës së hershme.[58] Të kësaj periudhe

[56] H. Myrto, Hartë.., Monumentet, 2, 1981 (22), f. 67, Tab. III, 8.

[57] J. W. Hayes, vep. cit., f. 306, fig. 60, 1.

[58] A. Hoti, Raport mbi gërmimet e viteve 1985-1986 në kalanë e Durrësit Arkivi (QKA).

janë përcaktuar këta tipa enësh edhe nga zbulimet në qytete e qendra të tjera të vendit tonë.[59] Gjetjet e sipërpërmendura u përkasin kryesisht shek. IV-VI. Ndërsa fragmentet e përshkruara në nënndarjet d, e, na japin një të dhënë me interes për vazhdimësinë e përdorimit të këtyre ngrehinave edhe gjatë mesjetës së hershme.

18. Manez Fshat

Lagjja e Farukëve. Në rrënojat e një kishe paleokristiane kohët e fundit kemi gjetur disa objekte arkeologjike.

Fragmente elementësh arkitektonikë: a) pjesë e një kolone mermeri të bardhë me rremba gri. Gjatësia 1,47 m, d=0.25 m, d=0.30; b) bazament kolone prej guri gëlqeror (Tab. II, 6); c) copa pllakash mermeri të bardhë me rremba gri, 1,6 cm - 4,5 cm të trasha.

Qeramikë ndërtimi. Tulla të plota drejtkëndëshe (29 x 28 x 4 m) të zbukuruara me dy kanale diagonale. (Tab. II. 1). Tulla të kësaj mase dhe me zbukurime të këtilla janë përdorur në Dyrrah qysh në shek. II të e.sonë.[60] Por në rrethin e Durrësit janë vërejtur raste të ripërdorimit të tyre në periudha të mëvonshme, madje edhe gjatë mesjetës.[61]

[59] D. Komata, Disa tipare të qeramikës mesjetare në Shqipëri, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve (sesion shkencor 3-4 mars 1969) Tiranë 1969 f. 237, Tab. VII, 9; Gj. Karaiskaj, Gradishta e.., f. 202, Tab. IX, 3.

[60] F. Miraj, H. Myrto, Ujësjellësi i Dyrrahut, Iliria 1, 1982, Tab. IV, 6-7; F. Tartari, Gjurmë ndërtimesh me kënetën e Durrësit, Monumentet 9, 1975, Tab. I, 5.

[61] M. Goga vep. cit..., f. 110.

19. Radë

Kodra e Kunrove. Në pjesën ku shpatet e kësaj kodre lidhen me territorin e fshatit Borç, kanë gjetur rastësisht: a) një majë heshte hekuri 44 cm të gjatë (Tab. XII, 4) dhe një aplike bronzi me figurën e një kau, në brirët e të cilit varet simetrikisht një kordele (Tab. V, 7; XII, 2).

Bashkë me këto objekte, në këtë vend u zbuluan edhe fragmente qeramike me vernik të zi të dobët. Duke u nisur nga ky fakt mendojmë se edhe dy objektet metalike duhet t'u përkasin shex. III II p.e.sonë.

Bregu i Mullirit. Në këtë vend, nga punimet tarracuese janë konstatuar disa varre të tipit gropë. Po aty janë gjetur edhe disa fragmente enësh balte: a) fragment pjate me glazurë e llojit të qeramikës protomajonike të fillimit të shek. XIII (Tab. X, 13); b) fragmente vorbash (Tab. VIII, 18; IX, 3, 4).

20. Armath

Kodër Palush. Gjatë hapjes së një kanali është zbuluar rastësisht një varr i mbuluar me tjegulla solene të përmasave 0,50 x 0,41 m. Në varr u gjet vetëm një rruazë qelqi e tipit milefiori (Tab. XI, 3). Rruaza të këtij tipi në gjetjet e varrezave të kulturës arbërore datohen në shekujt e parë të mesjetës së hershme[62]. Pranë varrit dalloheshin gjurmët e një muri godine me tulla e llaç gëlqereje. Po aty u gjetën: a) copa tullash ku veçohen tri copë, në faqet e të cilave janë stampuar në reliev shenja të ndryshme: kryq, yll me 5 cepa, yll e shtojca shenjash të tjera (Tab. III, 2-3,

[62] S. Anamali, H. Spahiu, Varreza arbërore e Krujës, Iliria» IX-X, Tiranë 1979-1980, f. 77, H. Spahiu, Varreza arbërore e kalasë së Dalmacies, «Iliria» IX-X, Tiranë 1979-1980, f. 38.

5). Tullat me shenja kryqi në reliev, sikundër thamë në rastin e gjetjeve të kishës së Qerretit, i takojnë shek. VI e.sonë; b) copa tjegullash solene (Tab. IV, 10, 12); c) fragmente vorbash (Tab. IX, 42, 44); c) dy gozhdë hekuri për lidhje trarësh (Tab. XI, 13, 14); Të dhënat e mësipërme tregojnë se në gjurmët e ndërtimit të kësaj kodërze duhet të kemi një ngrehinë të shek. V-VI. Po këtu ka të ngjarë që të jetë edhe një varrezë.

21. Hamallaj-Fshat

Ara e Ali Brahimi. Në këtë arë u mblodhën disa fragmente enësh balte: a) dy fragmente kotruvesh (Tab. VII, 27, 29, 30); b) dy vegjë të zbukuruara me shenja anepigrafike (Tab. VIII, 26, 28); c) bark shtambe i zbukuruar me tufa hullizash lineare dhe thonjëza pothuaj të njëlloj si enët e shek. XI-XIV të zbuluara në kishën e Çetës (Tab. VIII, 17); c) tri fragmente tasash të glazuara me zmalt krem (Tab. IX, 31, 36;6 41); që paraqesin ngjashmëri me enët e shek. XII XIII të gjetura në Kanaparaj, Çetë etj.

22. Kullë

Kodra e Kishës. Poshtë kodrës është gjetur një figurinë e vogël bronzi (Fig. 8). Figurina, 9.2 cm e lartë, paraqet një femër të mbështetur në këmbë, me duar të kryqëzuara në gjoks. Me tiparet e saj të veçanta ajo duhet t'i përkasë prodhimit lokal të ndonjë punishteje antike.



Fig. 8

Në parcelën e punueshme pranë kësaj kodre, para disa vitesh, nga hapja e një varri janë gjetur një sëpatë dhe një hanxhar hekuri (Tab. XI, 12, 16). Duke u mbështetur te tipologjia e sëpatës me tipare krejt të ngjashme me ato të qendrave të tjera të rrethit të Durrësit,[63] ka shumë mundësi që objektet t'u përkasin shek. III-IV e. sonë.

23. Kepi i Rodonit

Kisha e Manastirit të Shën Ndout. Në afërsi të kishës janë gjetur varre me mbulesë tjegullash solene (Tab. IV, 13). Po aty janë gjetur: a) fragmente të një poçeje balte me glazurë okër, zbukuruar në shpatull me hulliza paralele dhe gropëzime (Tab. VIII, 25); b) funde gotash qelqi me këmbë të dhëmbëzuar dhe unazore (Tab. XI, 2, 4, 7). Fragmenti i paraqitur në tabelën XI, 1 i përket profilit të një gote të zbukuruar në faqen e jashtme me relieve në trajtë themthash. Për datimin e gotave jemi të prirur të mbështesim mendimin që i përcakton ato si prodhime korintase të shek. XI-XII,[64] pa përjashtuar mundësinë e përdorimit të tyre edhe në shekujt e mëvonshëm, bile deri në fund të shek. XV,[65] Sidoqoftë, ky kuadër i gjerë kronologjik jo vetëm që përputhet me të dhënat burimore, por edhe shtron mundësinë e një ndërtimi bizantin më të hershëm, e provuar kjo edhe në teknikën e ndërtimit të mureve të kishës,[66]

[63] A. Hoti, Kërkime..., f. 328, Tab. II, 7-9.

[64] J. Philippe, Le monde..., f. 144, Fig. 62, A. Casparetto, La verrerie venitienne et ses relations avec le Lerant balkanique au Moyen âge Verre médieval aux Balkans (Ve-XVS), Belgrade, 1975, f. 148, Tab. V, 16, a, b.

[65] A. G. Gasparetto, vep. cit.... f. 148.

[66] A. Meksi, Kiskat..., f. 105.

Sopatë hekuri. Në territorin e Kepit është gjetur rastësisht një sopatë hekuri thuajse e plotë. Sopata është e tipit me çekiç të lartë (Tab. XI, 11; XII, 6). Ky objekt datohet në shek. III-IV të e.sonë[67].

PËRFUNDIME

Në këtë ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit janë përfshirë mbi 30 monumente dhe vendgjetje arkeologjike të periudhave të ndryshme. Pjesën më të madhe të lëndës (rreth 75%) e përbëjnë objektet arkeologjike të periudhës së antikitetit të vonë dhe mesjetës, ndërsa ato të kohëve më të hershme zënë një numër më të kufizuar.

Nga fusha e prehistorisë, sikundër dihet, kohë më parë, në rrethin e Durrësit janë zbuluar katër sëpata shqiptaro-dalmate.[68] Zbulimi tani së fundi i dy varianteve ndërmjetëse midis atyre shkodrane dhe shqiptaro-dalmateve hap një shteg për të ndjekur zhvillimin tipologjik të të parave në të dytat, si një proçes që bëhet brenda kufijve të këtij rrethi.

Për t'u vlerësuar janë gjithashtu disa vendgjetje me objekte të periudhës protourbane. Një vendbanim i kësaj kohe është kalaja e Mlikut, në të cilën është ndeshur një shtresë kulturore me objekte të importit korintas dhe jonik. Qendra të periudhës protoqytetare janë ndeshur gjithashtu edhe në zonat e Kryevidhit dhe Kryemdhejit. Intensifikimi i kërkimeve në to është me interes gjurmimi për të ardhmen.

[67] A. Hoti, Kërkime..., f. 328, Tab. II, 7-9.

[68] H. Myrto. Hartë.... Monumentet 2, 1981 (22), f. 66, fig. 3, A. Hoti, Qendra të reja prehistorike dhe protourbane në rrethin e Durrësit MSAD 1983, f. 67, Tab. II, 9.

Periudha qytetare ilire përfaqësohet në këtë rreth me disa qendra të banuara, ndonjëra prej të cilave e fortifikuar, që dëshmon për një zhvillim të jetës fshatare në prapatokën e Dyrrahut antik. Në këto vendbanime të hapura të karakterit fshatar si në Kanaparaj, Radë etj. u zbuluan disa objekte (materiale ndërtimi, fragmente enësh, armë, terrakota etj.), që i përkasin prodhimtarisë së Dyrrahut antik.

Monumentet dhe vendgjetjet arkeologjike antike të vona dhe mesjetare që u trajtuan në këtë artikull përbëjnë një ndihmesë që e pasuron më tej hartën arkeologjike. Nëqoftëse monumenteve dhe vendgjetjeve të përfshira në këtë artikull u shtojmë edhe monumentet e tjera të zbuluara dhe të studiuara nga autorë të tjerë, në hartën arkeologjike aktualisht përfshihen: katër kala mesjetare (Bashtovë, Rodon, Mlik, Ishëm), një sërë rrënojash ndërtimesh antike të vona e mesjetare apo detaje arkitektonike të këtyre kohëve (Gjuricaj, Rubjekë, Kep i Lagjit, Krye Luz, Kavajë, Shkodër, Bardhar etj.), disa kisha e bazilika paleokristiane e mesjetare (Arapaj, Gjuricaj, Manzë, Kanaparaj, Fushë-Qerret), një numër vendesh varrimi antike të vona dhe mesjetare (Mal i Robit, Kanaparaj, Kazie, Arapaj, Seferaj etj.), disa ujësjellës mesjetarë (Kavajë, Rrogozhinë), si dhe një varg gjetjesh të rastit në pika të ndryshme të rrethit.

Rrënojat dhe traktet e mureve të ndeshura në grehina pranë fshatrave Sterbeg, Beden, Kanaparaj, Tilaj etj. si dhe lënda arkeologjike e zbuluar në to tregojnë për ekzistencën e një sërë vendbanimesh të hapura të kohës së antikitetit të vonë, që së bashku me qendrat e fortifikuara (Kalaja e Turrës, Kalaja e Mlikut) dëshmojnë se në prapatokën e afërt dhe të largët të Dyrrahut, gjatë periudhës së antikitetit të vonë, bëhen një sërë

ndërtimesh. Krahas ekzemplarëve të plastikës arkitektonike, ku mund të përmendim kapitelet e bukura të Gjuricajt, Lis-Patrosit, gjetur vite më parë[69] apo traktet e kolonave dhe bazamentet si dhe pllakat dekorative zbuluar në fshatrat Fushë-Qerret, Manzë, Beden e gjetkë, të gjithë këto lënë për të menduar se në vend-gjetjet përkatëse ndodhen konstruksione arkitektonike me vlera të veçanta. Eshtë me interes për t'u vënë në dukje se disa prej elementeve arkitektonike të gjetura në rrënojat e kishës së Qerretit, Manzë Fshat, Beden etj. përbëhen nga një lloj mermeri disi të veçantë, me ngjyrë të bardhë e rremba gri. Sipas pikë-pamjes së autorëve tanë, ky lloj mermeri me origjinë nga Prekonezi i Detit të Zi (pranë Kostandinopojës),[70] që importohej me detaje ose blloqe, ishte i destinuar për ndërtimin e veprave të rëndësishme e në rradhë të parë për godinat e kultit paleokristian. Materialet e tjera të ndërtimit (tullat e tjegullat) të zbuluara në disa rrënoja të shek. IV-VI, e veçanërisht monogramet e shenjat e tjera anepigrafike të stampuara në to, tregojnë se këto objekte u përkasin prodhimeve të punishteve durrsake të kësaj kohe.

Zbulimi i tullave dhe i tjegullave të shekujve të parë të erës sonë në një sërë ngrehinash dhe kishash paleokristiane (Qerret, Kryevidh, Manëz etj.) dhe mesjetare (Kryevidh, Romanat) dëshmon për ripërdorimin e materialeve të ndërtimit ose të adaptimit të ndërtesave antike në kohë më të vona.

Gjetja e disa sëpatave prej hekuri të shek. III IV të e.sonë (Kepi i Rodonit, Kullë), krahas atyreve që ka dhënë inventari i

[69] H. Myrto, Harte..., Monumentet 2, 1981 (22), Tab. II, 1-2.

[70] S. Anamali, Problemi i formimit të popullit shqiptar nën dritën e të dhënave arkeologjike Iliria 1982, 2, f. 38; A. Meksi, Aspekte të arkitekturës paleokristiane në Shqipëri, «Iliria 1, 1986, f. 295.

pasur i varrezës së Malit të Robit si dhe zbulimi i një sëpate të fillimit të mesjetës së hershme në Fushë-Qerret ka rëndësi për faktin se nxirren të dhëna të reja për vazhdimësinë e përdorimit të veglave të punës në krahinën bregdetare të Durrësit.

Ndër enët e gjetura në disa ngrehina të shek. IV-VI (Qerret, Stërbeg, Tilaj etj.) të bie në sy numri i madh i fragmenteve të amforave të vona romake (LRA, 1-6).

Nga materiali qeramik i shek. VIII-XI që është gjetur në fshatrat Mlik, Kanaparaj, Çetë, Tilaj etj. të tërheq vëmendjen tipi i shtambës i zbukuruar me hulliza lineare e valëzuese. Enë me zbukurime të këtilla janë zbuluar edhe në qytetin e Durrësit, madje dhe me një numër më të madh ekzemplarësh. Ato përfaqësojnë tipin e shtambave të para mesjetare që zëvendësojnë pak nga pak amforat e antikitetit të vonë. Përafërsia e kësaj qeramike me shtambat e së njëjtës periudhë në Itali tregon në njëfarë mënyre për lidhje tregtare me Gadishullin Apenin, në një kohë kur marrëdhëniet me krahinat e Bizantit Lindor ishin më të kufizuara. Krahas kësaj qeramike, aty nga fundi i shek. X, fillojnë të përdoren për herë të parë në Arbëri tasat bizantinë me glazurë me ngjyrë jeshile ulliri. Fragmente të këtij lloji patëm rastin t'i gjejmë në Kryevidh (Qafa e Thanës), Kanaparaj e gjetkë. Kjo dukuri e rivendosjes së lidhjeve me Bizantin Lindor përputhet si kohë me kushte të caktuara historike të krijimit dhe të formimit të themës së Durrësit. Qeramika e glazuruar bizantine e shek. X-XI ndikoi gradualisht në shndërrimin tipologjik të prodhimit të enëve nga ateljetë e qytetit të Durrësit. Ky ndikim bëhet aq i ndjeshëm saqë në shek. XII-XIII qeramika e glazuruar merr tipare të vërteta lokale. Gjetjet fragmentare të qeramikës së glazuruar në fshatrat Çetë, Kanaparaj, Kryevidh, Lekaj,

Radë, Hamallaj, dëshmojnë qartë se këto enë i përkasin një prodhimi tashmë të ri durrsak, që bazohet nga njëra anë në traditën e hershme vendëse dhe nga ana tjetër në imitimet dhe riprodhimet e modeleve bizantine.

Nga kërkimet dhe gërmimet e bëra në qytetin dhe rrethin e Durrësit janë zbuluar një numër relativisht i madh fragmentesh balte të llojit të protomajolikës (Fundi i shek. XII fillimi i shek. XIII). Këto enë, që deri më sot njiheshin vetëm në Itali, Greqi dhe Azi të Përparme, siç del, kanë patur një rreze përhapjeje edhe në Shqipëri. Për vendprodhimin e kësaj qeramike janë shprehur mendime të ndryshme. Pa pretenduar se po japim ndonjë mendim për mbartësit dhe vendprodhimin e kësaj qeramike, konstatojmë se protomajolika e zbuluar në Durrës, Kaninë e gjetkë në Shqipëri, në pikëpamje të elementeve dekorative, afrohet më tepër me ekzemplarët korintas dhe më pak me ata brindiziotë të grupit I.

Nga inventari i varrezave të shek. XI-XIV në Çetë, Kep të Rodonit, Seferaj, etj. të bie në sy qëndrueshmëria e traditës së futjes së objekteve në varr, dukuri kjo jo aq e zakonshme për qendra të tjera varrimi të kësaj kohe.


KEPI I RODONIT
RRETHI I KRUJES
DETI ADRIATIK
Erzen
Bishti i Pallës
DURRES
SHIJAK
RRETHI I TIRANES
KAVAJE
RROGOZHINE
RRETHI I ELBASANIT
RRETHI I LUSHNJES
1 - Fushë Qerret
2 - Synej
3 - Kalaja e Turrës
4 - Kryevidh
5 - Patok - Milot
6 - Stërbeg
7 - Zhabjak
8 - Bashtovë
9 - Beden
10 - Lekaj
11 - Luz i Madh
12 - Mlik
13 - Kanaparaj
14 - Çetë
15 - Rogozhinë
16 - Met-Hasanaj
17 - Tilaj
18 - Manëz Fshat
19 - Radë
20 - Armath
21 - Hamallaj Fshat
22 - Kullë
23 - Kepi i Rodonit
24 - Ishëm
25 - Gjuricaj
26 - Lis - Patros
27 - Zig - Xhafaj
Qendër protourbane
Tuma
Fortifikim ilir
Trakt i rrugës Egnatia
Qytet i fortifikuar mesjetar
Kështjellë mesjetare
Fortifikim i antikitetit të vonë
Gjurmë rrënojash
Kishë ose rënoja kishe
Trakt ujësjellësi mesjetar
Varrezë antike
Varrezë mesjetare
Gjetje rasti

Tab. I



Tab. II



Tab. III


1
2
3
4
5
6
7
0 5CM
8
0 5CM
9
10
11
12
13
14
15
0 5CM
16
17
18
19
20
21
22
23
24
0 5CM

Tab. IV



Tab. V



Tab. VI


1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
25
23
24
26
28
27
29
30
31
33
35
32
34
0
5CM

Tab. VII


1
2
3
4
5
6
7
8
0 5CM
9
10
11
12
13
0 5CM
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
0 5CM

Tab. VIII



Tab. IX



Tab. X



Tab. XI



Tab. XII

KËRKIME ARKEOLOGJIKE NË ZONËN E KRYEMDHEJIT NË RRETHIN E DURRËSIT[1]

Në përgjigje të nevojave gjithnjë në rritje për pasurimin e hartës arkeologjike të rrethit të Durrësit, bërthama shkencore e muzeut arkeologjik me një bashkërendim të ngushtë të punës me bashkëpunëtorët e jashtëm, vitet e fundit, i ka zgjeruar edhe në tej kërkimet në drejtim të evidentimit të qendrave të reja të kulturës ilire. Shumë të dhëna kanë nxjerrë në dritë një sërë vendgjetjesh arkeologjike, që u përkasin periudhave të ndyshme duke filluar nga prehistoria deri në kufijtë e mesjetës së hershme shqiptare. Ka pasur raste që, nëpërmjet vrojtimeve të herëpashershme, disa zona të veçanta të eksplorohen më në thellësi. Të tilla punime janë bërë në fshatrat Seferaj, Tilaj, Kryemdhej dhe Golem.

Banorët e zonës së Kryemdhejit përfshihen në tokat e kooperativës bujqësore me të njëjtin emër. Territori i tyre, nga pikëpamja gjeografike, bën pjesë në grumbullin e kodrave që ndodhen në perëndim të Erzenit të Poshtëm. Por shpesh, në trajtimin nënzonal, këto njihen edhe me emrin Kodrat e Kavajës, që arrijnë lartësinë më të madhe deri në 450 m. mbi nivelin e detit. Kjo njësi orografike fillon nga fshati Shkallnur (Shkëmbi i Kavajës), i cili e ndan nga Durrësi, në veriperëndim e deri në fshatin Zig-Xhafaj në juglindje. Në drejtim të perëndimit piqet me bregdetin

[1] Marrë nga :Hoti Afrim. Kërkime arkeologjike në zonën e Kryemdhejit në rrethin e Durrësit; Në: Iliria, vol. 7-8, 1977. fq.325-330; (https://www.persee.fr/doc/iliri_1727)_2548-1977-num_7_1_1297)

e Adriatikut dhe në një largësi prej 10-12 km. arrin deri në kufijtë e fshatit Romanat në lindje. Faqet e kodrave, sidomos pjesët e ulëta të tyre, kanë pasur gjithnjë kushte të përshtatshme pedologjike për mbjedhjen e drithërave si dhe kushte të mira për kultivimin e hardhisë e të ullirit.

Studimet e mëparshme përmendin në këtë zonë zbulimin e një altari me mbishkrim latin në fshatin Seferaj,[2] që pas deshifrimit të parë, tani së fundi,[3] pati edhe një riplotësim për tekstin e tij.

Duke e gjurmuar më tej këtë pellg ne arritëm të zbulonim pika të reja arkeologjike.

Në fshatin Tilaj, në vendin e quajtur «Ara e Vrapit», (pranë shtëpisë së kooperativistit H. Muça), për shkak të erozionit dhe të plugimit të përvitshëm të tokës, është nxjerrë një material i pasur qeramik dhe skeletik. Gjëja e parë, që e dallon këtë vendgjetje, është se këtu kemi të bëjmë me një varrezë mbi të cilën dhe në afërsi është ngritur një vendbanim i hapur. Shpërndarja e gjetjeve në të gjithë sipërfaqen e arës nuk ndjek ndonje rregullsi. Si element arkitektonik na ka rënë në dorë një fragment parketi i thjeshtë, copat e të cilit përbëhen prej fragmentesh qeramike në trajtë katërkëndëshe dhe poligonale (Tab. II, 2).

Vendgjetja e dytë arkeologjike u zbulua në Arën e Rrasave (në afërsi të shtëpisë së kooperativistit P. Dedja). Punimet me karakter komunal kanë ndeshur këtu në trakte muresh guri të lidhur me llaç gëlqereje. Edhe në këtë arë, në një sipërfaqe relativisht të madhe, u gjetën copa enësh të llojeve të ndryshme.

[2] H. Ceka S. Anamali, Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë, «BUSHT», 1961, I, f. 117-118.

[3] H. Myrto, Mbi disa qendra arkeologjike midis Kavajes dhe Durrësit, «Monumentet» 7-8, Tiranë 1974, f. 250.


GJIU I DURRESIT
Kryemadhenj
Tilaj
Golem
Seferaj
Golemas
Kanaparaj
Qerret
Aganas
Spanjo
Zig Xhafaj
Prroi i Kavajés
Legjenda
Kala Ilire
Varreze
Mbishkrim
GJurme te Via Egnatias
Vendbanim
Helmas
Çefa
Mameli
KAVAJA

Tab. I

Në bregun e kishës së fshatit Seferaj, nga ku është nxjerrë altari i lartpërmendur gjatë hapjes së themeleve të një banese, kohët e fundit, u zbulua dhe një varr që përmbante objekte.

Vendgjetja e fundit, e konstatuar në parcelën eksperimentale të ekonomisë së shkollës së mesme bujqësore të Golemit (Mali i Robit), përfaqëson një varrezë tjetër, ku kanë dalë rastësisht disa objekte metalike.

Nga analiza tipologjike e materialit të zbuluar, me një vështrim tërësor, rezultojnë të përfaqësuara këto periudha kohore:

a) Periudha e shek. V-IV p.e.sonë.

Materialet e pakëta të dala nga varreza e Tilajve çelën serinë e objekteve më të hershme. Ashtu si është vënë në dukje për të gjitha qendrat e vendit tonë, edhe në këtë zonë, është karakteristike mënyra e varrimit me trupvënie.

Në këtë varrezë, megjithëse është koha e fillimit të jetës qytetare në kështjellën fqinjë të Zig-Xhafajt,[4] ndihet mungesa e plotë e objekteve të kësaj të fundit.

Qeramika e ardhur nga Dyrrahu gjatë shekujve VI-V p.e.s. në qendrat përreth, për këtë kohë është e kufizuar dhe përfaqësohet në Tilaj (Ara e Vrapit) nga skifosa balte të madhësive të ndryshme, të lyer me vernik të zi, me shkëlqim të theksuar. (Tab. I, 16-17).

b) Periudha e shek. III-II p.e.sonë.

Gjatë shekujve të mësipërme vendbanimet fshatare ilire në trevat pranë Adriatikut e veçanërisht ato që ndodheshin në zonën

[4] H. Myrto, rep. cit., f. 249 (raporti harto-arkeologjik ka evidentuar kështjellën e Zig-Xhafajt).

me Dyrrahun, u zgjeruan si pasojë e zhvillimit të degëve të ekonomisë, bujqësisë, blegtorisë dhe të prodhimeve të poçerisë: ndërsa farkêtaria, në kushtet e mungesës së lëndës së parë, duket se pati ritme të ulëta. Një qendër të tillë banimi të karakterit të hapur fshatar e ndeshim në Tilaj (Ara e Vrapit).

Poçeria e kësaj kohe prodhon ekzemplarë të qeramikës së hollë, siç janë pjatat me brumë kafe të çelët dhe okër, të lyer me vernik të zi të dobët dhe vernik të kuq e kafe (Tab. I, 1-5). Këto tipe enësh i kanë buzët rrethore, të kthyera nga jashtë, e që në disa raste, shfaqen me zgjatime të theksuara. Në to, si dhe në të gjitha kategoritë e enëve, duken shenjat e qarta të veprimit të çarkut. Enë të këtilla janë zbuluar jo vetëm në Dyrrah dhe Apoloni, por edhe në Kaninë,[5] Dimal, Selcë të Poshtme,[6] Antigone[7] e gjetkë. Tipologjikisht ato i përkasin shek. III-II p.e.s. Jo më pak të përdorura kanë qenë edhe skifosat fundlartë me vegje vertikale, të lyer me vernik kafe (Tab. 1, 19) si dhe enët me vegje në trajtë gërsheti të Dyrrahut (Tab. I, 20). Një kategori tjetër përbëjnë amforat e transportit, me buzë të kthyera nga jashtë, që, gjithashtu, i përkasin shek. III-II p.e.re. (Tab. I, 6). Nga mënyra e dhënies së formës së buzëve këto enë paraqesin ngjashmëri me tipet e hershme të periudhës paraqytetare.

Serine e objekteve të fundit e mbyllin peshoret si dhe kandilat karakteristikë për periudhën e vonë helenistike (Tab. I, 18).

[5] A. Baçe, Qyteti i fortifikuar i Kanines, «Monumentet» 7-8, 1974, Tab. V. 2-3.

[6] N. Ceka. Qyteti ilir në Selcën e Poshtme, Iliria 11, 1972, f. 183, Tab. V, 10

[7] Dh. Budina, Antigonea, «Iliria II, Tiranë 1972, Tab. XXVI, 1.

Të gjitha enët janë punuar me një teknikë të lartë. Ato janë lyer me vernik të zi të dobët ose me vernik që, në një farë mase, është i kuq e kafe.

Nga analogjitë e mësipërme rezulton se shumë nga objektet e zbuluara në Kryemdhej e afrojnë atë kryesisht me qendrat e trevës jugore të vendit tonë. Një veçori e tillë e lidhjeve kulturore gjen shpjegimin në vetë pozicionin gjeografik të Kryemdhejit që e përfshin atë në sferën e veprimtarisë tregtare të Dyrrahut dhe të Apolonisë, nëpërmjet tyre edhe me Dimalin, Kaninën e Antigonenë.

Një vend të rëndësishëm midis këtyre të zonës në fjalë zë vendbanimi i fortifikuar në Zig-Xhafaj, tiparet ilire të të cilit shprehen qartë në materialet e shekujve III-II p.e.sonë. Brenda caqeve të kësaj kohe, ndoshta, duhet të ketë pasur fillimin dhe mbarimin e vet dhe jeta qytetare në këtë qytezë.

c) Periudha e shekujve të parë të erës sonë.

Me ndërtimin e trasesë së rrugës Egnacia, Kryemdheji u bë një nga stacionet e para në rrjetin e qarkullimit. Në rrethinat e Arës së Vrapit (aty ku sot fillojnë blloqet e ullinjve) u ndërtuan banesa të reja të shtruara me mozaikë, ndërsa në vendin e quajtur Te rrasat u ngritën gjithashtu ngrehina të reja banimi. Këto zgjerime shprehin në mënyrë të ndjeshme një shtim të dendur të popullsisë së kësaj zone.

Pushtimi romak duket se shkaktoi ndërprerjen e jetës në Kështjellën e Zig-Xhafajt.[8] Banorët e saj e braktisën atë dhe u vendosën diku gjetkë. Fqinjësia e Kryemdhejit me qendrën nuk

[8] H. Myrto, vep. cit., f. 249, supozon braktisjen e kështjellës, duke u mbështetur në mungesën e materialit të periudhës së pushtimit romak.

e përjashton mundësinë e tërheqjes së banorëve të saj në drejtim të fshatit Tilaj.

Ndër enët më të rëndomta që ndeshim në Arën e Vrapit dhe në Arën e Rrasave, janë amforat që i kanë buzët e tyre të kthyera me prerje trekëndëshe (Tab. I, 7-8), forma këto të njohura në Dyrrah e Apoloni.

Në këtë periudhë, në zonën e Kryemdhejit u shfaqën edhe huazimet e para. Nga prania e disa tipe të caktuara enësh, të shek. I të erës sonë, siç janë amforat e tipit golf (Tab. I, 15), prejardhja e të cilave është italike, del një çështje me interes për studimin e rrugës së ardhjes së tyre. Por, nga ana tjetër, dukuria që tregon për riprodhimin dhe mbajtjen e gjallë të disa prej tipeve të amforave dhe të enëve të tjera të periudhave të mëparshme, nxjerr një çështje tjetër, atë të qëndrueshmërisë së traditës.

Nevoja e madhe për eksportimin e artikujve të lëngshëm detyroi punishtet poçare të kësaj kohe të prodhojnë me përpjestime akoma më të mëdha amforat e transportit. Vetë kuptohet se Dyrrahu me rrethinat e tij përballonte peshën kryesore në drejtim të këtij specializimi.

Krahas me prodhimin e amforave vend të rëndësishëm zënë dhe pitosat me grykë të gjerë, kupat e vogla si dhe tenxheret grykëhapëta (Tab. I, 14).

Si motive të vetme të qeramikës kemi një fragment me dekor të krëhëruar (Tab. II, 4).

Në shekujt e antikitetit të vonë, huazimet kulturore në prodhimin e qeramikës morën përpjestime më të mëdha. Një dukuri e tillë vërehet në grupin e amforave të tjera të zbuluara në Tilaj (Tab. I, 9-13), shumë elemente të të cilave pasqyrojnë përvetë-

simin dhe zbatimin e teknologjisë romake. Disa nga këta ekzemplarë kanë ngjashmëri me amforat e periudhës romake të Rapickës në rrethin e Përmetit.[9]

Ndër gjetjet e pakëta janë edhe tri copë sëpata dhe një majë heshte hekuri të shek. III-IV të e.sonë, të gjetura në varrezën e Golemit (Tab. II, 6-9).

Materialin arkeologjik të kësaj zone e mbyll periudha e principatave feudale shqiptare. Kësaj kohe i përket inventari i një varri të zbuluar në vendin e quajtur «Bregu i Kishës që përmbante një enë balte në formë sferike, me dy vegja (Tab. II, 3). Në shpatullën e saj janë incizuar dy rrathë koncentrikë, brenda të cilëve gjithashtu qarkojnë një sërë pikëzimesh. Së bashku me këtë enë është gjetur edhe një monedhë argjendi e mbretit Urosh (Tab. II, 1), trashëgimtar i Stefan Dushanit.

[9] A. Koka, Raport mbi ekspeditat arkeologjike në rrethet e Sarandës, Gjirokastrës dhe Përmetit, "Buletin Arkeologjik, 4", Tiranë, 1974 f. 189, Tab. II, 1-2.



Tab. II



Tab. III

KËRKIME ARKEOLOGJIKE NË FSHATIN HAMALLAJ[1]

(Rrethi i Durrësit)

Në fillim të vitit 1981, gjatë një ekspedite në fshatin Hamallaj, mbi sipërfaqen e një parcele të punueshme të njohur me toponimin "Toka e Kuqe" (fig. 1), u mblodhën disa objekte arkeologjike[2].



Fig. 1

Nga vrojtimet e bëra në parcelë u konstatua se aty ruheshin ende gjurmët e pesë tumave. por punimet bujqësore i kishin shkatërruar aq shumë sa ato u gjendën pothuajse të rrafshuara. Format e tumave mund t'i veçoje vetëm pas kryerjes së plugime-

[1] Marrë nga :Hoti Afrim. Kërkime arkeologjike në fshatin Hamallaj (rrethi i Durrësit); Në; Iliria, vol. 23, 1993. fq.123-131; *(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1993_num_23_1_1620)*

[2] A. Hoti. *Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit*. "Iliria" 1987, 1, f. 260; Po ai. *Qendra të reja prehistorike dhe protourbane në rrethin e Durrësit*, Materiale të Sesionit Shkencor Arkeologjik, Durres 1983, f3-4.

ve ku, në sfondin e parcelës me ngjyrë të errët, atyreve u dukeshin trajtat rrethore me ngjyrë të çelët.[3]

Për të njohur sadopak natyrën e kësaj varreze, gjatë muajit korrik të po atij viti. u ndërmor gërmimi i një tume që, në krahasim me të tjerat, ishte disi më e madhe.[4]

Edhe pse tuma ishte tepër e dëmtuar. në të u arrit të dallohet një shtresë kulturore. Nga këto gërmime u gjetën: një varr i prishur, dy vatra zjarri dhe disa objekte të imëta arkeologjike të mbledhura jashtë varrit.

Gjatë gërmimeve të vazhduara nën dyshemenë e varrit u ndesh edhe një shtresë tjetër kulturore në përmbajtje të së cilës kishte disa objekte prej stralli. Nisur nga këto rrethana u bënë edhe disa sondazhe të tjera jashtë tumës, në vende të ndryshme të parcelës. Nga këto sondazhe rezultoi se kjo shtresë kulturore shtrihej në të gjithë sipërfaqen e punueshme. çka dëshmoi praninë e një vendbanimi të hapur,[5] si dhe dukurinë e ndërtimit direkt mbi shtresën e tij të një varrezë tumulare.[6]

---

[3] Ky ndryshim i përbërjes kimike të dheut te tumave, ndryshe nga dheu i parcelës, ishte një e dhënë që tregoi se aty, gjatë ritualit të varrimit, janë sjellë masa dheu nga një territor tjetër, dukuri kjo e vërejtur edhe në disa nekropole tumulare të vendit tonë. B. Jubani, Tumat e Krumes (Rrethi i Kukësit), "Iliria" 1982, 2, f. 178; N. Bodinaku, Varreza tumulare e Pazhokut. "Iliria" 1982, 1, f. 59.

[4] Gërmimet e para kanë filluar në Hamallaj qysh në vitet ’50 të shek. XX. Në atë kohë nga arkeologet H. Ceka dhe S. Anamali u be nje sondazh ne një tume. Por, meqenëse nuk u dhane rezultatet e duhura. gërmimet u ndërprene. Shih S. Anamali, Gërmime arkeologjike të vitit 1955. "Buletini i Shkencave Shoqërore" 1956, 1. 1. 261.

[5] Theksojmë se në atë kohë u gërmua vetëm pjesa e mbetur e nje tume. Vendbanimi dhe katër tumat e tjera u lane për t'u gërmuar në fushata të mëvonshme.

[6] Nga sa mundem te vezhgonim gjatë sondazhit, midis nivelit të poshtëm të dyshemese se varrit dhe pjesës së sipërme të shtresës së vendbanimit, nuk u konstatua ndonje hiatus.

VENDBANIMI

Nga të dhënat e kufizuara të përftuara nga sondazhi doli se vendbanimi përfaqësohej nga një shtresë me trashësi 20-35 cm. Kjo shtresë përmbante dhe me ngjyrë gri të çelët. Vende-vende, në nivelet e sipërme të saj, ndesheshin grumbullime copash shtufi të karbonizuara, të përziera në ndonjë rast me pluhur hiri.[7]

Në shtresë u mblodhën disa objekte prej stralli (tab.I) dhe fragmente enësh balte (tab.II).

Objektet e strallit. Janë të paktë në numër. Ato përbëhen nga disa ashkla dhe një majë shigjete.

Ashklat (tab.1.1.3-10). Janë të përmasave të vogla, me ngjyrë kafe të errët, të bardhë. bezhë, gri etj. Në ndonjërën prej tyre duket qartë pjesa e bardhë e mëllës. Midis copave veçohet një ashkel gjatësore (tab.1.3) me gjatësi 4.4 cm e gjerësi maksimale 1.5 cm. që duhet të jetë përdorur si prefèse.

Majë shigjete (tab.1.2). Është punuar prej stralli ngjyrë bezhë. Ka formë trekëndëshi dybrinjënjëshëm me gjatësi të bazës 1.5 cm dhe lartesi 3.0 cm. Baza. në trajtë harkore. përfundon me kulme të majacuara. Eshte punuar me retushim të imët. Objekte të këtij tipi, te gjetura në tumat e Pazhokut, janë datuar në helladikun e mesëm.[8] Maja shigjetash të tilla. thuajse të së

[7] E njëjta natyrë stratigrafike u vërejt edhe në sondazhet në parcelë ku. pas heqjes se shtreses se sipërme me trashësi 70-80 cm (e krijuar nga depozitimet aluvionale). doli shtresa e poshtme kulturore me trashësi 30 cm, që i takonte vendbanimit.

[8] S. Islami - H. Ceka. Te dhena te reja mbi lashtësinë ilire në territorin e Shqiperise. "Konferenca I e Studimeve Albanologjike" (Tirane 15-21 nëntor 1962). Tirane 1965, f. 447. tab. I,12.

njëjtës kohë, janë gjetur edhe në jug të vendit tonë (Vajzë. Çuke e gjetkë)[9].

Qeramika (tab.II). Përbëhet nga disa fragmente enësh. Në gjendjen e porsa nxjerrë nga gërmimi ajo thërrmohej dhe thyhej shpejt, ndërsa pas larjes, kur thahej. paretet e saj bëheshin shumë të forta.

Qeramika është punuar prej brumi të papastër me ngjyrë gri të errët, me përzierje rëre lumi dhe në ndonjë rast edhe me thërrmija gurësh të shtypur. Në disa prej copave të qeramikës, në faqet e brendshme dhe të jashtme. dallohet një cipë e skuqur e shkaktuar me sa duket prej oksidimit. Në disa copa të tjera vihet re një lloj lustre e lehtë me shkëlqim të zi. Megjithëse të pakta në sasi, midis fragmenteve të qeramikës. dallohen forma buzësh, vegjësh dhe fundesh.

Buzët (tab.II.1-2). Janë dy fragmente që duhet t'u përkasin grykave rrethore të tenxhereve trungkonike. Këto enë ngjasojnë me ata ekzemplarë që ndeshen gjatë gjithë epokës së bronzit në Shqipëri.[10] Forma enësh të tilla, sikundër shprehen edhe autorë të tjerë, janë në përdorim edhe gjatë periudhës së hekurit të hershëm.[11]

Vegjët. Ndër copat që paraqesin më tepër interes janë vegjët brinake teh-sëpatë (tab.II.4-5). Format e tyre ndeshen në disa qendra të kohës së bronzit të mesëm dhe të vonë[12]. Përputhje më

[9] F. Prendi. Epoka e bronzit në Shqipen. "Iliria" VII-VIII. 1977-1978. 8: M. Korkuti. Një kushtim i epokës së bronzit në Çukë (Sarandë). "Iliria" 1990, 1. 1. 83.

[10] F. Prendi, vep.cit.. tab.II. 10: III.12: IX, e pesta nga lart-poshtë, majtas

[11] B. Jubani*, Qeramika ilire e qytezës së Gajtanit*,"Iliria" II, 1972, tab.IV, 7, X,10; M. Korkuti, Tuma e Patosit. "Iliria" 1981. 1, f. 48, tab.11. 4

[12] S. Islami-H. Ceka, vep.cit.,tab. VII.4; B. Jubani, Qeramika.... tab. III, 6.

të përafërta të ngjashmërisë së tyre vihen re me format analoge të poçerisë së bronzit të mesëm, zbuluar vitet e fundit në vendbanimin shpellor të Nezirit në rrethin e Matit.[13]

Një fragment tjetër (tab.II, 3) paraqet formën e një tasi trungkonik me buzë të kthyer nga brenda. Në faqen e jashtme duken gjurmë sprucimesh të lehta, por që nuk duhen lidhur me teknikën barbotine. Sprucimet mund të zhduken lehtësisht në qoftë se fërkohen me dorë. Tipat e këtyre enëve të njohura qysh në kohën e bronzit të vonë kanë gjetur përdorim edhe gjatë periudhës së hershme të hekurit.[14]

TUMA

Tuma që zgjodhëm për gërmim paraqitej mjaft e dëmtuar. Nën ndikimin e depozitave aluvionale të sjella nga përroi i Tarinit, që rrjedh pranë parcelës, ishte maskuar deri në një farë mase periferia e tumës. Për këtë arsye saktësimi i përmasave të tumes u bë pas përfundimit të gërmimeve.



Fig 2

[13] *Zh. Andreu, Vendbanimi shpellor i Nezirit. "Iliria" 1990, 2, f. 58, tab. XIII, 17-19.*

[14] *M. Korkuti, Vendbanimi prehistorik i Trenit, "Iliria" I, 1971, tab. VIII, 4; B. Jubani, Qeramika..., tab. II, 6; IX, 4.*

Tuma, me diametër 24 m dhe lartësi 0.80-0.90 m, ishte e ndërtuar tërësisht prej dheu (fig.2). Në këtë tumë dalluam vetëm një shtresë kulturore. Ajo përbëhej prej dheu me ngjyrë të verdhë në okër.

Mënyra e varrimit. Materiali eshtror i varrit përbëhej nga disa kocka kafke ku dalloheshin qartë gjurmë të djegies, një e dhënë kjo që dëshmoi për mënyrën e varrimit.

Vatrat e zjarrit. U gjetën në sektorin e parë në të njëjtat nivele (0.40 m thellësi). pranë njëra-tjetrës. Ato përfshinin një sipërfaqe 1.5-2.5 m2. Përveç dheut të djegur në to u ndeshën edhe copa thëngjijsh.

Varri. U zbulua në sektorin III, në thellësi 0.40 m nga qendra. Varri ishte i tipit gropë e thjeshtë. Dyshemeja e tij ishte prej dheu të ngjeshur. Drejtimi i varrit nuk u përcaktua, mbasi edhe ato pak kocka që u gjetën nuk jepnin ndonjë orientim të qartë. Mënyra e varrimit ishte me djegie. Në një sipërfaqe rreth 2 m2 në nivel të dyshemesë u gjetën disa objekte prej bronzi: një fragment shpate, një fragment gjoksoreje, katër copë kopsa të fragmentuara dhe një këmbë byzylyku.

Fragmente të një shpate bronzi (tab.III. 13,a-b). Nga ky ekzemplar ruhet vetëm një pjesë e tehut dypresash (9 cm) dhe mbaresa harkore e njërit vesh të dorezës. Këto elemente na lejojnë të krahasojmë këtë tip arme me shpatat danubiane të fazës së parë të hekurit të hershëm (shek. XI-IX p.c.sonë). tipologjia e të cilave ruhet edhe gjatë periudhave të mëvonshme[15].

[15] G.V. Merhart, "Hallstatt und Italien", Mainz 1969, f. 16, tab. II.1; f.17, fig. 1/5: Delia G. Lollini, Sintesi della civiltà picena. "Jadranska Obala u protohistoriji. Zagreb 1976, f. 120. tab. II, 19.

Pjesë e një gjoksoreje bronzi (tab. III, 1). Ka trajtën e një disku me diametër 20.5 cm. Disku formohet nga një shirit prej 10 rrathësh koncentrikë, me kurrize të lehtë. të lidhur vertikalisht dhe horizontalisht me anën e dy shiritave të tjerë me diametër 20.5 cm. Gjoksorja duhet të ketë shërbyer si mburojë që mbërthehej në mesin e kraharorit me anën e një mjeti fiksues.

Në dy botime të mëparshme gjoksorja është datuar në shek. VIII p.e.sonë[16] dhe është përcaktuar si objekt i importuar nga Italia[17]. Prototipet e modeleve të saj, me sa duket, kanë qenë tepër të preferuar si objekte zbukurimi gjatë periudhës gjeometrike në disa vise të brigjeve të përkundrejta të vendit tonë[18].

Kopsa bronzi të fragmentuara (tab. III. 2-5). Janë katër copa të njëjta në trajtë gjysmësferike. me çarje radiale. pa dekor të incizuar. Këta ekzemplarë të datuar midis shek. XI-VII p.e.sonë janë përcaktuar si objekte tipike të kulturës ilire të Matit.[19]

Pjesë e një byzylyku prej bronzi (tab. III. 6). Nga kjo stoli ruhet vetëm fragmenti i njërës këmbë. Incizimet vijëdrejta që

[16] A. Hoti, Qendra të reja..., . 4, tab. II. 1: M. Korkuti, Marredhenie midis dy brigjeve të Adriatikut jugor në kohën e bronzit dhe të hekurit, "Iliria" 1985, 1. f. 96. fig. 4 (bashkë me literaturën e cituar).

[17] M. Korkuti, po aty.

[18] Imma Kilian-Dirlmeier, Anhänger in Griechenland von der Mykenibischen zur Spätgeometrischen Zeit. "Prähistorische bronzefunde". Abteilung XI. 2 Band. München 1979. Tafel 10 (151-153): K. Kilian, Fruhej zenzeitliche funde aus der sudostnekropole von Sela Consilia, Heidel ridionale scambi fra le due sponde dell'Adriatiko "Bulletino di palentologia italiana" N.S.XX. vol.78. Roma 1969, Tafel 10 id: 113.3 ab: 267 III (4), 269 (6) B.Chirtano. La necropoli dell'eta'dell ferro dell'incoronate e di S.Teodoro (Scavi 1978-1985), v. II. 1994, f. 89, tab. 45. T. 258. G. 1.

[19] F. Prendi. Vështrim mbi kulturen e periudhës së epokës së hekurit në Shqipëri, "Iliria" III, 1973, f. 126, tab. V,12; D. Kurti, Tumat e Burrelit. "Iliria" VII-VIII. 1977-1978, f. 187, tab. XV, varri 80, fig. 4,6.

duken në pjesën e samarit, e ofrojnë më shumë me tipin e byzylykut karakteristik të pellgut të Korçës.[20]

Gjetje jashtë varrit. Në brendësi të tumës. jashtë varrit. u zbuluan: një fragment hanxhari prej hekuri bashkë me këllefin e tij. tri vegla peshkimi (dy plumçe dhe një grep peshku) dhe një pjesë gjilpëre prej hekuri.

Fragment i një hanxhari prej hekuri (tab. III, 11). Ruhet vetëm një pjesë e vogël e tehut që nuk të mundëson të përcaktosh tipin. Pjesë e këtij hanxhari duhet të jetë edhe fragmenti i një këllëfi po prej hekuri (tab. III. 12).

Vegla peshkimi. Përbëhen nga një grep hekuri (tab. III. 10) dhe dy peshore plumbi (tab. III.8-9) që u gjendën në pika të ndryshme të tumes. Grepat për zënien e peshkut janë përdorur në vendin tonë qysh në epokën e bakrit[21]. Të dhëna të tjera për këto objekte janë të pakta. Edhe plumçet sferike janë objekte gjithashtu të rrallë. Deri më sot njihen peshoret e peshkimit të zbuluara në qendrat bregdetare të Dalmacisë[22].

Fragment i një gjilpëre bronzi (tab.III.7). Nga gjilpëra ruhet vetëm pjesa e dëmtuar e kokës, që duhet të ketë qenë sferike si dhe një pjesë e trupit me seksion rrethor. Gjilpëra të tilla datohen nga shek.IX p.c.sonë deri në shek.V p.e.sone[23].

---

[20] Zh. Andrea, Tumat e Kuçit të Zi. "Iliria" VI,1976.tab.IX.varri 59.3; tab.II, varri 5/b, nr. 1-2.

[21] F. Prendi. La civilisation préhistorique de Maliq. "Studia Albanica" 1969, 1. tab. III, d.

[22] F. Stare. Dva prazgodovinska groba z Dalmatinske obale. "Adriatica", Zagreb 1970, f. 200, tab. I. 15.

[23] B. Jubani. Të dhëna për kulturën tumulare të Shqipërisë verilindore, "Kuvendi Ii Studimeve Ilire", I, f, 191, tab. V, 6: D. Kurti, vep.cit., f.171, tab. VII, varri 31, fig.5; M.Korkuti, Tuma e..., f. 31, tab. III, varri 17.

*

* *

Gërmimet për hapjen e një tume në Hamallaj dhe sondazhet e kryera në vendbanim, ndonëse na dhanë një lëndë me pak materiale, na mundësojnë për të nxjerrë disa përfundime paraprake.

Nga të dhënat e stratigrafisë doli se tuma, e përbërë tërësisht prej dheu, ishte ndërtuar mbi truallin e vendbanimit. Midis shtresës së poshtme (që i përkiste vendbanimit) dhe asaj të sipërme (që lidhet me fazën e ndërtimit të tumës) nuk u konstatua ndonjë hiatus.

Objektet arkeologjike të zbuluara në shtresën e vendbanimit e në mënyrë të veçantë qeramika, na lejojnë ta vendosim kronologjikisht këtë vendbanim në periudhën kalimtare nga epoka e bronzit në atë të hekurit.

Në tumë u gjet vetëm një varr. inventari i të cilit datohet jo më vonë se shek. VIII p.e.sonë. Prania e dy vatrave të zjarrit në brendësi të tumës, si edhe gjetja e objekteve të tjera jashtë varrit, na lënë të mendojmë se aty mund të ketë pasur më shumë se një varr.

Objektet arkeologjike të gjetura në tumë, ndonëse të njohura për kulturën ilire. zbulohen për herë të parë në rrethin e Durrësit e më gjerë përgjatë Ultësirës Pranadriatike. Madje, dy prej objekteve, shpata dhe gjoksorja prej bronzi zbulohen për herë të parë në vendin tonë.

Midis gjetjeve, krahas elementëve vendas, ka edhe objekte importi. Prania e një shpate bronzi me prejardhje tipologjike danubiane, përveç mundësisë së këmbimit nëpërmjet marrë-

dhënieve me Italinë, nuk përjashton edhe faktin që armë të tilla të jenë siguruar përmes shkëmbimeve tregtare me qendra të grupit kulturor Mat-Glasinac.[24]

Edhe gjoksorja prej bronzi, e njëjtë për nga veçoritë stilistikore me objektet analoge të zbuluara në viset e tjera të brigjeve të përkundrejta të Adriatikut. përbën një të dhënë tjetër që dëshmon për kontakte kulturore midis ilirëve dhe botës përreth gjatë periudhës së parakolonizimit helen.

[24] Variante të shpatave danubiane të vona kanë pasur përdorim edhe në trevat e grupit kulturor Mat-Glasinac: A.Benac-B.Čović, "Glasinac " II,tab.XVII,4.

RESUME

RECHERCHES ARCHEOLOGIQUES DANS LE VILLAGE HAMALLAJ

(District de Durres)

L'objet de ces recherches archéologiques effectuées en 1981 à l'endroit dit "Toka e Kuqe" ("Terre Rouge") sont les restes d'un tumulus endomage appartenant au commencement du VIII siècle av.n.ère ainsi qu'une agglomération non fortifiée datant de la période de transition de l'époque du bronze à celle du fer.

Le tumulus, construit en terre, disposait d'une scule couche culturelle. On y a trouvé une seule tombe à simple fosse. Deux foyers de feu et quelques ossements carbonisés du squelette du défunt témoignent d'un enterrement à incinération.

L'inventaire de la tombe se composait de quelques objets en bronze fragmentés (tab.III, 1-6: 13,a-b). Hors de la tombe on a trouvé aussi des objets métalliques (tab.III, 7-12).

La présence de l'agglomération est documentée par une couche culturelle se trouvant au-dessous du sol de la tombe. ainsi que par des objets en silex (tab.I) et des fragments de céramique (tab.II) assurés par un sondage fait dans la zone autour du tumulus.



Tab. I



Tab. II



Tab. III

DY VARRE TË PERIUDHËS SË ANTIKITETIT TË VONË NË DURRËS[1]

Nga një gërmim shpëtimi i kryer në nekropolin kodrinor të qytetit të Durrësit gjatë verës së vitit 1987, u zbuluan dy varre të tipit dhomëz. Ato u ndeshën rastësisht në të majtë të rrugës automobilistike, te kthesa e fundit që të çon në kuotën 98 m.[2] Varret ishin vendosur në një thellësi 2.75 m, me orientim L-P. Në pamjen e parë ato duket se janë ndërtuar si një dhomë, por, në fakt, zhvillimi planimetrik i tyre është bërë në dy drejtime: dhomëza e varrit nr. 1 (kryesori) në të djathtë dhe, bashkëngjitur e në lidhje organike me të, dhomëza e varrit nr. 2 (anësori) në të majtë (Fig. 1).

Varri 1. Është një dhomëz përdhese në formë drejtkëndëshe me përmasa të jashtme 2.60 x 1.90 x 1.65 m. Në muraturën e tij janë përdorur tulla (0.30 x 0.30 x 0.04 m) me lidhje llaçi gëlqereje e me përzierje zhavori të imët. Nga ana lindore, në pjesën ballore të varrit, ka një portëz hyrjeje në formë drejtkëndëshi me lartësi 1.10 m dhe gjerësi 0.60 m. (Tab. I, 2). Në

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës. Në; Iliria, vol. 18 n°1, 1988. fq.223-225; *(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1988_num_18_1_1484)*

[2] Disa të dhëna për këtë nekropol dhe për gërmimet e kryera aty gjenden te: F. Tartari. Një varrezë e mesjetës së hershme në Durrës, Iliria, 1984. 1, f. 227-250; po ai. Një grup varresh të shekujve II-IV të e.sonë në zonën kodrinore. të nekropolit të Dyrrahut, Iliria 1987, 1, 153-164.

fundin e portëzës është vendosur një prag prej guri, 0.20 m i lartë. Dyshemeja, me përmasa 1.95 x 1.20 m, është shtruar. me tulla të vendosura në rreshta të rregullta (Tab. I, 4). Tullat kanë përmasa të njëjta si ato të mureve anësore. Edhe mbulesa në trajtë kubeje është ndërtuar me tulla dhe me të njëjtën teknikë. Veshja e brendshme e mureve është kryer me suvatim të zakonshëm. Në dy anët e suvasë, me lartësi 0,66 m nga dyshemeja, ruhen gjurmë afresku me ngjyrë të kuqe (Tab. I, 6-7). Në secilën faqe me penelata shiritore janë pikturuar dy kryqe.

Varri 2 (Tab. I, 1-2) ka formë dhe ndërtim të njëjtë me të parin, por me përmasa të vogla: 2.40 x 1.20 x 0.90 m. Një pjesë e mureve që bashkëngjiten me varrin 1 janë ndërtuar, si në rastin e parë, me tulla dhe llaç, ndërsa faqet e tjera të muraturës me teknikën e përzier: gurë, tulla të plota (0.30 x 0.30 x 0.04) dhe copa tullash të lidhura me llaç gëlqereje. Pjesa e sipërme e muraturës së varrit u gjet e dëmtuar, prandaj nuk mund të gjykojmë se si ka qenë mbulesa e saj. Edhe në këtë varr nga ana lindore gjendet një portëz me hapësirë drite 0.60 x x 0,72 m. Dyshemeja e saj, në formë drejtkëndëshe (1.92 x 0.77 m) është shtruar me tre rreshta tullash të përmasave 0.30 x 0.30 x 0.04 m (në rreshtin e mesit) dhe 0.19 x 0.27 x 0.04 e 28.5 x 28.5 x 4.5 cm (në rreshtat anësorë) (Tab. I, 5).

Në dyshemetë e këtyre varreve u gjetën copa kockash dhe disa dhëmbë njeriu të shpërndara në mënyrë të çrregullt. Varret ishin pa inventar.

Tipologjia e varreve të përshkruar më lart, nga pikëpamja e kompozimit planimetrik dhe e teknikës së ndërtimit, është pothuajse e njëjtë me disa varre të tjera të zbuluara në këtë pjesë të

nekropolit, që datohen në shek. II-IV të e.sonë.[3] Por, ndryshe nga këto të fundit, në varrin 1 të zbuluar prej nesh, në faqet e brendshme të tij është pikturuar me afreske, skema e njohur e krishtërimit, krizma, si shprehje e një koncepti të ri ritual.



Nga të dhënat që parashtruam mendojmë se varret 1 e 2, të zbuluara pranë kuotës 98 m të nekropolit kodrinor të qytetit të Durrësit, u përkasin si kohë shek. IV-V të e.sonë. Nga pikëpamja ndërtimore dhe nga përdorimi e përmasat e materialeve të ndërtimit, ata u përmbahen traditës së ndërtimeve sepulkrale të shekujve të parë të e.sonë, ndërsa bartësit e tyre ka mundësi të kenë qenë përfaqësues nga rradhët e të krishterëve të parë të qytetit të Durrësit.

[3] F. Tartari, Një grup varresh.... f. 154.


V.2
V.1
A
A
1
0 60CM
2
PRERJE A-A
0 60CM
3
4
0 30CM
5
0 20
PERSPEKTIVE
6
0 10CM
7
90

Tab. I

RAPORTE GËRMIMESH

(RAPPORTS DE FOUILLES)

Gërmimet arkeologjike të vitit 1984

DURRËS (Lagjja 11)[1]

Gjatë fushatës verore të vitit 1984 në lagjen 11 (ish Varosh) të qytetit të Durrësit, pranë vendit të quajtur "kishëz", filloi gërmimi i një varreze mesjetare. Shenjat e para për ekzistencën e saj ishin konstatuar disa vite më parë. U gërmua një sipërfaqe prej 48 m2 dhe midis thellësive 0.80-2.20 m u hapën 14 varre. Ato u gjendën pranë dhe mbi disa rrënoja ndërtimesh të vjetra. Gjatë gërmimeve arritëm të dallojmë dy shtresa kulturore.

Në shtresën e parë me ngjyrë kafe të errët e me trashësi 50 cm u zbuluan: pjesa e një muri, një trakt kanali si dhe varret 8, 12 e 13. Njëkohësisht, këtu u zbulua edhe një lëndë arkeologjike e pasur me fragmente objektesh të ndryshme.

Muri (Fig. 8) ishte 5.40 m i gjatë, 0.65 m i gjerë dhe 0.50 m i lartë. Ai kishte orientim VL-JP. Ky mur ka qenë ndërtuar me teknikën "opus mixtum".

Një pjesë e kanalit u zbulua paralelisht me murin; ai ka pasur prerje drejtëkëndëshe me gjerësi 0.80 m dhe lartësi 0.70 m. Muret e tij janë ndërtuar, edhe ato, me teknikë «opus mixtum». Pjesa e sipërme e kanalit mbulohej me pllaka guri kristalin, ndërsa shtroja e tij përbëhej prej tjegullash.

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Durrës. Në; Iliria, vol. 14 n°2, 1984. fq.274-275; *(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1984_num_14_2_1888)*

Në këtë shtresë u mblodh një sasi relativisht e pasur qeramike e përbërë nga fragmente amforash të zbukuruara me gërvishtje krehri, copa enësh kuzhine, si dhe fragmente enësh të importit afrikano-verior të shek. IV-VI e. sonë. Kjo lloj qeramike është zbukuruar me figura gjeometrike të bëra me anë të gërvishtjes dhe me figura kafshësh në reliev.



Përveç këtij materiali, u gjetën edhe copa gotash prej qelqi me frone të larta si dhe disa monedha, por që ishin të dëmtuara dhe të palexueshme.

Në shtresën e dytë, me trashësi 1.70 m, dheu ishte me ngjyrë kafe të hapur, i përzier me një numër të madh fragmentesh qeramike ndërtimi dhe enësh të përdorimit të përditshëm.

Këtu u zbulua pjesa më e madhe e varreve (varret 1-7, 9-11 dhe 14). Materiali i ndërtimit përbëhet nga tulla me përmasa: 0.37 x 0.30 x 0.05 m, 0.36 x 0.34 x 0.04 m dhe 0.29 x 0.28 x 0.03 m, disa prej të cilave kanë mbishkrime tani për tani të palexueshme. Përveç tullave ka dhe tjegulla solene me përmasa 0.65x0.39 m, 0.63 x 0.41 m, si edhe kulmore (kalipterë) gjysmëharkore. Këto janë të zbukuruara me hulli, me tufa vijash 6 she të bëra me gishtërinj.

Në numrin e madh të copave të enëve dallojmë dy lloje qeramike: të thjeshtë dhe të glazuruar.

Qeramika e thjeshtë përbëhet nga: a) copa amforash të zbukuruara në barqe me hulli horizontale b) copa grykash të ngushta që, me sa duket, u ngjajnë shtambave mesjetare të ndeshura në Lezhë, Kaninë, Shurdhah etj. c) fragmente kanash dhe brokash të zbukuruara me bojë të kuqe dhe kafe me linja penelash të çrregullta, ashtu sikundër janë punuar enët mesjetare të hershme në Krujë, Lezhë e gjetkë, ç) copa vorbash me trup sferik pa zbukurime të profiluara në buzë me kanal për vendosje kapaku.

Qeramika e glazuruar dhe e pikturuar me ngjyra të ndryshme përbëhet nga fragmente tasash, pjatash, pjatancash etj. Si motive karakteristike të përdorura janë figurat gjeometrike, shpendësh e peshqish. Nga kjo qeramikë ka edhe copa të llojit sgrafito. Ndër gjetjet e tjera janë disa fragmente enësh qelqi, e veçanërisht fundet e tyre në trajtë dhëmbësh sharre, objekte këto që datohen në shek. XIII-XIV. U gjetën gjithashtu edhe 5 monedha bakri të shek. XI-XIII.

Varret ndodheshin në thellësi të ndryshme. Kështu, varret 1-7, 11 e 14 u gjetën në thellësinë 0.80-1.30 m, ndërsa varret nr. 8-10, 12, 13 në thellësi 1.40-1.90 m. Shumica e tyre janë varre me

gropë (varret 1, 2, 5-11, 13-14), vetëm dy prej tyre (varret 4 e 12) ishin mbuluar me tjegulla solene. Orientimi i varreve ishte PL (kafka në P), por ka edhe raste me orientim VL-JP (kafka JP) ose VP-JL (kafka në VP). Janë përdorur dy lloje varrimesh: individuale (varret 1, 4-14) dhe kolektive me dy skelete (varret 2 e 3). Skeletet ruheshin në gjendje pjesërisht të mirë. Në të gjitha varret mbizotëronte pozicioni i trupit i vendosur në shpinë me gjymtyrë të shtrira.

Disa nga varret kishin inventar. Kështu në varrin 1 u gjetën dy tasa të llojit të qeramikës protomajolike (fundi i shek. XII fillimi i shek. XIII); në varrin 3 u gjet një enkolpion bronzi me figurën e krishtit të kryqëzuar, ndërsa varri 5 kishte nje shtambë balte të zbukuruar me kanelyra horizontale. Interes të veçantë paraqet inventari i varrit nr. 8 që përbëhet nga një broke, gjashtë tasa të glazuruar dhe me pikturim, një çekiç hekuri dhe një monedhë e Manuelit I Komnen.

Zbulimi në shtresën kulturore të shek. IV-VI i një muri dhe një trakti të kanaleve terciare, që përcillte ujin nga banesat ose ndërtimet e ndryshme në rrjetin e kanaleve sekondare, provon se territori në fjalë ka qenë një lagje e kohës së antikitetit të vonë, ndërsa prania e varreve mesjetare tregon se ky vend u shndërrua më vonë në një varrezë.

Gërmimet arkeologjike të viteve 1985-1986

DURRËS KALAJA[1]

Gërmimet e kryera dy vitet e fundit (1985-1986) u përqendruan rrëzë faqes së brendshme të murit JP të kalasë së Durrësit. Në dy fushata kërkimesh të organizuara në muret I e II u gërmua një sipërfaqe prej 200 m2. Këto ekspedita kishin për qëllim të evidentonin elementet përbërëse arkitektonike të murit rrethues dhe ndjekjen e stratigrafisë.

Muri I (që përfshihet midis kullave A dhe B) e ka gjatësinë 48.80 m, ndërsa muri II (midis kullave B dhe C) 62.50 m. Muret e tyre, 3.35 m të gjera, ruhen në lartësi 5.35 m. Pranë secilit mur u hapën nga katër kuadrate (5 x 5 m). Punimet në murin e parë u çuan deri në thellësinë 2.70 m, ndërsa në murin e dytë deri 5.80 m. Pas këtij niveli, për shkak të daljes së ujërave nëntokësore, gërmimet u ndërprenë.

Rezultati kryesor ishte zbulimi në murin I i një porte dhe tepricat e themeleve të një ngrehine, kurse në murin II zbulimi i pjesës së mesme të saj (superstruksioni), si dhe një pjesë e xokolaturës. Porta në pamje ballore ka formën e patkoit. Pjesa e sipërme është punuar në trajtë harku me një rresht tullash të lidhura

[1] Marrë nga :Hoti Afrim. Durrës — Kalaja . Në; Iliria, vol. 16 n°2, 1986. fq.268-269;
https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1986_num_16_2_1999

me llaç gëlqeror. Ky hark vazhdon gjatë trashësisë së murit në formën e një kubeje gjysmëcilindrike. Shpatullat e kësaj kubeje mbështeten në mesin e murit dhe shkrihen me të si dhe me dy krahët anësorë të hyrjes. Hapësira e portës ka gjerësi 2.35 m, ndërsa lartësia e saj deri në nivelin e gërmimeve të sotme është 3.5 m. Porta është e mbyllur me një masë gurësh të lidhur me llaç të fortë gëlqeror. Kjo portë përbën një nga hyrjet kryesore në linjën JP të kalasë dhe si tip është e njohur në sistemin e fortifikimit të kalasë së Durrësit.

Superstruksioni është ndërtuar me teknikën e njohur me tulla e llaç të fortë gëlqeror. Lartësia e tij nga niveli i platformës është 7.85 m. Përmasat e këtyre tullave janë 31 x 35.5 x 5.5 cm dhe 29.5 x 35.5 x 5.0 cm. Këto përbëjnë dhe masën kryesore të tullës së përdorur në ndërtimin e kalasë. Në bazë të të dhënave të reja rezulton se lartësia e murit II nga niveli i platformës, duke përfshirë këtu superstruksionin dhe xokolaturën, është 10.75 m.

Tepricave të një ngrehine u përkasin dy mure të mbështetura pingul në faqen e murit I. Ato u zbuluan në thellësi 1.40 m dhe janë ndërtuar me gurë e llaç. Gjatësitë i kanë të ndryshme, 3.65 e 2.15 m.

Në fazën e gërmimeve të gjertanishme dallohen katër shtresa kulturore. Shtresa e parë, me trashësi 0.50 m (dhe i verdhë me përzierje rëre), përmban një numër të paktë fragmentesh amforash dhe pjatash, që tipologjikisht i takojnë periudhës së shekujve të parë të e.s.; shtresa e dytë, me trashësi 1.30 m (dhe i përhimtë i përzier me copëra gurësh), përmban një material të pasur me fragmente qeramike. Pjesa më e madhe e tyre u takon amforave të zbukuruara me hullza krehëri, që datohen midis shekujve V-VI e.sonë. Pjesën tjetër e zënë copat e brokave, kanave,

vorbave, kandilave etj., që edhe këto, u përkasin si kohë shekujve të antikitetit të vonë. Shtresa e tretë, me trashësi 2.20 m (dhe kafe i errët me përzierje gurësh), ka fragmente enësh si dhe ndonjë objekt metalik. Ena më përfaqësuese këtu është amfora shtambë e zbukuruar me shirita angobë kafe të errët, të kuqe dhe të kuqe të mbyllët. Ka edhe broka, kotruve etj., disa prej tyre janë zbukuruar me hulliza paralele, dhe valëzuese, ndërsa disa copa të tjera me pikëzim. Gjetje me interes janë dhe tasat trungkonikë me parete të holla, të glazuruara me jeshile e bezhë. Këto objekte ka shumë mundësi t'i përkasin importit bizantinolindor të shekujve IX-XI.

Shtresa e katërt, me trashësi 1.80 m (dhe kafe i çelët me nënshtresa argjile të verdhë dhe përzierje me copa gurësh), dallohet për pasurinë e gjetjeve. U grumbulluan mbi 20 enë balte thuajse të plota dhe një numër i madh fragmentesh, që u përkasin pitosave, amforave, shtambave, kotruveve, enëve të tryezës, vorbave etj. Pjesa dërmuese e këtyre objekteve i takon prodhimit endës të shek. XII-XV, por nuk mungojnë dhe objekte të importit italik apo të ndonjë qendre të veçantë të Mesdheut Jugor. Në shtresë u gjetën dhe objekte të tjera si gërshëra e thika prej hekuri, shishe e gota qelqi, disa monedha bizantine dhe dy monedha të tjera prej bronzi që u përkasin prerjeve të Republikës së Shën Markut, me legjendën: DALMAT ET ALBAN (shek. XIV).

Gërmimet arkeologjike të vitit 1987

DURRËS - QYTET[1]

Gjatë ndërtimeve të reja në zonën prapa pallatit të kultures "A. Moisiu", në thellësi 2.40 m. u zbuluan pjesë të një konstruksioni të lashtë me kolonade (Fig. 1). Nga gërmimet arkeologjike të kryera për disa muaj në një sipërfaqe 1600 m^2 rezultoi se ky konstruksion i përkiste një Macellumi me planimetri rrethore. Megjithëse ruhet në gjendje të dobët, në këtë monument duken qartë mbetjet e kolonadës, një pjesë e dyshemesë, mbetjet e një podiumi në qendër dhe nje pus pranë tij.

Kolonada është ndër pjesët që është dëmtuar me tepër. Ajo ka trajt rrethore me diametër 40 m. Ne gjendje disi të mirë paraqitet xokolatura e saj, ndërsa nga pjesët e tjera ruhen vetëm tri kolona të plota, dy fragmente të tyre, dy kapitele dhe një impost.

Xokolatura është bërë me teknikën muraturës së përzier. Muri i saj ka prerje drejtkëndëshe 0,85 m të gjerë dhe 0.30 m të lartë. Tek pjesa e sipërme e xokolit janë vendosur 11 pllaka jastëk guri në trajtë drejtkëndëshi. Në pesh prej pllakave u gjetën edhe bazamentet e kolonave dhe ndër këto të fundit kishte edhe të atillë ku ishin gdhendrur siglat IAT EY etj.

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Durrës (Qytet). Në: Iliria, vol. 18 n°2, 1988. fq.271-272;
(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1988_num_18_2_1923)

Kolonat dhe kapitelet janë punuar prej mermeri të bardhë me rremba gri. Faqet anesore të kapiteleve janë zbukuruar me dy rrathë gjethesh akanthi, ndërsa cepat e stilizuar në trajtën e kokës së dashit. Kësisoj, se bashku me kolonat. ato i përkasin plastikës dekorative arkitektonike të periudhës paleokristiane.

Dyshemeja ka qenë shtruar me pllaka guri kristalin. Ajo ndahet nga xokoli i kolonadës nëpërmjet një ujëmbledhësi (kunele) në trajtë gjysmërrethore. Pllakat janë vendosur mbi një shtresë llaçi hidroizolues. Ato kanë formë drejtkëndëshe dhe trapezoidale me përmasa 3.20 x 1,15 x 0,05 m; 2.50 x 0.80 x 0,50 m: 2.00 x 0.90 x 0,04 m. Nga e gjithe shtresa ruhet vetëm një numër i kufizuar i pllakave, kurse për pjesën tjetër mund të gjykohet vetem nëpërmjet gjurmëve të lëna nga heqja e tyre, në vendin e të cilave duken kurrizet e fugave që të japin deri në një farë mase përfytyrimin thuajse të plotë të vendosjes së tyre në trajtë rrezore. Ne sipërfaqen e disa pllakave është gërvishtur shkronja φ. Vetëm në një rast grupi i shkronjave greke ιφ. Bërthamën kompozicionale të monumentit e zë podiumi i ngritur në pjesën qendrore të tij. Ai eshte ndërtuar me gurë, llaç të fortë gëlqeror në trajtën e një masivi rrethor me diametër 4.50 m dhe lartesi 0.80 m, ka tri këmbë shkallë të harkuara, të cilat në pjesën e sipërme përfundojnë në një plate. Përreth tij u gjetën copa llaçi me afresk. Në njërën prej tyre, mbi sfondin e bardhë të sipërfaqes, janë vijëzuar katrorë të vegjël me brinjë 1 cm dhe me ngjyrë të kuqe, gjë që të jep përshtypjen se ato i imitojnë efektet e mozaikut. Ka shumë mundësi që ky afresk të ketë shërbyer si pjesë zbukurimi në anët murore të shkallëve. Pranë buzinës së këtij masivi u gjetën fragmenti i një kolone të vogël, disa copëza pllakash mermeri dhe pjesa e një skulpture mermeri, që na bëjnë

të mendojmë se edhe ketu duhet të kenë qenë përdorur si materiale per veshjen dhe zbukurimin e podiumit.

Dy metra larg podiumit, në anën lindore të tij, ndodhet pusi. Ai ka një grykë me diametër 1.20 m dhe është ndërtuar me teknikën opus mixtum. Nga sondazhi që u krye nën dysheme u gjetën një numër fragmentesh qeramike që i takojnë shtresës kulturore të shek. IV dhe fillimit të shek. V i e.sonë, gjë që na dha një terminus ante quem për ndërtimin e monumentit aty nga fundi i shek. V dhe fillimi i shek. VI.



Fig. 1

Varret e zbuluara brenda dhe jashtë Macellumit ndodheshin në një thellësi 2.35 - 2,40 m. Pesë prej tyre (varret 1-4,14) ishin ndërtuar brenda monumentit. drejt mbi dyshemenë e tij, ndërsa pjesa tjetër jashtë kolonadës. Varret i përkasin tipit me mbulesë tjegullash solene të vendosura në trajtë çatie dyujëshe. Disa prej tyre (varret 2-4, 10-13) kanë drejtim P-L (kafka në P). ndërsa

varret e tjera ishin të orientuara me drejtim V-J. Tek varret u vu re mënyra e varrimit me trupvënie, vetëm dy ishin pajisur me objekte. në njërin prej tyre (varri 4) u gjetën 11 rruaza të tipit "milefiori" e "perlshtab" dhe dy tëmthore bronzi me fund të përdredhur, ndërsa në tjetrin (varri 14) u gjet një brokë. Jashtë varreve u gjetën gjithashtu një tokëz dypjesëshe dhe një varëse në trajtë rrethore, të dyja këto prej bronzi.. Stolitë e gjetura në varre dhe ato jashtë tyre datohen në shek. VII-VIII të e.sonë.

Shndërrimi i dyshemesë në vendvarrim gjatë shek. VII-VIII të e.sonë tregon se ky monument në këtë kohë ka qenë rrënuar.

Macellumi i sapozbuluar përbën një objekt të ri të panjohur gjer më sot në vendin tonë. Duke pasur parasysh gjendjen urbanistike të kësaj zone, ku aty pranë janë konstatuar disa gjurmë kishash paleokristiane, mendojmë se edhe kjo ngrehinë duhet t'i përkasë një monumenti, nukël për kompozimin e qendrës së qytetit paleokristian.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1988

DURRËS - QYTET[1]

Në vijim të kërkimeve të vitit të kaluar, gërmimet e sivjetme në Macellum u përqendruan në lindje të portikut, përqark kolonadës. Këtu dolën në dritë elemente të reja të arkitekturës: hajati, një grup mjedisesh të vendosura njëri pas tjetrit në trajtën e brezave bash-këqendrorë dhe hyrja kryesore e monumentit. Nga kjo zgjidhje arkitektonike monumenti ka marrë formën e një rrethi me dia-metër 72 m (Fig. 1).

Pjesa e hajatit të zbuluar me hapësirë 5,30 m. paraqitet si një korridor i hapur harkor. Ai krijohet duke u kufizuar nga kolonada e portikut dhe muri i brendshëm i grupit të mjediseve.

Nga pikëpamja funksionale hajati ka luajtur rolin organizues, për të qarkulluar në grupin e mjediseve dhe për një komunikim të lirshëm.

Grupi i mjediseve është vendosur në shpinë të hajatit. Këto mjedise janë formuar nga ndarja e korridorit të dytë harkor me disa mure të brendshme. Deri tani janë zbuluar rrënojat e shtatë mjediseve. Nga konstruksioni i tyre ruhen vetëm muret e themeleve me lartësi 2,30 m dhe disa mbetje të pakta të mureve mbajtëse.

[1] Marrë nga: Hoti Afrim. Durrës (Qytet). Në: Iliria, vol. 19 n°2, 1989 fq.293-294;
(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1989_num_19_2_1964)



Fig. 1

Mjediset paraqiten në formë të çrregullt katërkëndëshe e trapezoidale me sipërfaqe 20-27 m2. Hyrja dhe dalja në çdo mjedis bëhet në dy krahë: nga jashtë nëpërmjet murit perimetral të monumentit dhe nga brenda nëpërmjet haiatit. Themelet janë ndërtuar me gurë e llaç. Një pjesë e faqes së brendshme të tyre ka qenë e suvatuar. Muret mbajtëse mbi xokol ruhen në lartësi 0,30-0,40 m. Ato janë bërë me tulla të lidhura me llaç gëlqereje të fortë me përzierje. Disa prej tullave, me përmasa 35 x x 29 x 5 cm, kanë monograme greke Ø, π, etj., njësoj si ato që janë ndeshur në kalanë e periudhës së antikitetit të vonë të Durrësit.

Mbulesa e mjediseve është bërë me tjegulla solene dhe kaliptere. Kjo gjë u dëshmua nga lënda e nxjerrë gjatë gërmimeve

dhe sidomos një nga mbulesat dukej qartë në gjendjen e saj të shembur në brendësi të themeleve të mjedisit nr. 3.

Hyrja e monumentit ndodhet në anën lindore. Ajo ka karakterin e një korridori të hapur (vestibul), 8 m të gjatë dhe 4 m të gjerë, që formohet nga dy faqet paralele të mureve anësore të mjediseve 1 e 5.

Në brendësi të grupit të mjediseve e përreth tyre në shtresën e poshtme kulturore, në thellësi 1,80 - 2.50 m, u gjetën materiale arkeologjike të përbëra nga qeramike e periudhës së shek. V-VI: enë të mëdha e të vogla, kandila etj., të shoqëruara me monedha të perandorëve Anastas, Justinian etj. Edhe në shtresën e sipërme, 1,80 m të trashë, u gjetën mjaft fragmente të zbukuruara me linja shiritore prej boje të kuqe e kafe. Po këtu, u zbuluan një shat hekuri, një kandar bronzi, disa peshore prej plumbi e balte, një kruese bronzi për kuaj, si dhe objekte të tjera të një lloji të veçantë: vula kontrolli për mallra, tesera loje, terrakotë me figurë femre, të gjitha këto prej balte.

Gjetja e mjeteve të peshimit si dhe fakti i zbulimit të një numri relativisht të madh me monedha prej bronzi (mbi 50 copë) të perandorëve bizantinë të antikitetit të vonë dhe fillimit të mesjetës, lënë të mendosh se grupi i mjediseve duhet të ketë funksionuar për tregtimin e mallrave.

Gjatë gërmimeve u zbuluan brenda dhe jashtë strukturave të monumentit (në thellësi 2,00-3,20 m) 41 varre të tjera me konstruksion.

Varret janë ndërtuar me mbulesa tjegullash solene të vendosura në trajtë çatie dyujëse. Në ndonjë rast, në kulmin e tyre janë vendosur edhe kaliptere. Varre kanë drejtim P-L, me shmangie të lehtë në anën VL-JP ose VP-JL. Në secilin prej tyre u vu re

mënyra e varrimit me trupvënie. Të gjitha skeletet ishin vendosur në shpinë me gjymtyrë të shtrira. Pjesa më e madhe e varreve u gjet pa inventar. Vetëm te disa prej tyre (varret 21, 33, 37) u gjetën objekte metalike: një enkolpion e një rreth bronzi dhe dy monedha, gjithashtu prej bronzi, në gjendje të palexueshme.

Të dhënat e deritanishme tregojnë se Macellumi është ndërtuar mbi bazën e një skeme planimetrike krejtësisht të veçantë e të ndryshme nga ndërtimet e tjera paleokristiane. Prania e disa godinave të kultit në afërsi dhe përreth tij tregon se ky monument ka luajtur një rol të rëndësishëm në formulimin urbanistik të qendrës së qytetit gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme.

Portiku me sipërfaqe relativisht të madhe ka qenë në qiell të hapur dhe, si i tillë, mund të ketë pasur funksionin e një sheshi publik. Duke qenë i rrethuar nga mjedise tregtimi, ka shumë të ngjarë që ai të jetë përdorur si shesh-tregu ku organizoheshin pazaret e panairet e rrumbullakët nga popullsia e qytetit dhe e rrethinës së tij.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1989

DURRES - QYTET[1]

Gërmimet arkeologjike të nisura dy vite më parë vazhduan në anën lindore të shesh-tregut (Macellumit), rreth 10 m larg murit perimetral të tij. Në një sipërfaqe afro 300 m2 u zbuluan disa rrënoja ngrehinash. Ky grup është ndërtuar në vijim të pjerrësisë së relievit, në një kuotë 0,20-0,30 m më të ulët se plani i vendosjes së shesh-tregut.

Grupi i dytë i mjediseve kufizohet në periferi me një mur perimetral, nga i cili dalin muret ndarëse të brendshme. Deri tani janë zbuluar pjesërisht tri mjedise me përmasa të ndryshme. Hyrjet e tyre ende nuk janë përcaktuar, por ka mundësi që të kenë qenë nga ana veriore.

Teknika e ndërtimit është e njëjtë me atë të mjediseve të shesh-tregut; themele të bëra me gurë dhe llaç të fortë gëlqeror dhe mbi të muret me tulla me përmasa 29x36x4 cm, disa prej të cilave të stampuara me shenja kryqi në reliev.

Muri periferik përshkon mjediset në formë të një harku me gjatësi 15,50 m, trashësi 0,70 m dhe lartësi 1,30 m. Nga ana e jashtme këtij muri i bashkëngjitet kanali i shkarkimit të ujërave.

[1] Marrë nga: Hoti Afrim, Sila Anton. Durrës. Në: Iliria, vol. 20 n°2, 1990. fq.271-272;
(https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1990_num_20_2_2048)

Muri periferik paraget interes se ai përsërit të njëjtin formulim si muret e jashtme të mjediseve tregtare.

Mjediset kanë trajtë katërkëndëshe me një faqe paksa të harkuar. Nga gërmimet e bëra deri tani del se mjedisi III ka përmasa 7,20 x 5,30 m. Brenda tij, në thellësi 2,20 m, u gjetën disa pllaka mermeri (njëra prej të cilave me përmasa 1,10 x 1,00 x 0,06 m) dhe qeramikë, që kanë shërbyer si shtrojë. Në nivelin e shtresës së këtij mjedisi u gjet gjithashtu fragmenti i një kunete të brendshme, të ndërtuar me tjegulla kaliptere, të vendosura njëra pas tjetrës në formë të mysët.

Në mjedisin II, nën strukturën e tij, u zbulua një mur tjetër themeli me drejtim të kundërt dhe stratigrafikisht më i hershëm se ndërtimet e sipërme.

Tek mjediset II, III u zbuluan gjithashtu dy gryka pusesh me gurë e llaç gëlqeror, që duhet t'i përkasin një periudhe më të vonë.

Të dhënat e deritanishme për grupin e dytë të mjediseve tregojnë se kemi të bëjmë me tri etapa ndërtimesh. Fazës së parë i takojnë rrënojat e mureve të shekujve të parë të e.sonë të zbuluara në mjedisin II. Ka shumë të ngjarë që ato të jenë pjesë përbërëse e ndërtesave të termave. Fazës së dytë i përkasin muret e mjediseve që datohen në antikitetin e vonë (shek. V-VI të e.s.). Ato nuk i përmbahen konceptit planimetrik të fazës fillestare. Faza e tretë, që përfaqësohet nga puset, është ende e papërcaktuar në kohë.

Pjesa e monumentit e zbuluar rishtas ka një planimetri të një lloji të veçantë, ajo zë vend pranë tregut, duke u harmonizuar me të si një ansambel unik. Çdo dhomë ka pasur funksion të vetin, por në mjedisin III u gjetën mbeturinat e një kunete të brendshme që na lë të mendojmë se dhoma në fjalë mund të jetë

përdorur si punishte, meqenëse në dyshemenë e saj rridhte një masë e lëngët. Eshtë kjo që dëshmon se grupi i mjediseve ka qenë shfrytëzuar si qendër e prodhimit zejtar.

Zbulimet e viteve të fundit sjellin të dhëna të reja për urbanistikën e qendrës së qytetit të Durrësit në kohën e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme. Kompozimi planimetrik dhe arkitektonik i saj na jep shembullin e parë të një ansambli tregtarozejtar, që, nga njëra anë, i përmbahet traditës helenistike e romake (kolona rrethore, tipi i kapiteleve etj.) dhe, nga ana tjetër, pasqyron tiparet e organizimit urban tipik bizantin.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1990

DURRËS[1]

Rreth 200 metra në verilindje të monumentit me kolonadë rrethore, brenda territorit të kinemasë verore, vite më parë u konstatuan gjurmë të një monumenti të lashtë. Duke punuar për zbulimin e planit në një sipërfaqe prej 150 m2, dolën në dritë trakte të murit perimetral të këtij ndërtimi, si dhe 10 varre të vendosura rreth tij. Gërmimet arritën në thellësinë 2,50 m. Për shkak të daljes së ujërave nëntokësore, ato nuk u çuan deri në taban. Gjatë gërmimit u dalluan dy shtresa kulturore.



Në shtresën e poshtme me trashësi 1,20 m u zbuluan: trakti i murit dhe varret. Materiali arkeologjik i kësaj shtrese është i

[1] Hoti Afrim, Sila Anton. Durrës . In: Iliria, vol. 20 n°2, 1990. pp. 271-272. https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1990_num_20_2_2048.

përzier dhe përbëhet nga fragmente enësh të thjeshta të shek. VI-VII të e.s. si dhe monedha bronzi, disa prej të cilave u përkasin perandorëve Komnenë. Në shtresën e sipërme u gjetën fragmente enësh me glazurë të shek. XII-XV, monedha turke etj.

Muri me gjatësi 4,50 m, trashësi 1,22 m dhe lartësi 0,90 m është ndërtuar me tulla të përmasave: 0,29x0,28x0,03 m, 0,29x 0,30x0,03 m dhe llaç të fortë gëlqeror.

Varret u gjetën në thellësinë nga 1,40 m deri në 2,40 m. Tipi II është me mbulesë tjegullash solene të vendosura në trajtë çatie dyuxjëse (varret 1-4, 6-10). Varre me ndërtim të tillë shfaqen në Durrës që në periudhën e antikitetit të vonë, por me të njëjtën mënyrë ndërtimi ato i ndeshim edhe gjatë shek. VII-VIII. Tipin II e përbën vetëm një varr (nr. 5). Ai ka trajtën e një dhome drejtkëndëshe. Faqet anësore të këtij janë ndërtuar me gurë e llaç, ndërsa mbulesa me trajtë qemeri gjysmërrethor është punuar me tulla dhe llaç.

Drejtimet e varreve paraqiten të ndryshme. Përveç orientimit mbizotërues P-L (1,2,3,5,7,8,10), kishte dhe varre me drejtim VP-JL (4,9) dhe vetëm një V-J (nr. 6).

Përmasat e varreve janë nga 0,66 deri në 2,84 m të gjata dhe 0,31 deri 1,70 m të gjera. Mënyra e varrimit është me vendosje trupi. Në çdo varr kishte vetëm një skelet. Ato u gjetën relativisht të ruajtura dhe të vendosura në shpinë në tokë. Përjashtim bënte varri nr. 9, ku si shtroje shërbenin tjegullat solene.

Varret ishin kryesisht pa inventar. Vetëm në varrin nr. 6 u gjetën dy vathë bronzi. Jashtë varreve u gjetën edhe objekte të tjera një enkolpion dhe një unazë bronzi që tipologjikisht u përkasin shek. IX-XI. Këto objekte ka shumë mundësi të jenë mbeturina varresh të prishura. Duke u mbështetur në të dhënat e derisotme, jemi të mendimit se kemi të bëjmë me rrënojat e një

ngrehine të kohës së antikitetit të vonë. Territori pranë saj, gjatë shekujve të mesjetës së hershme është zënë nga një varrezë me shtrirje të kufizuar. Shfrytëzimi i kësaj zone të qytetit mesjetar të Durrësit për varrime nuk është rastësi e provuar vetëm në këtë pikë, por edhe në disa mjedise të tjera brenda rrethimit të dytë të sistemit të fortifikimit bizantin. Këto të dhëna dëshmojnë se qysh gjatë fazës së parë të mesjetës së hershme qyteti kishte pësuar njëfarë tkurrje territoriale.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Hoti, Afrim
Kërkime arkeologjike : përmbledhje artikujsh shkencorë:
(1980 - 2000) / Afrim Hoti. - Durrës : Jozef, 2026.
276 f. : me il. ; 14,5 x 20,5 cm.
ISBN 9789928942111
1.Arkeologjia 2.Antikitete ilire
3.Studime 4.Durrës 5.Shqipëri
903/904(496.536) (081)